albas

KATALOGU I BOTIMEVE PËR FËMIJË

2023

WWW.ALBAS.AL

Përmbajtje

HAPAT E PARË	4-17
MËSO DHE LUAJ	8-11
FLETORET GJIGANTE	13-15
PUSHIMET MAGJIKE	16-17
KOHA E BANJËS	18-19
BABY MONTESSORI	20-21
LIBRA INTERAKTIVË	22
BOTA E BEBES	23
VOGËLUSHI-VOGËLUSHJA	24-26
LIBRI ME MASKË	27
LIBRA INTERAKTIVË	28-35
DINOZAURËT	36
KLASIKËT E MI TË PARË	37
SJELLJET MË TË MIRA	38-39
ME PAK FJALË	40-41
MIUSHI LEXUES	42-46
ARIU I BARDHË I ËNDRRAVE	47
NUMRAT E JETËS	48-49
LE TË FLASIM HAPUR	50-53
FABULAT E EZOPIT	54-55
TË KUJDESEMI PËR PLANETIN TONË	56

NGA G. RODARI 57
NJË HISTORI NË 5-15 MIN. 58-59
PËRRALLA QË TREGOHEN NGA TË RRITURIT 60-61
STILIM 62
LIBRA INTERAKTIVË 63-64
AUTORË SHQIPTARË 65-67
KLASIKËT PËR TË VEGJËL 68-76
LIBRA INTERAKTIVË 77
NJË FAMILJE E PAPARË 78-84
KRYEVEPRAT E ANTIKITETIT 85
KLASIKËT PËR FËMIJË 86-92
MË QUAJNË... 93-103
BËMAT E ESTES DHE KOKOSË 104
KONI DHE MAKSI 105-109
LETËRSIA ITALIANE PËR FËMIJË 110-111
TRASHËGIMI KULTURORE 112-113
AUTORË SHQIPTARË 114-119
LIBRI I MADH 121
LETËRSIA FRANCEZE PËR FËMIJË 122-123
ENCIKLOPEDIA IME 124
MINIGUIDAT 125
TITUJ TË TJERË 126-131

Hop-hop



FAQET ARGËTUESE "HOP HOP"

Dosje me 64 fletë kartoni

Faqe: 128 (64 faqe me ngjyra dhe 64 faqe bardhë e zi)

Formati: 205 x 295 mm

Kopertina: 350 g, e plastifikuar

Çmimi: 900 lekë; 7.5 €; 450 den

Dosja **"HOP-HOP"** "Faqet argëtuese" është hartuar në bazë të programit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për ciklin parashkollor sipas fushave kurrikulare: zhvillimi gjuhësor, matematikor, shkencor, artistik, social dhe shëndetësor.

Dosja shoqërohet me një udhëzues dhe plan mësimor për mësuesit dhe prindërit, të cilët do të ndjekin gjatë një viti ecurinë e fëmijëve të moshës 3-4 vjeç.

Çdo mësim ka dy faqe:

- faqja e parë është ilustrim me figura, ku fëmija heton (investigon), lexon figurën, tregon, dallon, numëron, pyet, përgjigjet, vepron, zgjedh (rrugën drejtimin);

- faqja e dytë është fletë pune, ku fëmija kërkon, zbulon, gjen, lidh të njëjtat, dallon ndryshimet, ngjyros, vizaton, shkruan.

Pra, në çdo faqe fëmija duhet të drejtohet për të mësuar njohuri të reja e për të punuar në mënyrë të pavarur.

9 miqtë e mi

Ky libër, i hartuar në përputhje me programin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për edukimin parashkollor, rekomandohet të përdoret për fëmijët 4-5 vjeç.

Libri shoqërohet me një udhëzues për mësuesit dhe prindërit, të cilët do ta ndjekin ecurinë e fëmijëve gjatë një viti shkollor.

Libri **"9 miqtë e mi"** është hartuar sipas fushave kurrikulare: zhvillimi gjuhësor, matematikor, shkencor, artistik, social dhe shëndetësor.

Libri është strukturuar me 9 kapituj, që u përgjigjen 9 muajve mësimorë, nga tetori deri në qershor. Në secilin muaj fëmija do të njihet me nga një personazh: arusha Ada, dinozauri Dino, tigri Tigo, pinguini Pigo, majmuni Moja, flutura Fufu, patoku Pam, bretkosa Besi, lepurushi Lori.

Nëpërmjet ilustrimeve tërheqëse dhe personazheve zbavitëse, fëmija njëkohësisht do të mësojë dhe do të argëtohet.

Çdo mësim ka një ose dy faqe, ku fëmija heton (investigon), lexon figurën, tregon, dallon, numëron, pyet, përgjigjet, vepron, zgjedh (rrugën drejtimin), lidh të njëjtat, dallon ndryshimet, ngjyros, vizaton, shkruan.

Pra, në çdo faqe fëmija nxitet për të mësuar njohuri të reja e për të punuar në mënyrë të pavarur.

Një mësim mund të punohet në disa orë mësimore, sa e sheh të arsyeshme mësuesja për të realizuar objektivat e parashikuar. Në krye të çdo faqeje janë disa kërkesa që përmbajnë thelbin e veprimit që duhet të bëjë fëmija. Këto kërkesa e orientojnë edhe prindin për punën që mund të bëjë fëmija në kushte shtëpie.

9 MIQTË E MI

Autore: Rita Petro, Mirela Tërova
Ilustruese: Ledia Kostandini
Faqe: 176 me ngjyra
Formati: 205 x 275 mm
Çmimi: 1 000 lekë, 8 euro, 500 den
Kopertina: 350 g, e plastifikuar

Miqtë e mi Vesa dhe Lumi

Paketa "Miqtë e mi, Vesa dhe Lumi", u dedikohet fëmijëve të grupmoshave mbi katër vjeç dhe atë mund ta përdorin në mënyrë shumë efikase edukatorët, prindërit dhe ekspertët e tjerë të edukimit si mjet për stimulimin e zhvillimit të fëmijës në fusha të ndryshme zhvillimore. Është një libër që përmban tema nga bota që rrethon fëmijët dhe ka për synim përgatitjen e tyre për shkollë dhe jetë.

"LUAJ ME SHKRONJAT"

Kuti kartoni me fisha (me shkronja e figura) dhe me CD

Çmimi: 900 lekë; 7.5 €; 450 den

Luaj me shkronjat

Kutia **"Luaj me shkronjat"** përmban fisha kartoni me 36 shkronjat e gjuhës shqipe. Secila shkronjë shoqërohet me nga një figurë.

P.sh.: shkronja A = ANA (personazhi i kutisë)

shkronja B = BALONA ..... etj.

Pas njohjes së shkronjës dhe figurës, fëmijët do të kalojnë në një etapë tjetër: atë të fjalëformimit.

Kjo lojë mund të luhet dhe në kompjuter me anën e CD-së që shoqëron kutinë.

Një hap drejt shkollës

Kjo paketë, e hartuar në përputhje me programin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për edukimin parashkollor, rekomandohet të përdoret për fëmijët 5-6 vjeç. Paketa shoqërohet me një udhëzues për mësuesit dhe prindërit, të cilët do ta ndjekin ecurinë e fëmijëve gjatë një viti shkollor.



Teksti **"Unë dhe shkronjat"** është ndërtuar mbi bazën e këtyre linjave të programit: gjuhë për komunikim; gjuhë për të menduar; lidhja e tingujve me shkronjat; të shkruarit fillestar. Teksti është ndërtuar mbi bazën e shkronjave të alfabetit. Çdo shkronjë studiohet më vete nëpërmjet një figure, e cila përmban një tregim. Po kështu nëpërmjet ushtrimeve, fëmijët lidhin tingullin me shkronjën dhe ushtrohen të njohin dhe të shkruajnë shkronjat e mëdha të shtypit.

Teksti **"Unë dhe mjedisi"** është ndërtuar mbi bazën e këtyre linjave të programit: Pjesa e parë - ***vetja ime dhe të tjerët, familja ime dhe të tjerët, kopshti im, vendbanimi im, lodrat*** dhe ***lojërat***;
Pjesa e dytë hapet me njohuritë për natyrën; fëmija drejtohet të vëzhgojë natyrën dhe të dallojë nga se përbëhet ajo. Vëren ngjyrat, format dhe përmasat e ndryshme të objekteve që ndesh në natyrë duke vëzhguar botën bimore, shtazore dhe njeriun, si dhe gjithçka përreth, fëmija dallon natyrën e gjallë nga jo e gjallë.





Teksti **"Unë dhe arti"** është ndërtuar mbi bazën e këtyre linjave të programit: Pjesa e parë - proceset fillestare të vizatimit (vijat, ngjyrat);
Pjesa e dytë - materialet e ndryshme për vizatim;
Pjesa e tretë - krijimi i lirë artistik.
Edukimi muzikor realizohet nëpërmjet një CD-je me 12 këngë të shoqëruara me tekstet e tyre.

NJË HAP DREJT SHKOLLËS

Dosje me kapak të fortë, përmban 4 tekste, CD, mozaikun e shkronjave dhe certifikatën e vlerësimit

Çmimi: 2 200 lekë, 18 euro, 1100 den



Teksti **"Unë dhe numrat"** është ndërtuar mbi bazën e këtyre linjave të programit: ***numri, gjeometria dhe orientimi në hapësirë, matja, marrëdhënia*** dhe ***funksioni***. Të gjitha njohuritë matematikore jepen nëpërmjet vizatimeve dhe situatave të shumta, të cilat i krijojnë mundësi mësuesit/prindit t'i organizojë në formë loje. Figurat e objekteve që përdoren për numërim apo për t'u krahasuar, janë të njohura për fëmijët, pasi merren nga jeta e përditshme.

7+ VJEÇ

MËSO

Abetare

mbarëkombëtare

ABETARE MBARËKOMBËTARE

Dosje me kapak të fortë

Autore: Rita Petro, Mirela Tërova, Natasha Pepivani, Vehbi Kadriu, Flutura Çitaku

Çmimi: 2 500 lekë, 18 euro, 1 100 den

Paketa e Abetares është përgatitur nga një grup specialistësh didaktikë dhe gjuhëtarësh nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Ajo është mbështetur në programet e Ministrive të Arsimit të këtyre trevave. Qëllimi i grupit të punës ka qenë të përgatisnin një paketë sa më të plotë, që do t'u shërbejë si nxënësve në shkolla, ashtu dhe fëmijëve që do ta përdorin këtë paketë në mjedisin familjar.

Paketa synon që mësimi i gjuhës shqipe të jepet në mënyrë sa më zbavitëse, tërheqëse dhe të përvetësueshme, duke harmonizuar pesë proceset bazë: të vëzhguarit, të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.

Paketa përmban:

- **Tekstin bazë, Abetare**, i strukturuar me tri pjesë: Paraabetare, Abetare, Pasabetare;
- **Fletoren e modeluar**, ku nxënësit sipas modelit do të shkruajnë shkronjat e dorës;
- **Fletën e punës**, ku nxënësit do të ushtrohen për mësimin e shkronjave, kryesisht të shtypit dhe disa njohuri gramatikore;
- **Fjalorin e ilustruar**: (shqip-anglisht, shqip-italisht, shqip-greqisht, shqip-gjermanisht); në paketë është një nga këta fjalorë.

Synimi është që fjalorët t'u shërbejnë edhe fëmijëve që jetojnë jashtë vendit të tyre;

- **CD-në**, e cila si mjet audiovizual u shërben nxënësve për proceset e të dëgjuarit dhe të vëzhguarit;
- **Mozaikun me vjersha** për secilën shkronjë;
- **Librin e stërgjyshërve** (me poezi të rilindësve);
- **Udhëzuesin** për mësuesit dhe prindërit.

Faqe: 72, me ngjyra
Formati: 205x275 mm
Kopertina: mat, 250 gr
Çmimi: 350 lekë; 2.5 euro, 150 den



Faqe: 72, me ngjyra
Formati: 205x275 mm
Kopertina: mat, 250 g
Çmimi: 250 lekë; 2 euro, 120 den



Tituj: 4
Faqe: 164, me ngjyra
Formati: 200x238 mm
Kopertina: mat, 250 g
Çmimi: 600 lekë; 4.5 euro, 250 den



ABETARE MBARËKOMBËTARE
Faqe: 164, me ngjyra
Formati: 305x240 mm
Kopertina: 350 g, e plastifikuar
Çmimi: 1 000 lekë; 7 euro, 420 den

Çmimi: 250 lekë; 2 euro, 120 den

7+ VJEÇ

MËSO

Abetare

mbarëkombëtare

ABETARJA MBARËKOMBËTARE është një libër që ruan bazën e të mësuarit të shkronjave prej botimit mjaft të suksesshëm të vitit 2009. Ky libër është ndërtuar sipas kurrikulave të sotme bashkëkohore dhe kompetencave, që marrin parasysh zhvillimin e fëmijëve të sotëm. Libri ka në qendër katër personazhe kryesore, të cilat do t'i shoqërojnë fëmijët në situata nga më të ndryshmet tepër argëtuese, por edhe me mesazhe edukuese.

Harmonizimi i kësaj abetareje si libër fizik me librin digjital, do t'ua lehtësojnë fëmijëve të mësuarit e shkronjave dhe, njëkohësisht, ata do të mësojnë duke u argëtuar. Katër personazhet do të shndërrohen në katër miqtë e tyre më simpatikë gjatë gjithë librit. Libri është i shoqëruar me ilustrime sa moderne, aq edhe didaktike, lehtësisht të kapshme nga nxënësit e kësaj moshe. Nëpërmjet ushtrimeve të zgjedhura me shumë kujdes, fëmijët do ta kenë shumë të thjeshtë t'i mësojnë shkronjat dhe të lexojnë fjalët, fjalitë dhe tekstet e shkurtra. Grupi i punës ka mundur të gjejë një ekuilibër mjaft të saktë duke e bërë këtë libër lehtësisht të përdorshëm nga fëmijët që jetojnë në të gjitha trevat ku flitet gjuha shqipe dhe në diasporë.

ABETARJA është e shoqëruar dhe me FLETË PUNE, ku fëmija do të ushtrohet për shkronjat e shtypi dhe shkronjat e dorës.

MËSO 7+ VJEÇ

Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare

Teksti Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare – Niveli 1 është hartuar në përputhje me Kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë, miratuar nga MASR, Shqipëri dhe MASH, Kosovë.

Teksti është ndërtuar në tri pjesë, që përkojnë përkatësisht me klasat I, II, III.

Ato në tekstin e nxënësit/es emërtohen: Paketa Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare I përmban: librin e nxënësit, fletoren e punës, fjalorin me figura, antologjinë me pjesë të zgjedhura *Shko dallëndyshe*, librin e mësuesit dhe librin digjital.



Faqe: 288, me ngjyra
Formati: 207x277 mm
Kopertina: mat, 250 gr
Çmimi: 820 leke; 6.7 euro

Faqe: 130, me ngjyra
Formati: 205x275 mm
Kopertina: mat, 250 gr
Çmimi:380 lekë; 3.1 euro

Faqe: 120, me ngjyra
Formati: 205x240 mm
Kopertina: mat, 250 gr
Çmimi: 350 lekë; 2.8 euro



Faqe: 48, me ngjyra
Formati: 130x180 mm
Kopertina: mat, 250 gr
Çmimi: 150 lekë; 1.2 euro

Faqe: 186
Formati: 130x180 mm
Kopertina: mat, 250 gr



MËSIMET E PIANOS

Faqe: 64, me ngjyra
Formati: 285x205 mm
Kopertina: 250 gr
Çmimi: 450 lekë; 3.5 euro, 200 den

Libri "Mësimet e pianos" është një libër udhëzues për fëmijët 4-7 vjeç, që ulen për herë të parë para pianos dhe që kanë shumë dëshirë ta mësojnë atë.

Ju, lexues të vegjël, së bashku me 6 miq të rinj do të nisni një udhëtim muzikor shumë të bukur e të dobishëm. Ndërsa shfletoni faqet e librit, nëse do të ecni me kujdes, dëshirë dhe durim, do t'ia dilni që të bëni një rrugëtim praktik dhe magjik në rrugën bardhezi të quajtur "piano".

I pasuruar me lojëra të thjeshta, gjëegjëza, rrëfenja të përkthyera në nota dhe ritëm, ky libër u shërben fëmijëve që të kuptojnë muzikën, të njohin teknikat, ritmin, ushtrimin e dëgjimit, leximin, improvizimin, solfezhin.

Udhëtimi muzikor në faqet e këtij libri ua bën fëmijëve më të këndshme dhe më të bukur këtë rrugë drejt mësimit të pianos.

XHEPI I SHKRONJAVE DHE I RROKJEVE

Kuti kartoni me fisha (me shkronja e rrokje)
Çmimi: 650 lekë, 5 euro, 300 den

Përmban të gjitha shkronjat e mëdha dhe të vogla të shtypit të alfabetit të gjuhës shqipe, si dhe rrokje të ndryshme për të formuar fjalët e para duke u argëtuar.

Seria Mëso dhe luaj

Seria për fëmijë "Mëso dhe luaj" përmban 3 blloqe argëtuese për fëmijë 3-5 vjeç dhe 3 libra për parashkollorin. Këto blloqe dhe libra përmbajnë ushtrime didaktike dhe mjaft argëtuese për fëmijë të këtyre grupmoshave. Duke punuar me blloqet, fëmijët aftësohen të gjejnë dallimet mes figurave, të kopjojnë gjurmët e kafshëve, të gjejnë rrugën për të dalë nga labirinti, të gjejnë sendin e futur gabim mes sendeve të dhëna, të ngjyrosin etj., kurse te tre librat, shkalla e vështirësisë së ushtrimeve rritet paksa, por gjithmonë në përputhje me zhvillimin e fëmijëve. Ata do të mësojnë format, të kundërtat, numrat dhe shkronjat nëpërmjet ushtrimeve mjaft argëtuese, duke u përgatitur kështu për të shkuar drejt klasës së parë.

Tri fletoret a para të punës për moshën 3-5 vjeç janë ideuar në formë blloqesh, pasi fëmijët e kësaj grupmoshe ende nuk janë aftësuar të punojnë me një libër, kurse blloku është më praktik për ta. Ata mund të punojnë një faqe dhe ta grisin nga blloku.

Tri fletoret e tjera janë në formë libri, pasi në këtë moshë fëmijët tashmë janë aftësuar të punojnë me librin.

Faqe: 88, me ngjyra
Formati: 160 x 240 mm
Kopertina: hapje nga lart, 250 gr
Çmimi: 450 lekë; 3.5 euro; 210 den



Faqe: 106, me ngjyra
Formati: 200 x 280 mm
Kopertina: me lustër , 250 gr
Çmimi: 570 lekë; 5 euro; 305 den

Seria

Fletoret gjigante

FLETORET GJIGANDE

Tituj: 4

Faqe: 18, bardhë e zi

Formati: 325 x 475 mm

Kopertina: me lustër

Çmimi: 550 lekë; 4 euro; 250 den (për libër)

Fletoret janë në format të madh, me qëllim që fëmija mund të punojë mbi to edhe i shtrirë mbi tapet.

Kjo seri me 4 tituj është hartuar mbi objektivat e përfshirë në programin mësimor për ciklin parashkollor. Përmes teksteve të shkurtra me figura interesante, fëmijët do të mësojnë të ngjyrosin, të lexojnë, të shkruajnë dhe të zbaviten duke luajtur në grup.

Personazhet e njëjta në secilin libër: një vajzë, një djalë dhe pesë kafshët që janë miqtë e tyre, vihen në situata të larmishme, të cilat u mësojnë fëmijëve si të sillen mirë, si të jenë të shëndetshëm e të lumtur, si të jenë të kujdesshëm në rrugë dhe si të mbrojnë mjedisin.

Me kërkesat e larmishme, si: ngjyrosja, shkrimi, shënimi, rrethimi, plotësimi i fjalëkryqeve, numërimi, fëmijët ushtrohen individualisht dhe në grup.

Natyra, ajri, lumi, pema, lulja - kjo është natyra që na rrethon, e cila fillon nga oborri dhe shkon deri larg, në malet, pyjet, detet etj. Dy personazhet, Bora dhe Blerimi, së bashku me miqtë e tyre kafshë, i udhëheqin fëmijët në një rrëfim, në të cilin fëmijët mësojnë si të kujdesen për natyrën: të mos prishin lulet, të mbjellin bimë, të përdorin mjete transporti që nuk ndotin ajrin, të mos lënë mbeturina apo të mos ndezin zjarr në pyll, të mbajnë pastër mjedisin ku jetojnë, të ndajnë mbeturinat sipas materialit me të cilin bëhen, t'i ripërdorin ato, të kursejnë ujin dhe energjinë pozitive, të kujdesen për kafshët etj.



Ky libër me vjersha të vogla e të thjeshta, të ilustruara me figura interesante, i mëson fëmijët se ç'janë ushqimet dhe uji, si të ushqehen mirë dhe shëndetshëm, cilat janë pjesët e trupit, si të kujdesen për veten, të merren me sporte, të shkojnë te mjeku, të pushojnë dhe ëndërrojnë, të kenë mendime të mira, si dhe të shprehin hapur mendimet dhe emocionet e tyre.

Të jetosh në qytet është bukur, por të kalosh nëpër rrugët e tij ka rreziqe. Ky libër i njeh fëmijët me rrugën dhe përdoruesit e saj, rregullat e qarkullimit rrugor, shenjat dhe sinjalet rrugore. **Ndalo! Prit! Shiko! Kalo!** Nëpërmjet personazheve të këndshme dhe gjuhës së thjeshtë e gazmore, ata mësojnë si të jenë të sigurt në rrugë. Me kërkesat e larmishme, si ngjyrosja, shkrimi, shënimi, rrethimi, plotësimi i fjalëkryqeve, numërimi, ata ushtrohen për atë që mësuan, duke luajtur individualisht dhe në grup.

Përshëndetje! Më fal! Faleminderit! Natën e mirë! Që sa zgjohen në mëngjes e derisa bien për të fjetur, njerëzit duhet të sillen mirë me të gjithë ata që takojnë. Miqtë tanë, nëpërmjet veprimtarive dhe situatave të larmishme, u mësojnë fëmijëve rregullat e mirësjelljes: të thonë "Mirëmëngjesi!" kur zgjohen, të sillen mirë në tavolinë, të ndihmojnë të tjerët, të kujdesen për veten, të mbajnë higjienë, të vendosin gjërat në vend, të njihen me miq të rinj, të luajnë bashkë me të tjerët, t'i dëgjojnë me vëmendje ata, të respektojnë të ndryshmit nga ata, të kërkojnë falje, të thonë "fjalët magjike", të mos flasin me zë të lartë, të mos hedhin mbeturina në mjedis etj.

Seria

Pushimet magjike

PUSHIMET MAGJIKE
Tituj: 5 (seri e hapur)
Faqe: 48, me ngjyra
Formati: 205 x 275 mm
Kopertina: me lustër
Çmimi: 2.5 euro

"Pushimet magjike" është një seri librash për pushimet verore për fëmijë nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Këta libra janë hartuar në bazë kurrikulës mësimore, e cila mbështet zhvillimin e kompetencave të fëmijëve. Te këta libra me ushtrime dhe aktivitete, leximi dhe veprimtaritë jepen në mënyrë zbavitëse dhe tërheqëse, duke i nxitur fëmijët të zhvillojnë shkathtësitë e aftësitë e nevojshme dhe të arrijnë objektivat mësimorë për moshën e tyre. Librat përmbajnë ilustrime të këndshme, të përshtatura për çdo grupmoshë të librave.

AVENTURAT TONA TË VERËS 1

Është një fletore pune për fëmijë 6-7-vjeçarë ose që kanë mbaruar klasën e parë, për të punuar gjatë verës.

Me anë të kësaj fletoreje, fëmijët e kësaj grupmoshe rikujtojnë dhe përforcojnë njohuritë e marra gjatë vitit shkollor që lanë pas dhe përgatiten për vitin e ri shkollor që i pret përpara.

AVENTURAT TONA TË VERËS 2

Është një fletore pune për fëmijë 7-8-vjeçarë ose që kanë mbaruar klasën e dytë, për të punuar gjatë verës.

Me anë të kësaj fletoreje, fëmijët e kësaj grupmoshe rikujtojnë dhe përforcojnë njohuritë e marra gjatë vitit shkollor që lanë pas dhe përgatiten për vitin e ri shkollor që i pret përpara.



AVENTURAT TONA TË VERËS 3

Është një fletore pune për fëmijë 8-9-vjeçarë ose që kanë mbaruar klasën e tretë, për të punuar gjatë verës.

Me anë të kësaj fletoreje, fëmijët e kësaj grupmoshe rikujtojnë dhe përforcojnë njohuritë e marra gjatë vitit shkollor që lanë pas dhe përgatiten për vitin e ri shkollor që i pret përpara.

AVENTURAT TONA TË VERËS 4

Është një fletore pune për fëmijë 9-10-vjeçarë ose që kanë mbaruar klasën e katërt, për të punuar gjatë verës.

Me anë të kësaj fletoreje, fëmijët e kësaj grupmoshe rikujtojnë dhe përforcojnë njohuritë e marra gjatë vitit shkollor që lanë pas dhe përgatiten për vitin e ri shkollor që i pret përpara.

AVENTURAT TONA TË VERËS 5

Është një fletore pune për fëmijë 10-11-vjeçarë ose që kanë mbaruar klasën e pestë, për të punuar gjatë verës.

Me anë të kësaj fletoreje, fëmijët e kësaj grupmoshe rikujtojnë dhe përforcojnë njohuritë e marra gjatë vitit shkollor që lanë pas dhe përgatiten për vitin e ri shkollor që i pret përpara.



Seria

Koha e banjës

Produktet e kësaj serie nuk janë thjesht një mjet argëtimi. Ato ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e disa aftësive të fëmijës suaj. Fëmija pasuron fjalorin me fushat përkatëse, si p.sh.: Frutat, Perimet, Kopshti, Deti, Kafshët etj. Po kështu arrin që të formojë të tërën nga pjesëzat e vogla dhe të kuptojë individualisht lidhjen logjike të sendeve në natyrë dhe në mjedisin ku jeton. Duke qenë se materialet e produkteve janë prodhuar për të rezistuar në ujë, koha e banjës për fëmijën kthehet në një moment shumë të bukur e tërheqës, që ai do ta presë me kënaqësi, falë këtyre lodrave.

NDËRTO ANIJEN

Krijo me 3 miqtë e detit

Kafshët pluskojnë në ujë dhe mund të ngjiten në pllakat e banjës, kur janë të lagura. Lodër ideale për t'u argëtuar dhe mësuar.

Çmimi: 1 080 lekë; 7.8 euro; 475 den

KOPSHTI

Luaj me kubin.

6 pjesë pazëlli për kopshtin.

Krijo kubin ose shkëput pjesët dhe vendosi në vaskë.

Çmimi: 1 080 lekë; 7.8 euro; 475 den

NUMËRO 1-10

Mëso numrat në kohën e banjës

Luaj me balonat ku janë ngjitur numrat 1-10. Renditi balonat sipas radhës së numrave. Lodër ideale për t'u argëtuar dhe për të mësuar.

Çmimi: 1 120 lekë; 8 euro; 490 den

NDËRTO TRAKTORIN

Krijo me 6 miqtë e fermës.

Të buta si sfungjer, me shkumë dhe plot ngjyra pjesët e lodrës bëhen më argëtuese.

Çmimi: 1 250 lekë; 9 euro; 550 den

FRUTAT

Luaj me kubin.

6 pjesë pazëlli për frutat.

Krijo kubin ose shkëput pjesët dhe vendosi në vaskë.

Çmimi: 1 080 lekë; 7.8 euro; 475 den

Seria

Baby Montessori

Tituj: 4
Çmimi: 550 lekë; 4.5 euro; 270 den (për libër)

Sa shumë gjëra për të parë në kopsht! Zbulojini së bashku, teksa shfletoni faqet e këtij libri të frymëzuar nga metoda e Maria Montessori-t.

Fëmija juaj mund të vëzhgojë imazhet bardhezi, të zbulojë detajet e vogla të kuqe dhe të nisë eksplorimin e botës.

Ndiqni mësimet e Maria Montessori-t në këtë libër argëtues!

Fëmijët mund të vëzhgojnë imazhet bardhezi, të zbulojnë detajet e vogla të kuqe dhe të nisin eksplorimin e botës.



Sa shumë kafshë për të njohur!

Zbulojini së bashku, teksa shfletoni faqet e këtij libri të frymëzuar nga metoda e Maria Montessori-t.

Fëmija juaj mund të vëzhgojë imazhet bardhezi, të zbulojë detajet e vogla të kuqe dhe të nisë eksplorimin e botës.

Shfletoni së bashku faqet e këtij libri të frymëzuar nga metoda e Maria Montessori-t.

Fëmija juaj mund të gjurmojë shtigjet me gishtin e vet të vogël, mund të vëzhgojë imazhet bardhezi, të zbulojë detajet e vogla të kuqe dhe të nisë eksplorimin e botës.

Seria

Eja ta gjejmë

EJA TA GJEJMË

Tituj: 2
Faqe: 10, me ngjyra
Formati: 220 x 220 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 880 lekë; 6.5 euro; 400 den (për libër)

Seria "Eja ta gjejmë" përmban dy libra mjaft argëtues për fëmijë mbi 1 vjeç.

Lodrat dhe kafshët janë gjërat më të dashura për fëmijët. Duke hapur "dritarëzën" ata gjejnë ku është fshehur lodra dhe çfare ha kafsha nga tingujt gazmorë që dalin prej saj.

KU ËSHTË USHQIMI?

Çfarë hanë fëmijët dhe kafshët? Ndihmojini të vegjlit t'u përgjigjen pyetjeve, duke hapur "dritarezat" me figura në faqet e këtij libri. Kur të hapni "dritarezën" që ka përgjigjen e saktë, ata do të dëgjojnë e do të argëtohen me tingujt e gëzueshëm të kafshës që po ha ushqimin.

KU ËSHTË LODRA?

Ku ndodhet lodra me të cilën po luan fëmija? Ndihmojini të vegjlit ta gjejnë, duke hapur "dritarezat" me figura në faqet e këtij libri. Kur të hapni "dritarezën" që ka përgjigjen e saktë, ata do të dëgjojnë e do të argëtohen me tingujt e gëzueshëm që bën secila lodër.

Seria

Bota e bebes

Librat e kësaj serie janë për fëmijët fare të vegjël. Ata kanë ilustrime të bukura të animuara, të punuara me plastelinë, si dhe tekste të shkurtra, që i ndihmojnë bebet të zbulojnë botën përreth.

Tituj: 6
Faqe: 18, me ngjyra, karton
Formati: 125 mm x 135 mm
Kopertina: me mbushje, e butë
Çmimi: 580 lekë; 4.2 euro; 270 den (për libër)

NGJYRAT

Ky libër shumë natyrshëm i njeh fëmijët me disa kafshë, fruta ose sende të dashura për ta, si dhe i nxit ata të dallojnë, të emërtojnë ngjyrat dhe t'i grupojnë sendet sipas ngjyrave. Nëpërmjet tij, fëmijët mësojnë që çdo gjë ka ngjyrën e vet.

LËVIZJA

Ky libër i njeh fëmijët me gjërat që lëvizin në natyrë dhe mjedisin përreth. Ata mësojnë se kafshët jetojnë në ujë, në ajër dhe në tokë, si dhe përkatësisht notojnë, fluturojnë, zvarriten, kërcejnë, etj. Gjithashtu, ata mësojnë edhe për mjetet e transportit që përdorin njerëzit për të lëvizur në tokë, në ajër e ujë.

LODRAT

Ky libër, përmes ilustrimeve të këndshme, argëtuese dhe didaktike, i njeh të vegjlit me lodra të ndryshme dhe i mëson ata se si të luajnë me to. Në këtë libër, fëmijët do të gjejnë edhe se cila është lodra e tyre më e parapëlqyer.

FRUTAT

Frutat janë aq të dashura dhe aq të ushqyeshme për bebet. Ky libër i njeh ato me disa nga frutat që përdoren më shumë në ushqimin e tyre. Përmes ilustrimeve të bukura, bebet mësojnë të dallojnë ngjyrat e tyre.



NATYRA

Ky libër i njeh bebet me natyrën dhe dukuritë e saj: qiellin, hënën e yjet, shiun, erën dhe ylberin, për gjethet që bien, për pemët, lulet, frutat etj.

TRUPI

Ky libër, i ilustruar me bebe që tregojnë me gisht pjesët e tyre të trupit, i mëson fëmijët të njohin dhe të shqiptojnë pjesët e tyre të trupit, shqisat, si dhe përse shërbejnë ato.

Seria

Vogëlushi -Vogëlushja

VOGËLUSHI-VOGËLUSHJA

Tituj: 8
Faqe: 14, me ngjyra, karton
Formati: 155 x 170 mm
Kopertina: me mbushje, e butë
Çmimi: 670 lekë; 4.8 euro; 310 den (për libër)

Një seri librash shumë e dashur për vajza dhe djem që duan të argëtohen duke imituar të rriturit. Histori për fëmijët që duan t'u ngjajnë heronjve dhe të enden larg me imagjinatën e tyre.



Zjarr! Zjarr! Leoja është gjithnjë i gatshëm të ndihmojë të tjerët me zjarrfikësen e tij të kuqe. Në këtë libër, ai u tregon fëmijëve për profesionin e guximshëm të zjarrfikësit.

Vogëlushja Klara ka shumë dëshirë të kërcejë dhe me kostumin e baletit ngjan si një balerinë e vërtetë. Bashkë me shoqen e saj Lina, ato bëjnë prova për të dhënë një shfaqje para kukullave të tyre. Klara i fton mikeshat e veta të vogla të kërcejnë bashkë me të.



Petri i vogël e kalon tërë ditën mbi traktorin e tij të bukur, duke u marrë me punët e fermës. Libri e fton fëmijën që të mësojë dhe të argëtohet, duke luajtur me Petrin dhe traktorin e tij të verdhë.

Liza e vogël u jep mësim kukullave të saj, njësoj si një mësuese e vërtetë: ajo bën apelin, shkruan me shkumës, pyet dhe jep detyra. Duke luajtur me Lizën dhe kukullat e saj, fëmijët mësojnë për profesionin e mësuesit.

Lola e vogël luan si mama me kukullën e saj. Ajo e shëtit atë në park, i mëson për zogjtë e natyrën, e ushqen, i ndërron pelenën, i bën banjë dhe e vë në gjumë duke i kënduar ninullë. Libri e fton fëmijën që të mësojë dhe të argëtohet, duke luajtur me Lolën dhe kukullën e saj.

Gastonit të vogël i pëlqen shumë të pilotojë. Me avionin e tij ai ngjitet mbi re dhe formon figura në qiell. Në këtë libër tregohet se sa bukur është të drejtosh një avion dhe të fluturosh sipër reve.



Leoja i vogël ka një anije të bukur. Përmes këtij libri tregohet se si një ditë ai niset për peshkim me anijen e tij. Por, për të drejtuar një anije, duhet të jesh një kapiten i zoti dhe të kesh trup atleti!

Nina e vogël vesh uniformën e doktoreshës dhe viziton arush-bebushin si një doktoreshë e vërtetë. I dëgjon frymëmarrjen, i kontrollon veshët, hundët dhe pastaj i bën një gjilpërë. Duke luajtur me Ninën, fëmijët mësojnë profesionin e doktoreshës.

Seria

Libri me maskë

LIBRI ME MASKË

Tituj: 2
Faqe: 10, me ngjyra, karton
Formati: 250 x 250 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 080 lekë; 7.8 euro; 475 den (për libër)

BUBI GJUMASH

Duke vendosur dorën në gojën e bubit gjumash, i cili vetëm do të flejë gjumë, fëmijët argëtohen me historinë e tij. Ai i bën të gjithë të gogësitin dhe t'ju vijë gjumë. Po cilët? Mësojeni këtë duke u argëtuar me librin-lodër.

ROSAKU I URITUR

Historinë e këtij libri mund ta tregoni duke futur dorën në sqepin e rosakut të uritur, i cili është pjesë e këtij libri. Si e gjen ushqimin rosaku i uritur? Mësojeni këtë duke u argëtuar me librin-lodër.

3+ VJEÇ

LIBRA INTERAKTIVË

Seria

Pse, kur, si?

PSE, KUR, SI?

Tituj: 5 (Seri e hapur)

Faqe: 16, me ngjyra, karton

Formati: 180 x 195 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 800 lekë; 7 euro; 420 den (për libër)

Një seri e mrekullueshme për të vegjlit, që u përgjigjet pyetjeve të para të fëmijëve: ***pse?, si?, kur?***.

Ilustrimet e këndshme dhe të përshtatura për moshën e tyre, i ndihmojnë ata të zbulojnë botën që i rrethon, të marrin informacionet që ju nevojiten dhe të argëtohen.

Dritarëze të vogla fshehin ilustrime plotësuese, të cilat pasurojnë situatat me detaje të reja.

Një seri edukative e përgatitur nga specialistë të fushës.



ZJARRFIKËSIT

Pse përdoren makinat e zjarrfikësve?

Si shuhet zjarri?

Kur na ndihmojnë zjarrëfikësit?

LAJ DHËMBËT DHE BËJ ÇIÇIN

Pse duhet t'i laj duart? Kur duhet të shkoj në banjë? Si lahen dhëmbët?



TRAKTORI

Për çfarë i duhet traktori fermerit?

Si e kosit fermeri arën?

Kush ia ndërron gomat traktorit?

SEMAFORËT, RRUGA DHE TRAFIKU

Si të jemi të sigurt në rrugë?

Çfarë janë vijat e bardha?

Si të dallohemi në errësirë?

Seria

Përralla zanore

HIRUSHJA

Përrallën e njohur nga të gjithë "Hirushja", tashmë fëmijët mund ta lexojnë të shoqëruar me tinguj të magjishëm. Duke shtypur një nga një 10 butonët-figura që shoqërojnë tekstin, fëmijët dëgjojnë tinguj argëtues dhe zërat e heronjve të përrallës. Po ashtu, ata mahniten nga ilustrimet e mrekullueshme, që i dërgojnë ata në një botë përrallore e magjepsëse.

PËRRALLAT MË TË DASHURA

Tituj: 2
Faqe: 10, me ngjyra
Formati: 170 x 230 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 850 lekë; 6 euro; 370 den (për libër)

MAÇOKU ME ÇIZME

Përrallën e famshme "Maçoku me çizme" të Sharl Perosë, të ilustruar në mënyrë të mrekullueshme, tani fëmijët mund ta lexojnë të shoqëruar me tinguj të magjishëm. Duke shtypur një nga një 10 butonët-figura që shoqërojnë tekstin, fëmija dëgjon tinguj argëtues dhe zërat e heronjve të përrallës.

PËRRALLA TË ANDERSENIT

Faqe: 18, me ngjyra, karton
Formati: 300 x 295 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 350 lekë; 10 euro; 614 den

PËRRALLA TË ANDERSENIT

Ky libër përmban katër përrallat e mirënjohura të Andersenit: *Mbretëresha e Dëborës; Princesha mbi bizele, Bariu i derrave, Mjellmat e egra.* Në faqet e këtij libri përrallat e dashura marrin jetë. Tani ato mund të lexohen duke u shoqëruar nga tinguj e zëra të mrekullueshëm. Duke shtypur butonët, fëmija dëgjon zërat e personazheve të përrallave, gjithashtu dhe shumë tinguj të tjerë interesantë.

Seria

Libra zanorë

KAFSHËT E MIA

Faqe: 10, karton, me ngjyra

Formati: 190 x 190 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 880 lekë; 6.5 euro; 400 den

Në faqet e këtij libri fëmijët do të takojnë kafshët e mrekullueshme që flasin dhe që kanë dëshirë të luajnë me fëmijët. Fëmijët, jo vetëm që mund të dëgjojnë zërat e tyre, por edhe mund t'i prekin ato.

INSEKTET PUNËTORE

Faqe: 10, karton, me ngjyra dhe figura të lëvizshme

Formati: 190 x 230 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 980 lekë; 7 euro; 430 den

Ky libër i njeh fëmijët me insektet punëtore, të cilat nuk rrinë dot pa punuar. Fëmija argëtohet duke i lëvizur insektet në rrugëzat e tyre, si dhe duke dëgjuar nga një histori për secilën prej tyre.

LODRA IME MË E DASHUR

Faqe: 14, karton, me ngjyra

Formati: 195 x 235 mm

Kopertina: me mbushje, e butë

Çmimi: 1 300 lekë; 9.5 euro; 580 den

Ky libër përmban vjershat më të bukura për lodrat e dashura të fëmijëve. Ato shoqërohen me ilustrime magjepsëse nga bota e lojërave. Duke shtypur butonin pranë figurës përkatëse, fëmija do të dëgjojë vjershën për lodrën e tij të preferuar. Vjershat janë të thjeshta, me rimë të përshtatshme për këtë moshë, si dhe shoqërohen me melodi fëminore.

TABELA E ZGJUAR

Faqe: 14, karton, me ngjyra

Formati: 315 x 275 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 1500 lekë; 11 euro; 650 den

Kjo është një enciklopedi moderne me një tabletë inteligjente për fëmijët! Përmban njohuri interesante rreth kafshëve të fermës. Fëmijët mund ta heqin tabletën lehtësisht nga libri dhe mund të luajnë me të!

ORA FOLËSE

Faqe: 10, karton, me ngjyra

Formati: 260 x 220 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 1 000 lekë; 7 euro; 420 den

Çdo ditë nise me këtë orë të zgjuar e shumëngjyrëshe. Vendose në kyçin e dorës dhe shtyp butonat, për të dëgjuar tingujt qesharakë dhe meloditë. Ajo të mëson që të tregosh orën dhe njëkohësisht të kujton se çfarë ke për të bërë.

MOS KI FRIKË, NUK KE GRIP!

Faqe: 12, karton, me ngjyra

Formati: 265 x 240 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 1 050 lekë; 7.2 euro; 440 den

Ju fëmijë do ta pëlqeni shumë këtë doktor. Ai është aq i dashur me pacientët e tij të vegjël. Ndihmojeni doktorin duke përdorur stetoskopin magjik.

3+ VJEÇ

LIBRA INTERAKTIVË

Seria

Miushi Magjik

MIUSHI MAGJIK

Tituj: 5 (seri e hapur)

Faqe: 12, me ngjyra, karton

Formati: 200 x 290 mm

Kopertina: me mbushje

Çmimi: 1 250 lekë; 9 euro, 550 den (për libër)

Kjo seri me libra elektronikë përfshin një tematikë të gjerë për fëmijët e moshës 3-4 vjeç, ku jepen njohuritë fillestare për shkronjat e fjalët, numrat, kafshët, natyrën e mjedisin përreth.

Me një miush magjik që lëshon tinguj dhe dritë, fëmija ndihmohet për përgjigjet e sakta. Nëse fëmija përgjigjet saktë do të ndizet drita e gjelbër dhe do të dëgjojë melodinë:

Ta ra ra ta taaaa!

Por nëse gabon, do të ndizet drita e kuqe dhe dëgjohet:

Oooohhhhh!



MËSOJ NUMRAT

NJOH KAFSHËT



NJOH NATYRËN



ENCIKLOPEDIA IME E PARË

FJALËT E MIA TË PARA

Seria

Libri që flet



ABETARJA E PARË ZANORE NË GJUHËN SHQIPE

Faqe: 18, me ngjyra
Formati: 280 mm x 300 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1500 lekë; 11 euro; 650 den

Duke shtypur butonët zanorë, fëmijët dëgjojnë shkronjat, fjalët e fjalitë dhe i mësojnë ato në mënyrë argëtuese. Në libër ata do të gjejnë situata me personazhe nga bota e kafshëve, të ilustruara plot ngjyra e fantazi.

EKSPLORUESI I RREZEVE X

Faqe: 12, me ngjyra, karton
Formati: 280 mm x 300 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 950 lekë; 6.7 euro; 400 den

A do të shohësh se si luftonin dinozaurët me njëri-tjetrin? A do të shohësh gatopardin të vrapojë, karkalecin të hidhet dhe lakuriqin e natët së fluturojë?

Atëherë ndiz skanerin e vogël dhe hap librin! Ky skaner i veçantë do të të ndihmojë të zbulosh sekretet e natyrës!

RRETH BOTËS PËR TË VEGJLIT

Faqe: 16, me ngjyra, karton
Formati: 280 mm x 300 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 250 lekë; 9 euro; 540 den

Libri **"Rreth botës për të vegjlit"** e udhëheq fëmijën në një udhëtim në vende të ndryshme të botës, duke e ftuar të bëhet shikues i korridës spanjolle, të realizojë safarin afrikan, të njihet me kaubojtë dhe indianët, të rrëshqasë me slitën, ku janë mbrehur qentë eskimezë dhe të udhëtojë me gondolën veneciane. Fëmija pasuron fjalorin me fjalë të veçanta e karakteristike të këtyre vendeve. Duke shtypur butonët zanorë që gjenden pranë figurave, ai njihet me melodi të dhe tingujt e çuditshëm të vendeve të ndryshme, që të çojnë në skajet më të largëta të planetit tonë.

BOTA RRETH NESH

Faqe: 16, me ngjyra, karton
Formati: 280 mm x 300 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1400 leke; 10 euro 600 den

Libri **"Bota rreth nesh"** i njeh fëmijët me gjithçka që ndodhet në Tokë: qytetin e zhurmshëm dhe fermën e gëzueshme, pyjet e gjelbra, savanat dhe xhunglat, detet dhe oqeanet, malet, polet... Duke shtypur butonët zanorë që gjenden pranë figurave, fëmijët njihen dhe argëtohen me zërat e kafshëve dhe tingujt e natyrës në skajet më të largëta të botës.

TRUPI IM

Faqe: 12, me ngjyra, karton
Formati: 280 mm x 300 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 350 lekë; 10 euro; 614 den

Ky libër i njeh fëmijët me pjesët e trupit dhe si funksionon organizmi ynë. Duke e shfletuar këtë libër fëmijët zbulojnë për sekretet e trupit të tyre, mësojnë për skeletin, zemrën dhe gjakun, frymëmarrjen, tretjen, urinimin, nervat, shqisat etj. Duke shtypur butonët, fëmijët do të argëtohen duke dëgjuar tingujt e gëzuar, si dhe do të pasurojnë fjalorin duke dëgjuar fjalët.

Seria Dinozaurët

DINOZAURËT

Tituj: 4

Faqe: 36, me ngjyra

Formati: 240 x 240 mm

Kopertina: e plastifikuar, 350 g.

Çmimi: 550 lekë; 4 euro; 250 den (për libër)

Personazhi i serisë **"Dinozaurët"** është një djalë i vogël, i cili në fund zbulon se dinozauri për të cilin po flet, është lodra e tij e dashur, me të cilën ai fle çdo natë. Teksti nxit imagjinatën e lexuesit të vogël, por edhe i mëson atij karakteristikat e veçanta të llojeve të dinozaurëve, kuriozitete rreth mënyrës së ushqimit, jetës dhe të dhëna rreth zbulimit të fosileve të tyre nga shkencëtarët.

Libri **"Tiranozauri Reks – mbreti i dinozaurëve"** flet për këtë lloj dinozauri dykëmbësh mishngrënës, emri i të cilit ka kuptimin "mbreti më tiran i zvarranikëve". Për të thuhet se ka qenë kafsha më e madhe që ka jetuar në Tokë dhe se mund ta kthente kokën nga të gjitha drejtimet.

Libri **"Stegozauri – dinozauri më miqësor"** flet për këtë lloj dinozauri katërkëmbësh barngrënës, emri i të cilit do të thotë "zvarranik me çati". Ai dallohej lehtësisht prej dy rreshtave me pllakëza mbi kurriz. Në fillim atë e quanin "dinozauri budalla", për shkak të trurit të tij të vogël sa një arrë.



Libri **"Triceratopsi - dinozauri më i fortë"** flet për këtë lloj dinozauri katërkëmbësh barngrënës, emri i të cilit ka kuptimin "fytyra me tri brirë". Mendohet të ketë qenë dinozauri i fundit që eci mbi Tokë dhe se ishte shumë i shpejtë.



Libri **"Brakiozauri – dinozauri më i madh"** flet për këtë lloj dinozauri katërkëmbësh barngrënës, emri i të cilit ka kuptimin "zvarraniku me krahë të degëzuar". Ai mendohet se ka qenë aq i madh, sa hante deri në 200 kilogramë bimë në ditë dhe se jetonte deri në 100 vjet.

Seria

Klasikët e mi të parë

Përrallat më të bukura të të gjitha kohërave, që të lexohen para gjumit dhe t'i bëjnë fëmijët të ëndërrojnë.

34 rrëfime të mrekullueshme që të futin në një botë fantastike dhe plot imagjinatë.

KLASIKËT E MI TË PARË

Faqe: 586, me ngjyra
Formati: 150 x 200 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 2400 lekë; 20 euro; 1200 den

HISTORI KLASIKE

Libri u drejtohet lexuesve fillestarë dhe i fut ata në botën magjike të përrallave klasike më të njohura.



PËRRALLA PËR TË ËNDËRRUAR

Libri përmbledh përrallat më të mira të autorëve klasikë, si: Anderseni, Vëllezërit Grim dhe Ezopi.

PËRRALLA KLASIKE

Libri përmbledh rrëfimet më të bukura të letërsisë për fëmijë të shek. XIX.

Seria

Sjelljet më të mira

SJELLJET MË TË MIRA

Tituj: 4
Faqe: 36, me ngjyra
Formati: 240 x 240 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 550 lekë; 4 euro, 250 den (për libër)

Tekste të thjeshta me ilustrime të këndshme dhe plot ngjyra i drejtojnë fëmijët te veprimtaritë paqësore dhe sjelljet e mira. Fëmijët gjithmonë dëshirojnë të dinë çfarë duhet të presin ose çfarë do të ndodhë në situata të ndryshme dhe kur shkojnë në vende të caktuara.

BEBUSHI ERDHI NË SHTËPI

Lindja e një fëmije mbetet një ngjarje e madhe për çdo familje. Ky libër përshkruan etapat e para dhe përvojat e reja të një vogëlushi ose vogëlusheje përgjatë ardhjes dhe rritjes së bebes në shtëpinë e tij/e saj. Libri synon, gjithashtu, të tregojë se ç'ndodh ndërsa bebja rritet dhe nis të zbulojë botën përreth. Në fund të librit do të gjeni dhe disa vargje argëtuese për të vegjlit, si dhe një udhëzim për të rriturit.

MOS U ZEMËRO!

Nëpërmjet fjalëve të thjeshta dhe ilustrimeve të bukura plot me ngjyra, ky libër synon t'u mësojë fëmijëve të dallojnë sjelljet e mira nga ato jo të mira e të zgjedhin çdo ditë në këtë dyshe sjelljeje, atë që është më paqësorja.

Me ndihmën e këtij libri, ata do të kuptojnë se dhuna nuk është asnjëherë gjë e mirë dhe që me duart, këmbët dhe buzët e tyre, ata mund të bëjnë gjëra shumë herë më të mira sesa të gjuajnë me shkelma apo të shajnë. Madje dikush është i aftë edhe të arsyetojë e t'i vërë fre zemërimit e inatit të tij. Ky libër u mëson më të vegjëlve se duhet të jenë të aftë që të kërkojnë falje, kur i bëjnë keq dikujt tjetër.

UNË KUJDESEM PËR GJËRAT E MIA

Personazhi kryesor është mësuar t'i hedhë gjërat e tij sa andej-këtej. Por një natë, kur ikën dritat, ai i kërkoi më kot lodrat që donte në errësirën e dhomës dhe nuk gjeti asgjë. Atëherë vogëlushi zbuloi se sa e rëndësishme është të kujdesej për gjërat e veta. Kjo do të thotë që ato duhet t'i sistemojë dhe t'i riparojë vazhdimisht, në mënyrë që të rrojnë sa më gjatë.

Siç kujdesemi për dhomën apo për shtëpinë tonë, ashtu duhet të kujdesemi edhe për mjedisin, planetin, për bimët, lulet dhe kafshët, veten dhe të tjerët.

DITA IME E PARË E SHKOLLËS

Fillimi i vitit të ri shkollor është një etapë që mund të shqetësojë shumë fëmijë, vajza e djem, veçanërisht ata që shkojnë për herë të parë në shkollë. Ky libër, përmes përshkrimit të situatave të këndshme e argëtuese, synon që t'u heqë fëmijëve shqetësimin për ditën e parë të shkollës, duke i inkurajuar atë për këtë ditë të veçantë të jetës së tij. Në fund të librit ka disa aktivitete për vajza e djem, si dhe një udhëzues për të rriturit.

Seria

Me pak fjalë

ME PAK FJALË

Tituj: 8

Faqe: 30, me ngjyra

Formati: 230 x 255 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 500 lekë; 4 euro, 250 den (për libër)

ME PAK FJALË

Është një koleksion librash që u shërben fëmijëve duke filluar nga mosha 3-vjeçare. Materiali nxit kureshtjen përmes njohurive të thjeshta dhe argëton, pa u shmangur nga qëllimi kryesor: zhvillimi i një sërë aftësish të rëndësishme, që fëmijët duhet të zotërojnë përpara se të fillojnë shkollën.

Nëpërmjet këtyre librave realizohet:

- kuptimi dhe përdorimi i fjalëve të reja;
- dëgjimi i tingujve të gjuhës së folur;
- lidhja e tingujve me shkronjat për deshifrimin e kodit të leximit;
- njohja dhe mësimi i shkronjave të alfabetit;
- dëgjimi dhe kuptimi i pjesës së lexuar dhe përgjigjja e pyetjeve;
- zhvillimi dhe kultivimi i vëmendjes dhe i përqendrimit.



PROFESIONET



SHKOLLA

SHQISAT



SHTËPIA



BIMËT



QYTETI



UDHËTIMI



KAFSHËT

Në fund të faqes së djathtë të çdo libri ka një pyetje të thjeshtë dhe argëtuese, së cilës fëmija, vetë apo i ndihmuar nga ndonjë i rritur, duhet t'i përgjigjet për të zbuluar personin apo objektin e fshehur.

Seria Miushi lexues

MIUSHI LEXUES

Tituj: 19
Faqe: 24, me ngjyra
Formati: 190 x 190 mm
Kopertina: e butë
Çmimi: 350 lekë; 2.5 euro; 150 den (për libër)

Është një seri librash për vajza dhe djem të moshës mbi 3 vjeç. Librat tregojnë ndodhitë e dy personazheve, Konit dhe Maksit, ndërkohë që ata zbulojnë si botën përreth, ashtu edhe aftësitë e tyre.

KONI FITON MEDALJEN E NOTIT

Koni mëson të notojë. Nuk është aq e thjeshtë të lëvizësh këmbët dhe krahët për të qëndruar mbi ujë. Por, ama, Koni ia del mbanë dhe fiton edhe medaljen "Kali i detit". Një libër për të gjithë fansat e Konit dhe adhuruesit e notit.

KONI LUAN FUTBOLL

Koni nuk humbet asnjë orë stërvitjeje, që kur bën pjesë në një ekip futbolli. Aty ajo mëson çdo gjë rreth futbollit. Ajo mezi po pret të luajë në një ndeshje të vërtetë, por papritur sëmuret. A do të shërohet në kohë për të luajtur dhe a do ta përballojë dot lojën?

KONI BËN NJË UDHËTIM

Koni dhe familja e saj bëjnë një udhëtim. Edhe gjyshërit dhe kushëriri i saj, Mikeli, janë sigurisht me to. Një shëtitje në pyll, piknik në fushë, akullore dhe udhëtim me tren. Një ditë me të vërtetë e bukur! Deri kur Koni humb arushin e saj...

SERIA PËR VAJZA

KONI BËN PICA

Mami ka gatuar pure patatesh me spinaq. Konit nuk i pëlqen fare dreka, ndaj vendos të gatuajë vetë. Së bashku me shokun e saj, Simonin, ata bëjnë pica shumë të shijshme. Një aventurë e re për Konin, por edhe për fëmijët që pëlqejnë t'i bëjnë vetë picat, duke lexuar udhëzimet në fund të librit.

KONI MËSON TË KËRCEJË

Koni shkon në një kurs baleti. Sa qejf është të kërcesh bashkë me fëmijët e tjerë, të hidhesh si mace dhe të lëvizësh nën ritmin e muzikës! Koni dhe grupi i baletit kërcen në një shfaqje të vërtetë para spektatorëve...

KONI NUK KA MË FRIKË NGA VIRUSI

Koni nuk mund të shkojë në kopsht, as të takojë miqtë. Po ashtu dhe gjyshërit. Duhet të lajë duart shumë shpesh. Kjo situatë është shumë e pazakontë. Por koha në shtëpi mund të kalohet bukur duke bërë aktivitete, si: duke gatuar, duke luajtur, duke kërcyer dhe duke bërë gjimnastikë. Të gjitha këto veprimtari janë shumë argëtuese.

KONI SHKON NË FLOKTORE

Koni luan "floktoresh". Por biguditë me lapsa dhe çamçakëz kanë ngecur keq te flokët. Këtë punë e zgjidh vetëm gërshëra. Por ajo nuk ka qenë kurrë më parë në floktore. A të dhemb kur i pret flokët?

KONI FESTON DITËLINDJEN!

Gëzuar, Koni! Më në fund erdhi dita e shumëpritur! Koni hap dhuratat e saj të ditëlindjes dhe ha ushqime që i pëlqejnë. Por, gjëja më e bukur do të jetë festa e saj. Ajo e feston ditëlindjen edhe në kopsht, edhe në shtëpi me miqtë e saj.

KONI DHE FESTA E KOPSHTIT

Kopshti i Konit po planifikon festën e verës, me gatime dhe lojëra të mrekullueshme. Ata do të vënë në skenë pjesën teatrore "Borëbardha dhe shtatë xhuxhët". Por kush do ta luajë Borëbardhën: Koni, Jolanda apo Julia? Provat dhe shfaqja janë mjaft emocionuese. Borëbardha e përrallës së tyre ishte shumë të veçantë. Në fund, të gjithë festojnë dhe argëtohen shumë, bashkë me prindërit.

KONI SHKON ME PUSHIME

Koni bashkë me familjen shkojnë me pushime në Detin e Veriut. Ajo mezi pret të luajë me valët e detit. Atje njeh një shoqe e re, me të cilën kalon çaste të bukura. Por një ditë, në breg sheh një bebe fokë të braktisur. Ata duhet të gjejnë patjetër mamanë e saj. Në fund, pushimet verore janë vërtet të mrekullueshme!

KONI SHKON NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK

Koni shkon në ekskursion me shkollën. Ata shkojnë te kopshti zoologjik! Atje ka shumë gjëra për të parë e për të mësuar. Nga e njeh mamaja zebër të voglin e saj? Çfarë hanë merkatët? A hanë majmunët vetëm banane? Papritur, një pandë e kuqe arratiset nga kafazi... Çfarë bëjnë fëmijët në këtë rast? Mësojeni duke lexuar këtë histori!

SERIA PËR VAJZA

SERIA PËR DJEM



MAKSI FLE TE SHTËPIA E PAULINËS

Urra! Maksit i japin leje të flejë një natë te shtëpia e Paulinës. Ai bën gati çantën sa hap e mbyll sytë: pizhamet, furçën e dhëmbëve dhe, sigurisht, elektrikun e dorës. Por, a mund të flejë Maksi pa puthjen e "natës së mirë"?!

MAKSI MËSON BIÇIKLETËN

Gati!? NISU! Maksi merr vrull me biçikletën e tij lodër. Por tani ai është rritur. Maksit i nevojitet një biçikletë e vërtetë! Bashkë me mamin, ai vendos të rregullojë biçikletën e vjetër të vëllait të tij, Feliksit. Pastaj duhet të mësojë, mësojë, mësojë... Dhe, shumë shpejt, Maksi fillon të marrë kthesat e para.

MAKSI DHE DHËMBI I QUMËSHTIT

Për të qenë një superpërbindësh i vërtetë, duhet të keni dhëmbë që ju kanë rënë. Sa keq që Maksi ka vetëm një dhëmb, që është duke i rënë. Dhëmbi nuk bie që nuk bie... Nuk ndihmojnë as këshillat e Feliksit dhe as takimi me dentisten. Kështu, Maksi vendos të presë, kur papritur... fiu! Në vend të dhëmbit mbetet një gropë!

MAKSI NDËRTON NJË ANIJE PIRATËSH

Maksi dhe Paulina ndërtojnë një anije piratësh, ama prej vërteti. Por nuk është dhe aq e thjeshtë. Për fat të mirë, në garazh gjejnë materialet që u duhen, për të ndërtuar "tmerrin e deteve"...



MAKSI BËHET KAMPION FUTBOLLI

Maksi dhe Paulina luajnë futboll. "Gol!" thërret Maksi. "Ne jemi kampionë bote!". Por fqinjit të tij, Timit, i duket se më të fortët në futboll janë ai dhe shokët e tij. Kështu, ata vendosin të bëjnë një ndeshje futbolli mes dy skuadrave. Kush do ta fitojë "Kupën e Botës"?!



MAKSI SHKON TE DOKTORI

Maksi ka ethe. Prandaj ai nuk ka shkuar dot në kopsht. Mami e çon për ta vizituar te mjeku pediatër. Doktor Aleksi i kontrollon Maksit grykët, sytë, veshët... Pasi e vizitoi, në fund kuptoi se Maksi ishte ftohur! Për këtë, pikat në hundë e ndihmojnë shumë. Shumë shpejt Maksi shërohet dhe kthehet në kopsht! Mirëpo atje mungon Paulina? Mos vallë edhe ajo ishte sëmurë? Këtë mësojeni në këtë libër të këndshëm!

MAKSI MËSON TË NOTOJË

Shoqja e ngushtë e Maksit, Paulina, sapo ka marrë medaljen "Kali i detit". Edhe Maksit do t'i pëlqente të mësonte notin. "Ti nuk e merr dot atë medalje, se nuk je adhurues i ujit", - i thotë vëllai i tij i madh. Tani i takon Maksit të tregojë ç'është i aftë të bëjë!

MAKSI DO NJË LEPURUSH PREJ VËRTETI

- Unë jam gati katër vjeç! - thërret Maksi. Dhe mendon se kushdo që bën 4 vjeç, mund të dëshirojë një lepurush prej vërteti për ditëlindje. Por... duhet të nxitojë, sepse lepurushi i zi më i bukur në botë mund t'i shitet dikujt tjetër...

Seria Ariu i Bardhë i Ëndrrave

MIUSHI LEXUES

Tituj: 3

Formati: 240 x 200 mm

Kopertina: e plastifikuar, me lustër

Çmimi: 450 lekë; 3 euro; 200 den (për libër)

Udhëtime imagjinare nëpër ëndrra, dëshira të realizuara dhe shumë argëtim... Në çdo libërth të kësaj serie, Ariu i Bardhë i Ëndrrave i rrëfen nipit të tij, Polo, historinë e një vogëlushi a vogëlusheje që i realizohet një dëshirë.

SAMUELI DHE VIOLINA PREJ REJE

Faqe: 18, me ngjyra

Samueli dëshironte me gjithë zemër të kishte një violinë të vërtetë. Mezi po priste ditëlindjen e tij, që prindërit t'ia dhuronin atë. Por, atë ditë askush nuk u kujtua për dëshirën e tij dhe Samueli shkoi në shtrat i mërzitur. Kur u zgjua në mëngjes, pa pranë shtratit një kuti me një violinë brenda. Ëndrra e tij ishte realizuar. Po si ishte e mundur kjo?

Pas historisë së Samuelit dhe violinës prej reje dhe Aurorës dhe fustanit shumëngjyrësh na presin shumë të tjera edhe më të bukura. Kjo seri nxit imagjinatën dhe fantazinë e lexuesit të vogël nëpërmjet ilustrimeve tërheqëse dhe plot ngjyra.

AURORA DHE FUSTANI SHUMËNGJYRËSH

Faqe: 26, me ngjyra

"Aurora dhe fustani shumëngjyrësh" tregon për dashurinë dhe pasionin e një vajze të vogël për t'u bërë balerinë. Mirëpo një natë para shfaqjes Aurora nuk kishte fustan... E dëshpëruar u shtri për të fjetur dhe në ëndrrën e saj erdhi Ariu i Bardhë. Lundroni edhe ju, bashkë me Aurorën, në ëndrrat, dëshirat dhe pasionet e saj.

JONI, KALTRA DHE SHTËPIZA PREJ AKULLOREJE

Faqe: 26, me ngjyra

Joni dhe Kaltra dëshironin shumë të shkonin te gjyshi në fshat. Atje kalonin pushimet më të bukura.

Ata dëshironin shumë të kishin një shtëpizë prej druri në pemë. Gjyshi ishte përpjekur një vit më parë, por e kotë!

Një ditë, kur u zgjuan nga gjumi, mbi pemë panë një shtëpizë prej druri të mrekullueshme!

Kush e kishte ndërtuar vallë atë?

Seria Numrat e jetës

NUMRAT E JETËS

Tituj: 6

Faqe: 46, me ngjyra

Formati: 240 x 240 mm

Kopertina: e plastifikuar, 350g

Çmimi: 550 lekë; 4 euro, 250 den (për libër)

Nëpërmjet numrave, me të cilët ndërtohen titujt e serisë, u mësojmë fëmijëve t'i kushtojnë vëmendje botës që i rrethon dhe të kujdesen për të. Ne duhet të kujdesemi për planetin tonë, të cilin e ndajmë me qeniet e tjera të gjalla, deri në fund të jetës sonë. Kjo është një nismë e re, që i nxit fëmijët të kuptojnë shkencën nga përvojat e tyre të para.



1 PEMA E FAMILJES

Pema e familjes është një skemë që tregon paraardhësit. Ata janë njerëz të familjes sate, që kanë lindur para teje. Këta njerëz janë të veçantë, sepse janë pjesë e jetës dhe e historisë sate personale. Pikturo pemën e familjes dhe ngjiti fotografitë e pjesëtarëve të saj në degë të ndryshme. Vendosi më të vjetrit në majë dhe më të rinjtë në degët më poshtë. Veten, vëllezërit dhe motrat, nëse ke, vëri në pjesën e poshtme. Poshtë secilit shkruaj emrin përkatës. Kështu, ti ke bërë pemën e familjes sate.

2 NGA SE PËRBËHEN GJËRAT?

Karamelet bëhen prej sheqeri, ndërsa sheqeri bëhet prej bimëve. Trikoja jote mund të jetë bërë me leshin e deles, ndërsa shumë ura janë bërë me gurë. Disa gjëra ne i bëjmë duke i marrë lëndët drejtpërdrejt nga natyra, disa të tjera janë të bëra prej lëndëve artificiale. Gjërat që përdorim çdo ditë, janë të përbëra prej të gjitha llojeve të materialeve: dru, letër, metal, qelq, lesh, çimento, si dhe prej shumë e shumë materialeve të tjera. Por, ne gjithmonë duhet të përdorim materialin e duhur për t'i bërë gjërat. A mund ta imagjinosh sikur ky libër të ishte bërë prej metali? Nuk do të ishte shumë i lehtë për t'u përdorur, apo jo?



3 R-TË: RIPËRDORIM, REDUKTIM, RICIKLIM

Tri R-të na mësojnë shumë gjëra që ne mund të bëjmë për të mbajtur pastër mjedisin. Kur ulim sasinë e gjërave që hedhim, si për shembull qeset plastike, ne ndihmojmë në mbajtjen pastër të mjedisit ku jetojmë, të ujit që pimë apo të ajrit që thithim. Gjithashtu, përdorimi i objekteve vetëm kur është e nevojshme është një ide e mirë. Dhe ne mund të riciklojmë gjëra, si për shembull, letrat, kanoçet, shishet duke i çuar në impiantet e riciklimit të mbeturinave, nëpërmjet përpunimit të të cilave mund të prodhohen objekte të reja. Mbajini mend mirë këto tri fjalë që fillojnë me R; është mënyra më e mirë për të mbrojtur planetin në të cilin jetojmë.

4 ELEMENTET

Djemtë dhe vajzat në këtë libër zbulojnë katër elementet bazë: ajrin, tokën, ujin dhe zjarrin. Fëmijët mësojnë se si secila prej tyre, së bashku, luan një rol jetësor në veprimtaritë e njerëzve. Dy faqet e fundit të këtij libri të mrekullueshëm përmbajnë një udhëzues për prindërit.

6 SI LËVIZIM?

Përpara se bebet të mësojnë të ecin me të dyja këmbët, ato fillojnë të lëvizin këmbadorazi. Fëmijët, të cilët e kanë të pamundur të lëvizin pa ndihmë, përdorin patericat ose lëvizin me karrige me rrota. Disa njerëz, kur plaken, përdorin shkopin, i cili i ndihmon për të ecur më lehtë - që afërsisht është si të jesh me tri këmbë. Shumë kafshë ecin me 4 këmbë, insektet ecin me 6 këmbë, merimangat me 8 këmbë. Shumë kafshë dhe insekte fluturojnë si zogjtë, p.sh., mollëkuqet dhe fluturat. Duke shfletuar faqet e këtij libri mund të zbulosh se në sa shumë mënyra lëvizin nga njëri vend në tjetrin kafshët e planetit tonë.

5 SHQISAT

Në këtë libër djemtë dhe vajzat zbulojnë pesë shqisat e tyre: të parit, të dëgjuarit, të nuhaturit, të prekurit dhe të shijuarit. Ata kuptojnë se sa e bukur duket bota nëpërmjet funksionimit të shqisave në harmoni me njëra-tjetrën. Nëpërmjet tyre çdo fëmijë mund të shijojë një kek të mirë, mund të dëgjojnë një muzikë të bukur, mund të shohë ngjyrat e ylberit e të tjera. Dy faqet e fundit të librit përmbajnë një udhëzues për prindërit.

Seria

Le të flasim hapur

LE TË FLASIM HAPUR

Tituj: 12 (seri e hapur)
Faqe: 36, me ngjyra
Formati: 240 x 240 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350g
Çmimi: 550 lekë; 4 euro (për libër)

Edhe fëmijët shumë të vegjël kanë shqetësimet, frikërat e tyre, prandaj këta libra janë shkruar dhe janë ilustruar veçanërisht për ta. Prindërve dhe mësueseve u këshillohet t'i lexojnë këta libra me zë të lartë, ndërsa parashkollorët të dëgjojnë dhe të shikojnë ilustrimet me djem dhe vajza të çdo tregimi. Shumë fëmijë, në klasat e ulëta, mund t'i lexojnë vetë këto tregime.

Le të flasim hapur!

Kjo seri i nxit fëmijët të zbulojnë ndjenjat e tyre dhe të flasin hapur për gjërat që ata i shqetësojnë.

ATË DITË KUR HUMBA DHE MË GJETËN

Të humbësh në një vend publik, ku të duket e pamundur që mami dhe babi të të gjejnë, është e frikshme dhe e rrezikshme. Një përvojë të tillë mund ta kalojë edhe fëmija më i vogël i familjes.

Libri **"Atë ditë kur humba dhe më gjetën"** tregon historinë e një vajze që humbet në një panair. Ajo qan dhe e kap paniku. Vajzën e ndihmon një polic, i cili e çon në një qendër, ku kujdesen për fëmijët e humbur. Pas pak, atje mbërritën mami dhe babi dhe të gjithë u ndien të lumtur.

Ky libër i nxit fëmijët dhe prindërit të caktojnë një vend takimi, sa herë shkojnë në një vend të madh.

BABI DO TË MARTOHET

Fëmijët me prindër të divorcuar ndonjëherë çorientohen dhe shqetësohen, veçanërisht kur njëri nga prindërit vendos të rimartohet.

Libri **"Babi do të martohet"** tregon historinë e një vajze, prindërit e së cilës janë divorcuar. Por ndërkaq, babi po martohet me dikë tjetër. Si ndihet vajza për këtë? Zakonisht, kur njëri nga prindërit martohet, fëmija ndihet i turbulluar. A duhet të gëzohet? A duhet të mërzitet? Mos prindi po e braktis?

Ky libër i bën vajzat dhe djemtë të kuptojnë se, edhe pse prindërit rimartohen, ata përsëri do të vazhdojnë t'i duan dhe t'i takojnë ata.

KUR MAMI DHE BABI HARRUAN TË ISHIN MIQ

Prindërit e mi dikur ishin shumë miq dhe unë ndihesha e lumtur. Ne çdo gjë e bënim së bashku. Më pas, gjërat filluan të ndryshonin. Prindërit e mi ishin gjithnjë të mërzitur me njëri-tjetrin dhe vetëm grindeshin. Nisa të mendoja se ishte faji im që prindërit e mi nuk ishin më shokë; por tani e kuptoj se është më mirë që secili të jetojë në shtëpi më vete. Çfarëdo që të ndodhë, mami dhe babi im do të jenë prindërit e mi... dhe, për më tepër.... ata gjithmonë do të më duan.

A JE I TURPSHËM?

Fëmijët të cilët janë të turpshëm, shpesh janë të shqetësuar dhe ndihen të keqkuptuar.

Libri **"A je i turpshëm?"** i ndihmon djemtë dhe vajzat të kuptojnë se ka shumë mënyra me të cilat ata të kapërcejnë ndjenjën e turpit. Ata nuk duhet të vihen në siklet, nëse u mbahet goja ose nëse skuqen kur pyesin për diçka. E rëndësishme është që ata të shprehin hapur mendimin e tyre.

Libri "A je i turpshëm?" i ndihmon fëmijët të kuptojnë se ndjenja e turpit do të zhduket pak nga pak, nëse ata përpiqen të shprehin atë që mendojnë.

EDHE MAMI PUNON!

Të gjitha mamatë punojnë. Sido të jetë rasti, edhe nëse një mama zgjedh të punojë për shkak të problemeve financiare apo se ajo do të ndihet e plotësuar si grua në punën e saj, të gjitha këto arsye fëmija duhet t'i njohë, që të mos i vlerësojë si të gabuara. E rëndësishme është që asnjë arsye nuk duhet gjykuar si e mirë apo e keqe; ajo duhet matur me dobinë që sjell puna e prindit në shtëpi. Pikërisht këtë kuptim synon ky libër.

A KE NDONJË SEKRET?

Sa mirë është të mbash një sekret... Por nëse ky sekret të bën të ndihesh mirë ty dhe dikë tjetër, ky është një sekret i mirë. Por, nëse ke ndonjë sekret që ty të mundon... një sekret që të shqetëson ose të frikëson... është më mirë t'ia thuash dikujt që ti i beson. Mund të jetë pak e vështirë t'ia rrëfesh atë mamit, babit ose mësueses. Por, është mirë të bëhesh trim dhe t'ia thuash. Sapo ta bësh këtë, do të ndihesh më mirë.

VËLLAI IM ËSHTË AUTIK

Të rritesh në një familje me një fëmijë me autizëm mund të jetë e vështirë, por pjesa më e madhe e familjeve përpiqen ta kalojnë këtë sfidë. E rëndësishme është që fëmijët, vëllai ose motra, të kuptojnë sa më shpejt problemet që kanë lindur dhe të zbulojnë se dashuria, durimi dhe sensi i humorit, janë aftësi jetësore të qenësishme, të cilat do t'u hyjnë atyre në punë gjatë gjithë jetës.

Ky libër tregon për një djalë, vëllai i të cilit, Beni, është me autizëm. Kur ai vihet në vështirësi nga sjelljet e tij në sy të shokëve të klasës, i kërkon mësueses t'u flasë atyre për autizmin. Me ndihmën e mësueses, fëmijët mësuan se shumë njerëz me këtë sëmundje kanë zhvilluar aftësitë e tyre të veçanta, duke u ndier të vlefshëm e të vlerësuar.

KUJTOJ QENIN TIM

Ne lindim, jetojmë dhe pastaj vdesim. E njëjta gjë ndodh edhe me kafshët shtëpiake.

Libri "Kujtoj qenin tim" na njeh me dashurinë dhe gëzimin që kemi për një kafshë shtëpiake dhe më pas trajton përballjen me humbjen e saj, e cila është e dhimbshme për të gjithë familjen, por sidomos për fëmijët.

Vdekja e kafshës shtëpiake është përgjithësisht, përvoja e parë kur fëmijët ndeshen me dukurinë e vdekjes. Një ndodhi kaq tronditëse shkakton te fëmijët një mori ndjenjash, të cilat ata nuk arrijnë t'i kuptojnë dot. T'i lejosh fëmijët që të shprehin ndjenjat e inatit dhe të trishtimit, është shumë e rëndësishme në procesin e shërimit të tyre shpirtëror.

NGJYRAT E YLBERIT

Ylberi ka shumë ngjyra dhe secila ngjyrë është e ndryshme nga të tjerat.

Edhe ne njerëzit jemi pak a shumë si ngjyrat e ylberit, sepse secili prej nesh është i ndryshëm dhe i veçantë. Forma e syve, ngjyra e lëkurës, madje edhe ushqimet që na pëlqejnë, janë ato që na bëjnë të ndryshëm.

Por, gjithashtu, ne jemi shumë të ngjashëm. Ne kemi ndjenja, mendime, shpresa, dëshira dhe ëndrra; ne qeshim kur jemi të gëzuar dhe qajmë kur jemi të mërzitur.

Kur njerëzit nga e gjithë bota bëhen bashkë, ata krijojnë një pamje të mrekullueshme, njësoj si ylberi. Ndaj le të bashkohemi, që të krijojmë një ylber!

Le të festojmë për të përbashkëtat dhe ndryshimet tona!

MAMI ËSHTË SËMURË!

Të mësosh se mami ka kancer është një përvojë e frikshme për një fëmijë. Djali i vogël i kësaj ndodhie pyet veten se: *Mos është faji i tij që mami ka kancer? Si do të ndryshojë jeta e tij dhe e gjithë familjes së tyre?.*

Ky libër i nxit prindërit të jenë të hapur dhe të çiltër me fëmijën e tyre, edhe kur duhet të tregojnë se njëri nga prindërit ka kancer. Prindërit e djalit i shpjegojnë atij që mami do t'i nënshtrohet kimioterapisë dhe, duke luftuar sëmundjen dita-ditës, gjithçka do të shkojë mirë. Si përfundim, mami shërohet, por djali duhet të kuptojë se kanceri edhe mund të rikthehet.

Ky libër i bën fëmijët të kuptojnë se kanceri është gjendje shëndetësore serioze. Dhe se po të mbështeten gjithmonë te prindërit, do ta kenë më të lehtë të largojnë ankthet dhe të shprehin emocionet e tyre. Nga ana tjetër, fëmijët ndihen të vlerësuar kur kuptojnë se dhe me sjelljet e tyre mund të ndihmojnë në përmirësimin e gjendjes së të rriturit që është i sëmurë.

SHOQJA IME KA SINDROMËN DAUN

Ky libër rrëfen historinë e dy vajzave që takohen në një kamp veror dhe zënë miqësi të ngushtë; pavarësisht se njëra prej tyre ka sindromën Daun. Të dyja vajzat tregojnë se janë të afta të bëjë mirë diçka dhe kjo e ndihmon secilën të kapërcejë frikën dhe vështirësitë, duke arritur sukses.

Libri "Shoqja ime ka sindromën Daun" jep mesazhin se të gjithë fëmijët meritojnë t'u jepen mundësi për të shfaqur të gjithë potencialin e tyre dhe për të krijuar marrëdhënie shoqërore afatgjata. Vetëm se duhen thyer disa nga kufijtë që ekzistojnë midis fëmijëve; çdo fëmije, në çfarëdo rasti, i pëlqen të arrijë të përkryerën, duke bërë më të mirën për veten.

GJYSHËRIT E MI JANË TË VEÇANTË!

Fëmijët ndihen shumë të veçantë, falë lidhjes së dashurisë dhe afrimitetit që kanë me gjyshërit. Ky libër tregon një histori të përzemërt të një fëmije dhe të gjyshërve të tij.

Djemtë dhe vajzat nxiten të vlerësojnë marrëdhënien që ata kanë me gjyshërit dhe të ruajnë kujtime të dashura, ndërsa koha kalon dhe ata rriten.

Libri i ndihmon fëmijët të mësojnë për sfidat e moshës me të cilat përballen gjyshërit e tyre, me qëllim që ata të kuptojnë e të vlerësojnë të moshuarit në përgjithësi.

Seria

Fabulat e Ezopit

FABULAT E EZOPIT

Tituj: 4 (seri e hapur)

Faqe: 40, me ngjyra

Formati: 140 x 180 mm

Kopertina: e plastifikuar, me lustër

Çmimi: 420 lekë; 3.5 euro; 200 den (për libër)

Fabulat e Ezopit është një seri me fabulat më të përzgjedhura nga Ezopi. Në këto 4 libra janë përmbledhur tregime dhe përralla të shkurtra, por që përmbajnë një mesazh të madh. Këto fabula të të gjitha kohërave vijnë në shqip me një gjuhë të këndshme dhe ilustrime të bukura për fëmijë fëmijët e ditëve të sotme.

MIRË T'U BËHET!

Mirë t'i bëhet edhe erës që desh të matej me diellin babaxhan, edhe lepurit mburravec.

Ja që, jo gjithmonë fiton më i shpejti! Le pastaj dhelpra, që desh ta tërhiqte prej hunde (sqepi) lejlekun! Mirë t'i bëhet edhe asaj! Në këtë përmbledhje fabulash të Ezopit, personazhet pësojnë nga mendjemadhësia e tyre! Epo, mirë t'u bëhet!

URI PREJ UJKU

Kujdes prej personazheve të këtyre fabulave: ato kanë një uri të madhe! Jo të madhe, por të llahtarshme fare! Çne të llahtarshme: kanë një uri prej bishe!

Dhe kur ca grykës si ujku, dhelpra dhe luani kanë një uri prej bishe, kushedi ç'kurthe e ç'gracka sajojnë për të mbushur barkun!

KUSH TEPËR LAKMON...

Kush tepër lakmon, a thua më shumë gëzon? As që bëhet fjalë! Kush shumë lakmon, mbetet me gisht në gojë! Kjo i ndodhi luanit të babëzitur, gomarit lakmitar dhe personazheve të tjera të fabulave të kësaj përmbledhjeje.

TË VEGJËL, POR MENDJEMPREHTË

Mos vallë vetëm ata që janë të mëdhenj ia dalin mbanë? Jo, aspak, sepse edhe të vegjlit janë mendjemprehtë, siç janë personazhet e këtyre fabulave. Gjinkalla ia hodhi dhelprës dinake, miushi i shpëtoi jetën luanit dhe kecushi ia mbathi prej kthetrave të ujkut... Nuk e beson?! Lexoje vetë me sytë e tu!



Seria Të kujdesemi për planetin tonë

TË KUJDESEMI PËR PLANETIN TONË

Tituj: 4
Faqe: 36, me ngjyra
Formati: 240 x 240 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 550 lekë; 4 euro, 250 den (për libër)

Librat e kësaj serie do t'i ndihmojnë fëmijët të kuptojnë se burimet e Tokës janë të kufizuara dhe mjaft të çmuara, ndaj duhen përdorur me kujdes. Në fund të librit ka katër faqe, ku sugjerohen veprimtari, të cilat mund të realizohen nga fëmijët dhe që lidhen me temat e trajtuara në libër. Gjithashtu, në fund ka edhe një udhëzues me këshilla për prindërit, se si ta përdorin informacionin e librit, për t'i bërë fëmijët të vetëdijshëm për çështjen e mbrojtjes së planetit ku jetojmë.

***FIUU!* AJRI**

Të gjitha kafshët dhe bimët kanë nevojë për ajër të pastër. Ky libër u tregon fëmijëve rëndësinë që ka ajri për jetën dhe shpjegon rreziqet e ndotjes. Fëmijët mësojnë se secili prej tyre mund të ndihmojë për të pakësuar ndotjen e ajrit.

***YFF!* MBETURINA!**

Mbeturinat, plehrat dhe mbetje të tjera të hedhura në vende të papërshtatshme, krijojnë një mjedis të papastër e të pakëndshëm. Ato, gjithashtu, rrezikojnë shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve. Ky libër u mëson fëmijëve se sa e rëndësishme është hedhja e mbeturinave në vendet e caktuara.

***PLLUQ!* UJI**

Në këtë libër fëmijët mësojnë për rëndësinë që ka uji për jetën e gjallesave: njerëzve, kafshëve, bimëve dhe zbulojnë mënyrat se si mund ta kursejnë ujin në shtëpitë e tyre.

***KLIK!* ENERGJIA**

Në këtë libër, fëmijët do të mësojnë se e gjithë energjia në Tokë vjen drejtpërdrejt nga Dielli ose jo. Fëmijët do të mësojnë gjithashtu, për rëndësinë e gjetjes së burimeve të ripërtërishme të energjisë.

Seria Nga G. Rodari

Në fletët e mëdha të këtij libri të shkrimtarit italian për fëmijë, Xhani Rodari, piktori i varfër, që s'ka asnjë lek për të blerë ngjyra, paraqitet si një siluetë e bardhë në sfondin gri.

Nëse e nxitni fëmijën ta shkruajë këtë tekst në formë poezie, do ta shikoni se do të dalë një vjershë me strofa dhe rimë. Libri është dizajnuar në mënyrë të tillë që fjala dhe figura të krijojnë një sfond të përbashkët për dhënien e mesazhit artistik.

Gjithashtu, duke u nxitur nga imazhet e këtij libri, ata mund të pikturojnë vetë figurat e librit, madje dhe të tjera, me të gjitha ngjyrat që kërkonte piktori: blunë, të verdhën, të gjelbrën, kafen, të kuqen. Ashtu si piktori, fëmijët do ta kuptojnë se për të arritur diçka, më parë duhet ta kërkojnë brenda vetes.



Mesazhi i poezisë "Triumfi i Zeros" i shkrimtarit italian për fëmijë, Xhani Rodari, lidhet jo vetëm me rëndësinë e 0-s si numër, por dhe me atë se çdo njeri, sado i parëndësishëm të duket në sipërfaqe, ka brenda vetes vlera, që mjafton t'ia zbulosh.

Ky libër merr jetë nëpërmjet ilustrimeve elegante e të këndshme. Përveç mesazhit shumë domethënës për t'i parë gjërat nga këndvështrime të ndryshme, fëmijët mësojnë se me fantazi dhe imagjinatë fjala mund të "përkthehet" në figurë.

Nëse rimat e vargjeve i nxitin fëmijët ta mësojnë këtë poezi përmendsh, ilustrimet e mrekullueshme i ftojnë ata të krijojnë vetë punime artistike duke përdorur stampa, lapsa dhe figura të prera.

NGA G.RODARI

Tituj: 2 (seri e hapur)
Faqe: 28, me ngjyra
Formati: 235 x 335 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 980 lekë; 7 euro; 430 den (për libër)

Seria

Një histori në 5-15 min.

NJË HISTORI NË 5-15 MIN

Tituj: 6
Faqe: 40, me ngjyra
Formati: 140 x 180 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 400 lekë; 3.5 euro; 200 den (për libër)

Magji, aventurë, frikë, imagjinatë... dhe shumë zbavitje. Këta libra me histori të shkurtra janë posaçërisht për fëmijët që sapo kanë filluar të lexojnë. Për këtë qëllim edhe lloji i shkrimit që është përdorur, i përshtatet shkallës së vështirësisë të leximit: shkronja KAPITALE, shkronja të vogla shtypi dhe me shkrim dore.

Në fund të çdo libri ka lojëra me fjalët dhe figurat e përfshira në libër.

SHIU I YJEVE

Një histori në 5 minuta

Një vajzë e varfër, por zemërmirë, ndihmon këdo që takon, sa u jep atyre edhe rrobat e trupit. Por një magji ndodh dhe nga qielli bie shi yjesh, që shndërrohen në monedha sapo bien në tokë. Ky libër është për fëmijët që sapo kanë filluar të lexojnë, të cilët, pasi e lexojnë atë, luajnë me fjalët dhe figurat në fund të librit!

QYTETI QË ASKUSH NUK E NJEH

Një histori në 5 minuta

Qyteti që askush nuk e njeh është një qytet i ndërtuar vetëm me ushqimet që u pëlqejnë më shumë fëmijëve: ëmbëlsira, limonada, makarona, salsiçe, mish të pjekur, patate të skuqura... Përveç imagjinatës dhe kënaqësisë, fëmijët që sapo kanë mësuar të lexojnë, zbaviten me lojërat e fjalëve e figurave në fund të librit.

FANTAZMA

Një histori në 10 minuta

Në një fermë banonin vetëm të moshuar për shkak të një fantazme shuuuumë të frikshme. Por guximi dhe bujaria e një djaloshi i dhuron paqe fantazmës, e cila largohet përgjithmonë. Ky libër për fëmijët që sapo kanë filluar të lexojnë, është i pajisur edhe me lojëra për fjalët dhe figurat e përfshira në libër!

HAJDUTI FATLUM

Një histori në 10 minuta

Një hajdut, që e quante vjedhjen zanat si çdo zanat tjetër, shkon për të vjedhur në një shtëpi. Rrugës zë disa shokë të çuditshëm: një shkop, një kërmill, një gjel, një gozhdë dhe një grumbull pleh të cilët e ndihmojnë. A do të ndërrojë zanat ai pas kësaj aventure? Fëmijët që sapo kanë filluar të lexojnë argëtohen, duke lexuar përrallën dhe, në fund, ka lojëra për të luajtur me fjalët dhe figurat.

PRINCESHA E GUXIMSHME

Një histori në 15 minuta

Kush tha se vetëm djemtë dinë të luftojnë? Kësaj radhe është pikërisht princesha e guximshme ajo që shpëton princin, duke i dalë para fatit të keq që ishte parathënë për princin. Pasi lexojnë historinë, fëmijët që sapo kanë mësuar të lexojnë zbaviten me lojërat në fund të librit.

DOKTOR GJITHËDITURI

Një histori në 15 minuta

Duke lexuar se si një fshatari i varfër që bëhet "Doktor Gjithëdituri" dhe bëhet i pasur, fëmijët që sapo kanë mësuar të lexojnë zbaviten me historinë dhe me lojërat në fund të librit.

Seria

Përralla që tregohen nga të rriturit

PËRRALLA QË TREGOHEN NGA TË RRITURIT

Tituj: 6

Faqe: 48-64, me ngjyra

Formati: 210 mm x 250 mm

Kopertina: e plastifikuar, me lustër

Legjenda, përralla dhe histori nga e gjithë bota reale dhe ajo imagjinare; nga vende e popuj të çdo kontinenti, nga jeta tokësore, ujore, yjore... Ndodhi të së shkuarës, të së tashmes e të së ardhmes, që të lënë me gojë hapur me fantazinë dhe larminë e tyre... Personazhe nga më të çuditshmit: princesha e kalorës; zana, magjistarë e elfë; dragonj e përbindësha, por edhe kafshë e lodra...

Gjashtë librat e serisë **"Përralla që tregohen nga të rriturit"** u mësojnë fëmijëve për vende dhe njerëz anembanë botës, u nxitin fantazinë e dëshirat dhe prekin ndjenjat e emocionet e tyre, madje ka një libër më vete vetëm për frikën: **"Përralla që të futin dridhmat"**.

PËRRALLA QË TË FUTIN DRIDHMAT
Tetë përralla që të futin dridhmat, plot mistere dhe ankthe, shkruar kryesisht për të rriturit, që t'ua tregojnë fëmijëve në mbrëmje e të nxitin dëshirën e tyre për t'i lexuar vetë.



PËRRALLA FANTASTIKE

Tetë përralla fantastike, plot me zana e magji, shkruar kryesisht për të rriturit, që t'ua tregojnë fëmijëve në mbrëmje e të nxitin dëshirën e tyre për t'i lexuar vetë.

PËRRALLA PARA GJUMIT

Pesë përralla të mrekullueshme dhe argëtuese, shkruar kryesisht për të rriturit, që t'ua tregojnë fëmijëve para gjumit e të nxitin dëshirën e tyre për t'i lexuar vetë.

PËRRALLA ME PRINCESHA DHE KALORËS

Pesë përralla të mrekullueshme, plot me aventura princeshash dhe kalorësish, shkruar kryesisht për të rriturit, që t'ua tregojnë fëmijëve në mbrëmje e të nxitin dëshirën e tyre për t'i lexuar vetë.

PËRRALLA TË SË ARDHMES

Tetë përralla për kohën e ardhme, plot fantazi, aventura dhe humor, shkruar kryesisht për të rriturit, që t'ua tregojnë fëmijëve në mbrëmje e të nxitin dëshirën e tyre për t'i lexuar vetë.

PËRRALLA TË KOHËVE TË VJETRA

Tetë përralla për kohët e vjetra, të mbushura me bëma heronjsh, shkruar kryesisht për të rriturit, që t'ua tregojnë fëmijëve në mbrëmje e të nxitin dëshirën e tyre për t'i lexuar vetë.

Seria Stilim

STILIM

Tituj: 2

Faqe: 48-64, me ngjyra

Formati: 300 x 260 mm

Kopertina: E fortë

Çmimi: 1150 lekë; 8.5 euro, 510 den (për libër)

E pajisur me të gjitha mjetet që duhen për të qenë stiliste, fëmijët do të argëtohen duke stiluar veshje dhe aksesorë. Kompleti përmban letra të ngjitshme, modele të skicuara, bojëra, letra ngjitëse me ngjyrë dhe për t'u ngjyrosur, vinovil me xixa etj.

Lëri idetë e tua dhe imagjinatën të lirë dhe krijo veshjen që do ta admirojnë të gjithë!

Seria

Mësoj me gjëegjëza

Në faqet e librit "Lojë me gjëegjëza" do të gjeni një sërë gjëegjëzash të ilustruara me ngjyra, të cilat ngacmojnë logjikën e fëmijëve dhe i nxisin ata të gjejnë përgjigjet. Gjëegjëzat e këtij libri lidhen me sendet që ata i hasin ose jo në jetën e përditshme, si: lodrat, orenditë shtëpiake, mjetet e udhëtimit, dukuritë njerëzore e ato natyrore etj., duke dalluar karakteristikat më të veçanta të tyre. Me anë të lapsit magjik (që di gjithçka), ata mund ta vërtetojnë menjëherë, nëse përgjigjet e tyre janë ose jo të sakta. Për ta bërë lojën sa më interesante, janë dhënë disa variante, ndërmjet të cilave duhet zgjedhur përgjigjja e duhur.

Libri "Gjëegjëza me kafshë" përmban të ilustruara me ngjyra gjëegjëza klasike për shumë lloje kafshësh, që jetojnë pranë ose larg nesh. Duke u ndihmuar edhe nga ilustrimet interesante e ngacmuese, fëmijët mësojnë për tiparet dalluese të kafshëve, për vendet ku ata jetojnë, për mënyrën e të ushqyerit, për zërat e tyre etj. Me anë të lapsit magjik (që di gjithçka) ata mund ta vërtetojnë menjëherë, nëse përgjigjet e tyre janë ose jo të sakta, duke mësuar, duke u argëtuar e duke e bërë të paharrueshme kohën e tyre të lirë. Për ta bërë lojën sa më interesante, janë dhënë disa variante, ndërmjet të cilave duhet zgjedhur përgjigjja e duhur.

MËSOJ ME GJËEGJËZA

Tituj: 2

Faqe: 30, me ngjyra

Formati: 258 x 295 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 900 lekë; 6.5 euro; 400 den (për libër)

Seria Pse, kur, si?

PSE, KUR, SI?

Tituj: 3 (Seri e hapur)
Faqe: 16, me ngjyra, karton
Formati: 240 x 275 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1000 lekë; 8 euro; 500 den (për libër)

Një seri e mrekullueshme për të vegjlit, që u përgjigjet pyetjeve të para të fëmijëve: ***pse?, si?, kur?***.

Ilustrimet e këndshme dhe të përshtatura për moshën e tyre, i ndihmojnë ata të zbulojnë botën që i rrethon, të marrin informacionet që ju nevojiten dhe të argëtohen.

Dritarëze të vogla fshehin ilustrime plotësuese, të cilat pasurojnë situatat me detaje të reja.

Një seri edukative e përgatitur nga specialistë të fushës.

GJITHÇKA PËR MAKINAT E GARAVE

- Pse përdoren makinat e garave?
- Kur u ndërrohen gomat makinave të garave?
- Si bëhesh një shofer garash?

TË ZBULOJMË TRUPIN TONË

- Pse marrim frymë?
- Kur duhet t'i pastrojmë dhëmbët?
- Si shohim dhe si dëgjojmë?

Seria Autorë shqiptarë

NA ISHTE DY HERË...
Autor: Qëndresa Zeneli Rrahmani
Faqe: 56, me ngjyra
Formati: 210 x 250 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 700 lekë; 6 euro; 350 den

Na ishte dy herë... një botë magjike dhe e mistershme për vogëlushët. E në këtë botë magjike, personazheve të vërteta u ndërlidhet fati me personazhet e tyre më të dashura vizatimore. Këtë u ofron lexuesve të vegjël libri me përralla "Na ishte dy herë". Ky botim përmban 5 përralla: *Trimi, Lisa dhe peshku i dëshirave; Rroni në kopshtin zoologjik; Një letër për babadimrin; Princesha Zana dhe medaljoni magjik; Drini shkencëtari.* Të gjitha përrallat shoqërohen me ilustrime plot ngjyra, që e bëjnë mjaft të këndshëm leximin.

VJERSHAT E SHKRONJAVE
Autor: Brunilda Tahiri (Spahiu)
Faqe: 40, me ngjyra
Formati: 250 x 250 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 350 lekë; 2.5 euro; 150 den

Në librin **"Vjershat e shkronjave"** do të gjeni një vjershë për secilën shkronjë të alfabetit. Janë krijime të shkurtra, të thjeshta dhe të lehta për t'u mësuar. Këto vjersha dhe ilustrimet fantastike do t'i ndihmojnë nxënësit të fiksojnë më mirë shkronjat.

AVENTURAT E TOBIT
Autor: Valbona Imeraj
Faqe: 40, me ngjyra
Formati: 192 x 192 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 380 lekë; 3 euro, 180 den

"Aventurat e Tobit" është i përshtatshëm për fëmijët e moshës 6-8 vjeç. Në këtë libër fëmijët do të: lexojnë, shkruajnë, përgjigjen, zbaviten, vizatojnë e ngjyrosin personazhet e dashura për ta.



PICA, PICA, VETËM... PICA

Autore: Rudina Çupi
Faqe: 24, me ngjyra
Formati: 170 x 240 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 300 lekë; 2 euro; 120 den

Aq shumë u pëlqejnë fëmijëve picat, sa ata i krahasojnë me çdo gjë përreth, me të cilën luajnë dhe zbaviten. Pica si anije kozmike, si rrota autobusi, si breshkë... si vepër arti. Pasi lexojnë poemthin e ilustruar, fëmijët që sapo kanë mësuar të lexojnë, zbaviten edhe me lojërat në fund të librit.

PA E VRARË MENDJEN

Autore: Natasha Poroçani (Shuteriqi)
Faqe: 56, bardhë e zi
Formati: 140 x 200 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 350 lekë; 2.5 euro; 150 den

"Pa e vrarë mendjen" është një libër me histori të mrekullueshme me mbretër e zana, si dhe me tregime të bukura e me plot humor nga jeta e përditshme e fëmijëve. Në to flitet për marrëdhëniet me gjyshërit, prindërit dhe mësuesit, me shokët e shoqet, rregullat që duhet të ndjekin fëmijët në familje, shkollë etj. Personazhet e tregimeve kanë teka dhe dëshira "të çuditshme", si dhe pikëpyetje për gjëra që nuk i dinë. Por, në fund, ata gjejnë te prindërit, gjyshërit dhe mësuesit miqtë e tyre më të mirë!

FLUTURIMI I MARKUT

Autor: Sazan Goliku
Faqe: 24, me ngjyra
Formati: 170 x 240 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 300 lekë; 2 euro; 120 den

Në qendër të librit është Marku, personazhi kryesor, një djalë shumë trazovaç. Një ditë të bukur ai nuk ua vuri veshin fjalëve të gjyshes dhe ngacmoi zgjoin e bletëve. Ato u zemëruan shumë me të dhe e ndëshkuan. Papritur ai u zvogëlua dhe u bë më i vogël se një bletë! **"Fluturimi i Markut"** është një përrallë fantastike mjedisore dhe edukative. Ky libër i bën fëmijët të kuptojnë se të gjithë duhet të kujdesemi për natyrën, të jemi miq të saj dhe të dëgjojmë këshillat e të rriturve.

AVENTURAT E LUSIT NË KUZHINË

Autore: Stela Subashi
Faqe: 110, me ngjyra
Formati: 175 x 250 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 1200 lekë; 9 euro; 550 den

Libri **"Aventurat e Lusit në kuzhinë"** sjell disa receta të thjeshta për fëmijë, që përgatiten vetëm me 4 hapa dhe që kanë përbërës shumë të shëndetshëm për fëmijët. Por, më tepër se një libër kuzhine për fëmijë, ky libër synon ta bëjë fëmijën pjesë të kuzhinës, ku prindërit dhe fëmijët mund të kalojnë më shumë kohë bashkë. Por, ajo që është më kryesorja, fëmijët që refuzojnë të hanë, vetëm duke u përfshirë në kuzhinë, duke u njohur me botën e saj, duke e kthyer gatimin në një argëtim për ta, do të arrijnë të ushqehen shëndetshëm dhe pa bërë naze në ushqim.

GËNJESHTRA TË BARDHA

Autore: Sevi Lami Agolli
Faqe: 64, me ngjyra
Formati: 145 x 210 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 500 lekë; 4 euro; 250 den

Mjaftoi një "gënjeshtër e vogël" e mamit për pyetjen e saj se si lindin bebet, që në mendjen e Amelit të ndizej një imagjinatë e madhe, sa ndërtoi një supermarket gjigant, ku shiteshin fara bebesh... Por, si mund të shkonin ata në këtë supermarket të largët, për të blerë një farë bebeje? Këto dhe ndodhi të tjera të këndshme lindën nga disa gënjeshtra të bardha, që i thanë prindërit e saj, duke qenë se ata mendonin se Ameli ishte e vogël për të kuptuar të vërtetën.

HAJDUTJA E BUZËQESHJEVE

Autore: Sevi Lami Agolli
Faqe: 78, me ngjyra
Formati: 145 x 20.8 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 550 lekë; 4.8 euro; 300 den

... Sa qejf është ta kesh tezen police! Ditën e parë, kur ua thashë të tjerëve në klasë, djemtë i hapën sytë aq shumë dhe filluan të më pyesin a kishte kapur ndonjë keqbërës tezja ime dhe ku i mbante prangat e shkopin e gomës... Kurse vajzat më pyesnin se çfarë uniforme vesh tezja ime dhe a kam qenë te puna e saj. Dhe unë, duke u mburrur pak, u tregoja që tezen time mund ta shihnin kudo nëpër rrugët e qytetit, sepse ajo drejton trafikun dhe ndihmon njerëzit e automjetet të mos bëjnë aksidente.



KALENDARI I ËNDRRAVE TË MOLLËS

Autore: Natasha Shuteriqi Poroçani
Faqe: 32, me ngjyra
Formati: 170x230 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 400 lekë; 3.5 euro; 210 den

Një mollë ka ëndrra të bukura. Në çdo muaj të vitit. Ajo nuk i mban për vete ëndrrat e saj, por i ndan me të vegjlit.

Madje edhe fëmijët (lexues) pyeten për ëndrrat, dëshirat dhe detyrat që kanë në çdo muaj. Libri është i pasur me ilustrime

"Engjëlli Blu" është një libër me aventura fantastike. Personazhi kryesor është një djalë i veçantë me spektrin e autizmit. I lodhur nga bullizmi në lagje dhe në shkollë, ai fillon të ëndërrojë dhe ndërmerr disa aventura fantastike, bashkë me qenin Dasi dhe delfinin Zuro, dy miqtë e tij gazmorë. Ai është një djalë i zgjuar, paqësor dhe i dashur. Nëpërmjet aventurave të tij, ai jep një mesazh të bukur: të duam dhe të bëhemi miq me të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta si Kori.

ENGJËLLI BLU

Autore: Anila Kruti
Faqe: 68, me ngjyra
Formati: 150 x 18.5 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 500 lekë; 4.5 euro; 270 den

Seria

Klasikët për të vegjël

KLASIKËT PËR TË VEGJËL

Tituj: 26

Faqe: 80, me ngjyra

Formati: 140 x 180 mm

Kopertina: e plastifikuar, 350 g.

Çmimi: 600 lekë; 5 euro; 300 den (për libër)

Klasikët e mëdhenj, të përshtatur për lexuesit vegjël. Këta libra prezantojnë vogëlushët mbi 8 vjeç me botën e bukur të letërsisë, nëpërmjet personazheve më të njohura dhe më të dashura nga të gjithë. Historitë që të gjithë i njohim, vijnë të ritreguara plot humor dhe mjeshtëri, të shoqëruara nga ilustrime fantastike.

KOPSHTI SEKRET

Meri është një vajzë e llastuar që jeton në Indi. Por fatkeqësia e godet, dhe një sëmundje u merr jetën të dy prindërve të saj. Prandaj Meri detyrohet të kthehet në Angli dhe të jetojë në Misëlthuejt Manor, shtëpinë e xhaxhait të saj. Aty takon Dikonin, një djalosh mjaft i çuditshëm, mik me gjithë kafshët, dhe kushëririn e sëmurë, Kolin. Bashkë me ta, ajo do të rilindë kopshtin sekret të vilës, i goditur edhe ai nga fatkeqësia, njëlloj si vogëlushja Meri.



SANDOKANI, TIGRI I MALAJZISË

I fuqishëm dhe i egër si një tigër, Sadokani dhe aventurat e tij në detet e Malajzisë rikthehen në këtë ritregim. A do të arrijë të bashkohet me të dashurën e tij, ledi Marianën? Me çfarë rreziqesh do të përballet? Me në krah mikun e tij, Janezin, dhe shokët e tij besnikë, tigrat, Sandokani do të luftojë për liri, drejtësi dhe dashuri.



ISHULLI I THESARIT

Thesari i kapitenit Flint, piratit më gjakatar të të gjitha kohërave, ka qëndruar i fshehur në një ishull të largët. Harta e thesarit i bie në dorë Xhim Hokinsit, një djaloshi që punonte në bujtinën e prindërve. Bashkë me doktor Livsin, kavalier Trelaunin dhe një karakter të dyshimtë, të quajtur Xhon Silveri i Gjatë, ata do të vihen në kërkim të thesarit. Çfarë të papriturash e presin të riun Xhim?

RRETH BOTËS PËR 80 DITË

Filias Fogu vë një bast dhe niset në një udhëtim rreth botës, që duhet të përfundojë për 80 ditë. I shoqëruar nga maxhordomi Paspartu, e bukura Auda dhe nën vështrimin dyshues të inspektorit Fiks, ai përshkon gjithë rruzullin tokësor. Dalë nga pena e Zhyl Vernit, babait të fantashkencës, kjo aventurë vjen e ritreguar për fëmijët.



AVENTURAT E TOM SOJERIT

Djaloshi çapkën, Tom Sojeri dhe miku i tij Hak Fini rikthehen me aventurat e tyre në brigjet e Misisipit. Gardhit i duhet një dorë bojë, por Tomi përton si dreqi. Si do të shpëtojë ai nga kjo angari? Aventura me piratë, shpella si labirint dhe thesare të fshehura presin lexuesit e vegjël në faqet e këtij libri.



AVENTURAT E PINOKUT

Personazhi i Pinokut vjen në një përkthim të ri, të këndshëm dhe shumë argëtues. Ju do të njiheni me aventurat e kukullës prej druri, që s'do të shkojë në shkollë dhe që futet në telashe të njëpasnjëshme. Por ai ia del në fund të bëhet një djalë prej vërteti, sepse është zemërmirë, i do dhe i ndihmon të gjithë ata që has gjatë aventurave të tij, dhe veçanërisht do babanë e vet, Xhepeton e moshuar, dhe Zanën, mirëbërësen e tij të kudogjendur.



ODISEJA

Në këtë libër, fëmijët do të njihen me Odisenë, mbretin trim, të mençur dhe dinak të Itakës, pas mbarimit të Luftës së Trojës. Zoti i Deteve, Poseidoni, e dënoi atë që të endej për vite e vite nëpër vise të panjohura, të luftonte kundër dallgëve dhe erërave, larg mbretërisë së tij, djalit dhe gruas që e priste me padurim. A arrin ai të largohet nga Kalipsoja që e mbante prej vitesh të izoluar në ishullin e saj? A arrin t'i shpëtojë ciklopit Polifem dhe a kthehet në Itakë për të shpëtuar mbretërinë e tij?

POLIANA

Vogëlushja Poliana mbetet jetime dhe shkon të jetojë me tezen e saj, znj. Polin, një grua e zymtë. Aty Poliana njeh miq të mirë dhe njerëz shumë interesantë, që i bën për vete me natyrën e saj të qeshur dhe miqësore. Falë "lojës" që i kishte mësuar i ati, ajo i bën të tjerët të gjejnë lumturinë dhe në fatkeqësi, vetëm duke parë anën pozitive të gjërave. Me pafajësinë e mirësinë që rrezaton, Poliana rikthen te tezja e saj dashurinë e vjetër dhe tek i gjithë fshati buzëqeshjen. Në libër ju do të lexoni për shumë e shumë situata të vështira, të cilat Poliana i kalon me guxim.

UDHËTIMET E GULIVERIT

Lemuel Guliveri dhe udhëtimet e tij plot të papritura rikthehen të treguara për lexuesit e vegjël. Guliveri, mjek anijeje, niset për një udhëtim në Inditë lindore, por rastësia e bën të përjetojë aventura të mëdha në tokën e Lliputëve dhe në mbretërinë e Bordbingnagut.



HAJDI

Vogëlushja Adelajde, ose siç e thërrasin të gjithë, Hajdi, jeton në malet e Zvicrës me gjyshin e saj. Asaj i pëlqen të luajë me mikun e saj, Peter dhe me kopenë e dhive. Hajdi shkon edhe në qytet, ku takon një mikeshë të re, Klarën. Por atë e merr malli shumë për gjyshin dhe shtëpinë. A do të rikthehet Hajdi në mal?

I MREKULLUESHMI MAGJISTARI I OZIT

Ndiqni Dorotinë dhe qenin e saj Toto në aventurën e tyre në mbretërinë e Ozit. Aty ata miqësohen me Dordolecin, Druvarin prej teneqeje dhe Luanin frikacak. Por Doroti do të rikthehet në Kansas. Prandaj ajo kërkon ndihmën e Magjistarit të Ozit, por rrugës përballet me vështirësi të mëdha dhe një shtrigë të pabesë.

TARZANI I MAJMUNËVE

Në këtë libër tregohet historia e mrekullueshme e djaloshit të xhunglës, Tarzanit. Prindërit e tij nisen nga Londra drejt Afrikës për të punuar, por gjatë rrugës ata braktisen në xhungël nga kapiteni. Pikërisht këtu lind Tarzani, i cili pas vdekjes së prindërve, rritet nga majmuni Kala. Një ditë Tarzani pa në breg një kasolle të vogël, të ndërtuar mbi pemë. Tepër kureshtar shkon drejt saj, pa e ditur që ajo ishte shtëpia ku kishte lindur. Në këtë shtëpi ai takon dhe bie në dashuri me Xhejnin. Por a do ta braktisë xhunglën dhe a do të takohet me Xhejnin në Londër? Mësojeni këtë në aventurën e Tarzanit.

PITER PANI

Familja Darling jetonte në një shtëpi të madhe e të bukur. Ajo përbëhej nga prindërit, vajza e madhe Uendi, dy vëllezërit e saj të vegjël, Xhani e Mikeli dhe qeni Nana. Një mbrëmje një djalë i vogël i çuditshëm hyri nga dritarja duke fluturuar. Kështu fillon historia e mrekullueshme e Piter Panit, djaloshit që nuk rritej, e cila vjen në këtë libër, e ritreguar plot humor dhe mjeshtëri, e shoqëruar me ilustrime fantastike. Uendi, Xhani dhe Mikeli përfshihen në një aventurë, së bashku me Piter Panin në "Ishullin që nuk është". Mësoni më shumë për aventurat e tyre duke lexuar këtë libër.



ROMEO DHE ZHULIETA

Në qytetin e bukur të Veronës, shtatëqind vjet më parë, jetonin dy familje me fuqi dhe fisnikëri të barabartë, Montagët dhe Kapuletët, armike prej një urrejtjeje të lashtë.

Romeo dhe Zhulieta, historia e një dashurie të madhe që përfundon në një tragjedi për shkak të një letre të padorëzuar. Një ritregim fantastik i historisë më të famshme të dashurisë.

LIZA NË BOTËN E ÇUDIRAVE

Libri "Liza në botën e çudirave" është një tregim fantastik, i botuar në 123 vende të botës. Ai rrëfen për udhëtimin fantastik të vogëlushes Lizë, që ka ndodhur kohë më parë në një ditë vere. Liza kalon nëpër shumë aventura njëra pas tjetrës, takon Lepurin e Bardhë, macen ngërdheshëse, Kapelabërësin, mbretin, mbretëreshën etj. Për të mësuar më shumë mbi bëmat e Lizës në botën e çudirave lexoni këtë libër klasik me ilustrime fantastike.

LIBRI I XHUNGLËS

Një "këlysh" njeriu gjendet në xhungël, në shpellën e ujqërve. Ai është shtrirë midis këlyshëve ujqër, pranë nënës Ujkonjë dhe nuk ka fare frikë. Jashtë shpellës, tigri Sher Kan ulërin i tërbuar sepse do ta kollofitë. Çfarë do të ndodhë me Moglin? A do ta shpëtojnë ujqërit nga kthetrat e tigrit njeringrënës? A do të arrijë të mbijetojë në xhungël? Po ligjit të xhunglës? Mësojeni këtë në historinë e *Librit të Xhunglës*, të rrëfyer me një gjuhë të thjeshtë dhe të shoqëruar me ilustrime tërheqëse.

UDHËTIM NË QENDËR TË TOKËS

Profesor Lidenbroku, gjeolog dhe studiues mineralesh me famë botërore, së bashku me nipin e tij Aksel, përgatiten për një mision: një udhëtim në qendër të Tokës. A do ta përmbushin ata këtë mision? Zbuloni më shumë për udhëtimin e tyre plot peripeci dhe të papritura duke lexuar librin.





DON KISHOTI

Don Kishoti mendon se është një kalorës si në kohët e vjetra. Po sigurisht që në ditët e sotme nuk ka dragonj me të cilët mund të luftosh, po kjo gjë nuk e pengon atë që, së bashku me ndihmësin e tij, të kalojë nga një aventurë e çmendur në tjetrën.



ROBIN HUDI

"Robin Hudi", një prej klasikëve më të bukur, është sjellë nga autorja italiane Silvia Ronkalia për lexuesit e vegjël, me një gjuhë tejet të këndshme, plot humor dhe inskenime gjatë rrëfimit të saj të shkurtër, duke e bërë librin t'i përngjajë një filmi, i cili është duke u xhiruar në po të njëjtin çast që lexuesi e lexon. Ky bashkëpunim midis lexuesve e bën këtë libër mjaft tërheqës gjatë zbulimit të personazhit të Robin Hudit dhe miqve të tij që gjenden në rrezik.

AVENTURAT E HAKËLBERI FINIT

Të gjithë fëmijët që e njohin të famshmin Tom Sojeri, në botimin më të ri të klasikëve për të vegjël, do të mund të njohin, më në fund, shokun e tij më të ngushtë, trazovaç e të pabindur, Hakëlberi Finin. Ky djalë i vogël është braktisur nga babai i tij i papërgjegjshëm. Vejusha Dagllas e merr në shtëpinë e saj, që ta rrisë dhe edukojë. Por Hakëlberi është një fëmijë i pashtruar, që e ka zët të jetë "një djalë i mirë", pasi për të dhe Tomin jeta duhet të jetë gjithë aventura. Por ja që një ditë babai i Hakëlberit shfaqet dhe e rrëmben, duke e marrë të jetojë me të në pyll. Se si do të arrijë ai t'i shpëtojë rrëmbimit nga i ati dhe cila do të jetë aventura e tij si hero, do ta mësoni në këtë libër fantastik aventuresk nga autorja Sarah Rosi.

DAVID KOPERFILDI

David Koperfild është një djalë i vogël, që ka lindur kur i ati nuk ishte më në këtë botë. Kështu, e ëma e tij martohet me një burrë tjetër, që të mund t'i sigurojë të birit një të ardhme. Por shpejt edhe ajo ndërron jetë dhe Davidi i vogël gjendet përballë një njerku të pashpirt, i cili e dërgon të punojë në një vend të largët, në njërën prej fabrikave të tij. Aty ai njeh njerëz të mirë dhe të këqij dhe për t'i shpëtuar asaj jete të vështirë, ia mbath dhe vihet në kërkim të teze Betsit. Se si do të mund t'ia ndalin mbanë personazhet, se si David Koperfildi njeh hap pas hapi dashurinë, vuajtjet, zhgënjimet dhe si kupton që jeta është një sfidë, e cila gjithnjë përfundon me një dashuri të madhe, do ta mësoni në këtë libër.

DJEMTË E RRUGËS "PAL"

Në një nga lagjet e Budapestit, ku po bëheshin gjithnjë e më shumë ndërtime, ndodhej ende një fushë e lirë për të cilën dy grupe djemsh të cilët nuk kishin më hapësira për të luajtur, "luftojnë" për ta zënë. Djemtë e rrugës "Pal" janë disa djem të cilët të udhëhequr nga komandanti i tyre Boka dhe me ndihmën e Nemeçekut të vogël arrijnë t'i mposhtin kundërshtarët e tyre dhe ta zënë fushën.

Është historia e disa djemve të cilët edhe pse të vegjël arrijnë të përballojnë me kurajë situata, ndonjëherë më të mëdha se vetë ata.



DRAKULA

Xhonatan Harkeri as nuk ia ka idenë se çfarë tmerresh e presin në kështjellën e kontit Drakula. Një qenie e ligë është e uritur për gjak të ri. A mundet Xhonatani dhe miqtë e tij ta mposhtin atë? Secila skenë e rrëfimit bëhet më e qartë nëpërmjet ilustrimeve shoqëruese.

ANA FLOKËKUQJA

Methju dhe motra e tij, Marila, kishin vendosur të birësonin një djalë, që t'i ndihmonte në fermën e tyre, por gabimisht jetimorja u dërgon Anën, një vajzë me flokë të kuq dhe tepër ëndërrimtare. Me imagjinatën, kokëfortësinë, zgjuarsinë e saj, ajo arrin t'i bëjë për vete dhe të sjellë gjallëri në Grin Gejbëlls.

Çdo ditë është një aventurë e re për Anën, e cila edhe pse padashur bën shumë prapësi, gjithnjë e karakterizon humori të cilin e përçon edhe te njerëzit që e rrethojnë.

REMI PA FAMILJE

Remi, djaloshi të cilin e kishin gjetur të braktisur në një nga rrugët ku banonin të pasurit e Parisit, ishte rritur me shumë dashuri derisa ndodh diçka që e ndryshon krejtësisht jetën e tij.

Zoti Vitali vendos që ta marrë Remin në trupën e teatrore dhe së bashku enden nëpër Francë duke dhënë shfaqje. Djaloshi i vogël kalon shumë vështirësi, derisa më në fund fati e bashkon me familjen e tij të vërtetë.

GRA TË VOGLA

Katër motra jetojnë me nënën dhe shërbyesen pasi babai i tyre ishte nisur për në luftë. Të katërta vajzat, të cilat babai i tyre i quan "gra të vogla", edhe pse kanë karaktere krejt të ndryshme, janë shumë të lidhura me njëra-tjetrën.

Ato përballen me situata nga më të ndryshmet që shoqërojnë përditshmërinë dhe rritjen e tyre në kohë të vështira.

SERIA DOKTOR GJENIU

Tituj: 2 (seri e hapur)

Faqe: 30, me ngjyra

Formati: 300 x 260 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 900 lekë; 6.5 euro; 400 den (për libër)

Kjo seri përmban lojëra zbavitëse, logjike dhe inteligjente, që e ndihmojnë fëmijën të zhvillojë kujtesën, shkathtësinë mendore dhe përqendrimin. Me këta libra, duke ushtruar "materien gri", përforcohet shëndeti i trurit.

Dy libra me një stilolaps elektronik, i cili tregon nëse përgjigjja është e saktë apo jo. Për këtë mjafton që fëmija të vendosë lapsin në rrathët e vegjël të zinj.

SERIA DEDEKTIVI INTELIGJENT

Tituj: 2 (seri e hapur)

Faqe: 30, me ngjyra

Formati: 300 x 260 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 900 lekë; 6.5 euro; 400 den (për libër)

Këto libra do të vënë në provë zgjuarsinë dhe mendjemprehtësinë tënde!

Provo aftësitë e tua hetuese përmes lojërave argëtuese logjike, inteligjente, vëzhguese dhe bëhu një dedektiv i vërtetë.

Ti mund ta gjesh nëse je përgjigjur saktë, falë lapsit tënd elektronik.

Seria

Një familje e paparë

NJË FAMILJE E PAPARË

Tituj: 21 (seri e hapur)
Faqe: 48, me ngjyra
Formati: 120 x 180 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g.
Çmimi: 420 lekë; 3.5 euro; 200 den (për libër)

NDIHMË! PO NDËRROJMË SHTËPI

Kur mami dhe Pieri u kthyen nga një fundjavë romantike, Lolës dhe Tomit u komunikuan një lajm: familja do të transferohej në një shtëpi në periferi të Parisit. Lola filloi të ulërinte: "Kjo është kot e superkot fare!". As që mund të bëhej fjalë të ndahej nga Alisa, shoqja e saj e ngushtë deri në vdekje... Po kështu edhe Tomi...

NJË DITË QË FILLOI TERS

Është e çuditshme! Kur dita nis keq, shkon për dreq deri në darkë. Lola kaloi një ditë të tmerrshme. E gjitha kjo, sepse në mëngjes prindërit dolën shumë herët dhe ajo dhe i vëllai, Tomi, duhej të merreshin me qenin, përpara se të niseshin për në shkollë. Pastaj... tersllëqet ndoqën njëri-tjetrin...

NJË E MËRKURË E PAZAKONTË

E mërkura është një ditë e rëndësishme për Lolën. Ajo ka kursin e kalërimit me kalin e vogël, ponin... Asaj i pëlqen shumë kalërimi! E mërkura e Lolës u dreqos... fillimisht zënka e mamit me marangozin, që e kishte punuar shumë keq parketin, më pas telefonata nga spitali për Tomin që kishte përfunduar në urgjencë...

KUR TË ZËNË ME PRESH NË DORË

"Kush vjedh një gjilpërë, vjedh një ka të tërë"... Lola e di mirë këtë. Gjyshi ia ka përsëritur 100 herë. Megjithatë, ajo mori sheqerka në dyqanin e zotit Martino. Disa ditë më vonë, vëllai i saj, Tomi vodhi dy DVD. Kuptohet që, kur e morën vesh prindërit... mirë se erdhët telashe!

BEBJA... JO NDONJË GJË E MADHE

Lola ishte shumë e gëzuar që po përgatiste festën e ditëlindjes së mamit. Vetëm se Romana, motra e vogël, vendosi të vinte në jetë tamam këtë ditë. Të gjitha planet u përmbysën dhe Lola u zemërua shumë me këtë bebe që i prishi ditën dhe "i mori mamin"...

O ZOT, ÇFARË NATE!

Gjithçka ndodhi, sepse dadoja e Lolës nuk mund të vinte atë natë... dhe Tomi, vëllai i madh që duhej të kujdesej për të, donte të shkonte patjetër në një festë te një shok dhe i gënjeu prindërit, duke e marrë edhe Lolën me vete...

NJË E DIEL KOTI

Është e diel. Familja e Lolës është e ftuar për vizitë te halla jo e vërtetë. Të shkosh për të ngrënë një byrek tradicional, nuk është ndonjë argëtim i madh, sidomos kur nuk ke dëshirë. Të gjithë janë të acaruar... Kjo ishte një e diel koti.

SHUMË ZHURMË PËR ASGJË!

Ka shumë njerëz që shkojnë në mal për sportet e dimrit, por ka edhe të tjerë, si Lola, që do të dëshironin të rrinin në të ngrohtë, nën batanije. Aq më tepër kur përfundoi në spital, sepse të gjithë kujtuan se theu këmbën. Por Lolës thjesht i ishte spërdredhur çorapi te pulpa...

SA VËSHTIRË TË JESH VETËM!

Lola do t'i kalonte pushimet e prillit te babi, mirëpo ai niset në një udhëtim pune në fund të botës. Rezultati: ajo përfundon te gjyshja duke ngrënë peshk çdo vakt, që i vjen në majë të hundës. Mirëpo, kur kthehet në shtëpi, mami i saj ishte nisur për një konferencë super të rëndësishme, babai i saj jo i vërtetë nuk "e pret" dhe aq mirë dhe... U mbush kupa! Lola nuk duron më... dhe planifikon një... arratisje.

ÇFARË TMERRI!

Tomi ka një detyrë të veçantë: ai duhet të kujdeset për Lolën dhe Zhadën, vajzën e vogël të kushërirës së mamit. Ai i premton mamit për këtë. Por në shtëpi vjen Mediu, shoku i tij i ngushtë, që harron të mbyllë derën e shtëpisë. Ç'katastrofë! Zhada picirruke del jashtë vetëm me Kroketën. Qeni dhe vajza e vogël shëtitin në rrugë, në mes të trafikut... Si mendoni se reagon mami?!

DASHURIA ËSHTË E BUKUR!

Lola është shumë e gëzuar: ajo do të shkojë në një dasmë. Por, më e bukura... ajo do të jetë shoqëruesja e nuses. Natyrisht, ka veshur një fustan princeshe dhe i ka bërë flokët me rrica, ashtu siç ka ëndërruar gjithmonë. Eh, në të vërtetë, dasmat janë super argëtuese! Dhe, sidomos, kur shoqëruesi tjetër i nuses është një djalë me emrin Antuan. Lola kupton se ai e bën të ndihet shumë, shumë mirë! Atëherë, ajo pyet veten: Kjo është dashuria?!

NJË HISTORI ME QEN

Lola i adhuron pushimet te gjyshi! Për më tepër që këtë herë me të është Tomi dhe shoku i tij, Mediu, madje edhe Kroketa. Asaj i pëlqen shumë të shkojë te fqinjët e gjyshit. Atje është si në panairet e Parisit: ka kafshë të të gjitha llojeve, si pula, bretkosa, peshq, pata, gjithashtu, edhe lepuj, lepuj të mrekullueshëm... Por, me të gjitha këto që ka fshati, gjithçka mund të ndodhë, madje edhe ndonjë mashtrim që, shpejt, del në dritë.

SI NJË E RRITUR

Lola ëndërron të ndihet e rritur: të ketë një celular dhe të dalë vetëm nëpër qytet. Por asaj nuk i lejohen këto. Por ja që një ditë, mami i beson Lolës dhe shoqes së saj një mision: të blejnë panine me çokollatë në furrën e bukës aty pranë. Ajo fluturon nga gëzimi dhe është shumë krenare për këtë! Fatkeqësisht, ajo harron këshillat e mamit dhe, bashkë me shoqen e saj, Zhanën, mendojnë ta zgjatin pak rrugën për në shtëpi. Dhe... nga kjo aventurë, gëzimi shndërrohet në... një mësim të mirë.

BABI IM ËSHTË VETËM IMI

Lola ndihet si në qiellin e shtatë. Mezi pret të shkojë me pushime, sepse do t'i kalojë ato me babin. Ajo ka kohë që s'e ka parë atë dhe ka shumë gjëra për t'i treguar. Mirëpo, edhe ai ka diçka me rëndësi për t'i thënë. Por pushimet filluan ters: zhytja në pishinë nuk shkon siç duhet. Le pastaj... zhdërvjelltësia e Tomit, vëllait të saj, bën që të gjithë të shohin vetëm atë. Pastaj vjen "ai lajmi i madh i babit", që e bën Lolën të ndihet edhe më keq... edhe më keq...

NË SHTËPINË E ZHANËS TË IKËN TRURI

Lola bashkë me prindërit e saj është ftuar për darkë te shoqja e saj, Zhana. Për fatin e saj të madh, ajo do të qëndrojë edhe për të fjetur tek ajo. Por në shtëpinë e Zhanës fëmijët sillen shumë çuditshëm: nuk i dëgjojnë prindërit e tyre dhe, mbi të gjitha, sillen siç ua do qejfi. Lola habitet shumë dhe imagjinon se çfarë mund të ndodhë në shtëpinë e saj, nëse ajo dhe Tomi sillen kështu...

EMA E KA MENDJEN VEÇ TË HAJË

Jo, Ema nuk është si balenë, siç tallen djemtë në pishinë! Madje Lolës ajo i duket si princeshë. Edhe pse ka disa kilogramë më tepër, kjo nuk është një arsye për t'u tallur me të. Ema është shumë e mërzitur për këtë. Edhe pse familja e ndihmon shumë, ajo e ka kaq të vështirë të dobësohet. Emës i duket e padrejtë që Mediu ha si ari dhe nuk shëndoshet, kurse ajo... Por e vërteta është se ne nuk jemi të gjithë të barabartë para ushqimit.



PIERI NDËRRON PROFESION

Papunësia u fut frikën si të rriturve, ashtu edhe fëmijëve. Kompaninë e Pierit, babait jo të vërtetë të Lolës, do ta blejë një kompani tjetër dhe ai do të mbetet pa punë. Lola është shumë e shqetësuar dhe e pyet veten se pse pikërisht Pieri duhet të mbetet i papunë. Një ditë Pieri i njofton se do të rikthehet në shkollë, sepse dëshiron të ndryshojë profesion... Por profesioni i tij i ri në fillim nuk i pëlqen aspak Lolës dhe Tomit!



FUTBOLLI NUK ËSHTË VETËM PËR DJEMTË

Në të vërtetë, jo vetëm djemtë dinë të luajnë futboll, por edhe vajzat janë sulmuese të mira dhe dinë ta mbrojnë portën. Dhe për këtë bindesh plotësisht, po të shohësh Kapuçinën me topin ndër këmbë. Sa i përket Lolës, këtu çështja është pak më e komplikuar, por ajo është gati të bëjë gjithçka për të shënuar një gol kundër djemve!

OBOBO, KROKETA ËSHTË SËMURË!

Të shëtitësh në pyll është shumë argëtuese! Mirëpo gjatë shëtitjes Kroketa gëlltit një copë sfungjeri dhe nga shëtitje kthehet në ekspeditë. Kur kthehen në shtëpi, Lola dhe Tomi duhet të lajnë Kroketën e zhytur në baltë. Kjo është një tjetër aventurë. Më e keqja është se këtë herë Kroketa sëmuret keq.

Atë natë në familjen e Lolës gjendja ishte si luftë. Ehhh! Lola do të donte të ishte e rritur, që të kujdesej vetë për qenushen e saj. Madje kur të rritet, ajo do të bëhet veterinere.

SFIDË! NJË JAVË PA EKRANE

Shkolla e Lolës vendos të bëjë një sfidë: një javë pa ekrane! Dhe sfida vlen për të gjithë familjen. Një javë pa telefon, pa kompjuter, pa tablet, pa televizor... pa asnjë ekran. Oh, jo, kështu fëmijëve iu duket sikur e gjithë jeta ndalon. Prandaj ata duhet ta organizojnë ditën ndryshe: të bëjnë shëtitje, veprimtari të ndryshme, të lexojnë, të luajnë me kushërinjtë dhe shokët, të gatuajnë me prindërit etj. Por në këtë sfidë të madhe, ata që rrinë të menduar edhe mund të gënjejnë...

PANIK NË AUTOSTRADË

Një ditë Lola e gjorë e gjen veten të vetme, të harruar, në stolin e parkingut të një pike karburanti në anë të autostradës. Ajo fillon të qajë e frikësuar, sepse prindërit e saj ishin larguar nga pika e karburanti pa e vënë re se ajo nuk ishte më në makinë, pasi ishin shumë të zënë duke debatuar me njëri-tjetrin. Lola ishte betuar se do të qëndronte në makinë me Kroketën, mirëpo nuk e mbajti fjalën...

Seria Kryeveprat e antikitetit

KRYEVEPRAT E ANTIKITETIT
Tituj: 3 (seri e hapur)
Faqe: 48, me ngjyra
Formati: 120 x 180 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g.
Çmimi: 1300 lekë; 11 euro; 660 den (për libër)



ILIADA TREGUAR FËMIJËVE

Në poemën *Iliada* tregohet se çfarë ndodhi gjatë javëve të fundit të luftës së Trojës, në të cilën u ndeshën grekët dhe trojanët. Kjo luftë zuri fill me zemërimin e Akilit, heroit më të madh grek, prej fyerjes që i kishte bërë mbreti Agamemnon. Sa dëme e sa dhimbje do të shkaktonte ajo luftë! Fjalët e bukura me të cilat e ka kënduar këtë histori Homeri, kanë bërë që ajo të lërë gjurmë në kohë, deri në ditët tona. Kjo poemë e Homerit vjen e treguar aq bukur në prozë, me fjali plot rimë dhe figuracion, i përshtatur për fëmijë.



ODISEJA TREGUAR FËMIJËVE

Lufta në Trojë tashmë kishte mbaruar prej kohësh. Pasi kishin mundur trojanët, grekët ishin kthyer në tokën e tyre. Por Odiseja, një nga luftëtarët grekë më dinakë, ende nuk kishte mbërritur në ishullin e bukur të Itakës, ku prej vitesh e priste Penelopa, gruaja e tij, dhe Telemaku, i biri. Nimfa Kalipso e mbante të burgosur në ishullin e saj, e bindur se me kalimin e kohës do të pranonte të martohej me të. Uliksi derdhte lot inati dhe priste me padurim të kthehej në atdhe dhe do të përqafonte gruan e tij. Por si të ikte nga ishulli, kur në të nuk kishte asnjë barkë? Të gjitha bëmat dhe kthimin e tij në Itakë do ta gjeni në këtë klasik të përshtatur për fëmijë. Kjo poemë e Homerit vjen e treguar aq bukur në prozë, me fjali plot rimë dhe figuracion, i përshtatur për fëmijë.



ENEIDA TREGUAR FËMIJËVE

Heroi Ene tashmë i njohur në luftën e Trojës, është një luftëtar i shquar trojan. Kjo pemë e përshtatur për fëmijë tregon për peripecitë e udhëtimit të heroit trojan Eneas, pas rënies së Trojës. Perënditë duke e parë në atë gjendje, i premtojnë pushtetin në një të ardhme të afërt. Kështu, ai ndërmerr udhëtimin. Përpara se të arrijë në Romë për të formuar mbretërinë e tij atje, ai qëndroi për pak ditë edhe në Butrint. Këto e shumë peripeci të tjera të luftëtarit trim trojan i gjeni në këtë poemë, që vjen e treguar aq bukur në prozë, me fjali plot rimë dhe figuracion.

Seria

Klasikët për fëmijë

KLASIKËT PËR FËMIJË

Tituj: 13 (seri e hapur)
Formati: 150 x 210 mm
Kopertina: e fortë, mat

Seria e klasikëve për fëmijë vjen e re dhe e freskët, përmes titujve, si "Princi i vogël", "Piter Pani", "Aventurat e Pinokut", "Bëmat e Lizës në botën e çudirave", "Princi i lumtur dhe përralla të tjera", "Zemër", etj. Këto vepra, shumë të njohura nga lexuesi i vogël, vijnë të përkthyera nga veprat origjinale dhe janë shoqëruar me ilustrime të këndshme. Shoqëria me personazhet e tyre do të jetë një kënaqësi e vërtetë për ju.



PRINCI I VOGËL

Faqe: 75, bardhë e zi
Çmimi: 700 lekë; 6 euro, 350 den

Historia e një djaloshi, që lë planetin e tij të vogël për të udhëtuar nëpër planetë të tjerë. Princi i vogël njihet me sjelljet tekanjoze të të rriturve, përmes disa takimeve me personazhe të çuditshme... Ky rrëfim i të fëmijët përballë një sërë pikëpyetjesh: *Pse të rriturit e kanë kaq të vështirë të kuptojnë të vegjlit? Pse kanë ngritur një shoqëri, në të cilën shifrat kanë më rëndësi se përjetimet, ndjenjat?* "Ne shohim qartë vetëm me zemër. Thelbësorja është e padukshme për sytë", ky ndoshta është një nga mësimet më të bukura të princit të vogël. Ky libër ka fituar zemrat e fëmijëve në mbarë botën me historinë plot me mesazhe universale.



PITER PANI

Faqe: 262, bardhë e zi
Çmimi: 950 lekë; 8 euro; 500 den

Një mbrëmje, një djalë i çuditshëm duke fluturuar hyn në dritaren e shtëpisë së Darlingëve. Këtu zënë fill aventurat e Piter Panit, Uendit, Xhonit dhe Majkëllit, Lulekëmborës, Djemve të Humbur etj., në ishullin mitik të Kurrkundit. Piter Pani është djalosh çapkën dhe plot gjallëri, që arrin të fluturojë dhe nuk rritet asnjëherë. Fëmijërinë e tij që nuk mbaron kurrë, ai e kalon me peripeci, si kryetari i Djemve të Humbur, ndërkohë që bashkëvepron me zana, piratë, sirena dhe me fëmijë të zakonshëm nga bota jashtë Kurrkundit.



AVENTURAT E PINOKUT
Faqe: 168, bardhë e zi
Çmimi: 750 lekë; 5.5 euro; 330 den

"Aventurat e Pinokut" është një prej klasikëve më të njohur në letërsinë mbarëbotërore, shkruar prej autorit italian Karlo Kolodi. Në këtë libër rrëfehet se si një marangoz plak vendos të ndërtojë një kukull druri me një dru që gjen rastësisht në punishte, meqë rronte i vetmuar. Por, ndërsa punonte, ai shpreh me vete dëshirën që kjo kukull të ishte një djalosh i vërtetë, një djalë që atij i ka munguar prej vitesh. Për çudi, Zana Flokëkaltër e dëgjon këtë dëshirë të marangozit plak dhe ajo i jep jetë kësaj kukulle druri. Pikërisht në këtë moment nisin aventurat e mrekullueshme të kësaj kukulle të pazakontë.

PRINCI I LUMTUR
Faqe: 168, bardhë e zi
Çmimi: 900 lekë; 7.5 euro; 450 den

Princi i Lumtur; Mbreti djalosh; Peshkatari dhe Shpirti i tij; Miku i përkushtuar; Bilbili dhe trëndafili; Vigani egoist; Fushqeta e mrekullueshme; Ditëlindja e Infantës; Fëmija-Yll janë 9 përralla të bukura dhe magjike, të rrëfyera nga Oskar Uajlld dhe të shoqëruara me ilustrime. Rrëfimi emocional i ngjarjeve dhe i personazheve, ku realiteti ndërthuret me imagjinatën, e njohura me të panjohurën, e zakonshmja me të jashtëzakonshmen e bën leximin e këtyre përrallave një udhëtim fantastik. Këto përralla përbëjnë një koleksion të përkryer për të gjitha moshat.



BËMAT E LIZËS NË BOTEN E ÇUDIRAVE
Faqe: 116, bardhë e zi
Çmimi: 900 lekë; 7.5 euro; 450 den

Udhëtimi fantastik i vogëlushes Lizë, i rrëfyer mjeshtërisht nga Ljuis Keroll, vjen në këtë botim të ri. Teksa po qëndronte pranë lumit me motrën e saj, Liza papritur shikon lepurin e Bardhë. Ajo bëhet kureshtare dhe e ndjek atë. Këtu fillojnë bëmat e saj në botën e çudirave, ku takon krijesa nga më të çuditshmet: macen ngërdheshëse, Kapelabërësin, mbretin, mbretëreshën etj. A do të arrijë të kthehet në shtëpi Liza? Për të mësuar më shumë mbi bëmat e Lizës në botën e çudirave lexoni këtë klasik të shoqëruar me ilustrime.



ZEMËR
Faqe: 304, bardhë e zi
Çmimi: 950 lekë; 7 euro; 420 den

I shkruar 132 vjet më parë, më 1886, nga një prej shkrimtarëve më të njohur e klasikë italianë, Edmondo de Amiçis, romani **"Zemër"** mbetet ende nga ata libra që lexohet me kënaqësi, me dhembshuri dhe me përgjegjësinë për të menduar një botë ku mëtohet përsosmëria drejt së mirës. Personazhet e paharrueshme, si Shkruesi i vogël fiorentin, Enriku, Garoni guximplotë, Markoja që kërkon të ëmën duke u nisur nga Apeninet e duke përfunduar në Ande, Çiçili tek Infermieri i Tatës dhe Feruços me gjyshen e tij të paralizuar, do të rizgjojnë në kujtesë fëmijërinë e prindërve të sotëm, po aq sa do të paraqiten për herë të parë për lexuesit e sotëm të vegjël.



KOPSHTI SEKRET
Faqe: 296, bardhë e zi
Çmimi: 1100 lekë; 9 euro; 550 den

Meri Lenoksi është një vajzë 10-vjeçare, e bija e një familjeje të pasur angleze. Pasi humbet prindërit nga epidemia e kolerës, e çojnë për të jetuar te familja e xhaxhait të saj. Pas disa kohësh ajo zbulon se në atë shtëpi ka gjëra që i janë mbajtur të fshehta: në shtëpinë e tyre ishte dhe një tjetër pjesëtar familjeje, Kolini, të cilin e mbanin të fshehur për shkak të sëmundjes së tij. Kishin dhe një kopsht sekret, në të cilin ndodhin mrekulli.



HAJDI
Faqe: 308, bardhë e zi
Çmimi: 950 lekë; 7 euro; 420 den

"Hajdi" është një histori që ndoshta nuk është e vërtetë, ndoshta ka ndodhur vetëm në imagjinatën e autores, por është kaq e besueshme. Hajdi është një vajzë 5-vjeçare, simbol i mirësisë, i dashurisë për njerëzit më të afërt të familjes, por jo vetëm për ta. Gojëmbël, çamarroke, e padjallëzuar, admiruese e kafshëve, luleve, e të gjitha qenieve frymuese, e bukurisë natyrore dhe njerëzore, të gjitha këto veçori autorja i vë në shpirtin e një fëmije trupvogël dhe jo rastësisht ajo e dërgon atë nga një vend në tjetrin. *A ia doli Hajdi, që me dëlirësinë dhe mirësinë e saj, t'i ndryshojë njerëzit me të cilët ndeshet gjatë udhës së saj? A triumfoi mirësia e saj, në një botë ku ligësia, thashethemet, varfëria dhe djallëzia bashkëjetojnë? A mundi ajo t'u thotë të gjithë fëmijëve, se jeta është më e bukur dhe kuptimplotë, nëse e do me gjithë shpirt gjithçka që të rrethon?*



NILS HOLGERSONI
Faqe: 586, bardhë e zi
Çmimi: 1 100 lekë; 8 euro; 480 den

Nilsi është një 14-vjeçar trazovaç, i cili sillet keq me të gjithë, sidomos me kafshët. Si dënim i sjelljes së tij, ai shndërrohet në xhuxh, ku dhe duhet të shlyejë të gjitha këto prapësi. Hipur mbi shpinën e patokut të tij Martin, ai tashmë fillon ta shikojë botën me një sy tjetër: ta shikojë nga lart. Udhëtimi i Nilsit nuk është vetëm një udhëtim fizik, por edhe një udhëtim brenda vetes së tij. Të zënë me punët e fermës dhe të kufizuar nga një filozofi prindërimi autoritar, prindërit e Nilsit kanë dështuar aty ku pata e moçme Aka ka sukses. Ajo me mjaft maturi i mëson Nilsit vlerën dhe bukurinë e punës, mirësisë, miqësisë dhe fjalës së dhënë. Ajo e përfshin Nilsin në jetën e përditshme, i jep detyra që e bëjnë të ndihet i vlefshëm. Nilsi e përfundon udhëtimin si një djalë i fortë, që di të dojë dhe të respektojë veten dhe të tjerët.



POLIANA
Faqe: 256, bardhë e zi
Çmimi: 880 lekë; 6.5 euro; 390 den

Poliana njëmbëdhjetëvjeçare, pas vdekjes së prindërve, shkon të jetojë në Vermont, me teton e saj hijerëndë, Polin. Megjithatë, vogëlushja nuk pranon kurrsesi t'i nënshtrohet gjendjes së zymtë, por, përkundrazi, zgjedh të shohë anën e mirë të gjërave. Me anë të "lojës së gëzimit", të cilën ia ka mësuar babai, Poliana gjen arsye që të gëzohet në çfarëdo situate dhe përballon çdo pengesë. Vogëlushja i nxit të tjerët t'i bashkohen lojës së saj të gëzimit dhe të ndryshojnë jetën e tyre të zymtë. Mes lojtarëve të rinj janë zonja Snou, Xhon Pendëlltëni, Nensi etj. Të gjithë tregohen bujarë për ta pranuar në jetën e tyre vajzën e hareshme, që nuk njeh lodhje, edhe pse asaj i duhet të përballojë dhe të kapërcejë sfidat e veta.



POLIANA RRITET
Faqe: 320, bardhë e zi
Çmimi: 950 lekë; 7 euro; 420 den

Poliana, tashmë e shëruar nga dëmtimi në shpinë, vazhdon të përhapë "lojën e saj të gëzimit" nëpër qytet. Poliana tani është një zonjushë e hijshme shtatëmbëdhjetëvjeçare, e cila njeh për herë të parë dashurinë. Si do të përballojë zemra e re ndjenjën e parë romantike?



GOSTIA E KONTESHËS BERTA DHE TREGIME TË TJERA

Faqe: 120, bardhë e zi

Çmimi: 650 lekë; 5.5 euro, 330 den

Zoti Libërxhepi ju rrëfen historinë e konteshës Berta dhe të gostisë së saj të përvitshme me mjaltë në çdo përvjetor të ndërtimit të kështjellës. Çfarë ndodh nëse thyhet tradita e përvitshme? Historinë e trishtë e dashurisë së ushtarit prej plumbi me një këmbë dhe balerinës prej letre, të cilët digjen së bashku, udhëtimin e Gishtëzës mendjemadhe dhe aventurën e saj një ditë në fluturim, si dhe historinë e mbretit të urithëve dhe vajzës së tij mund t'i lexoni në tregimet e tjera. Aventura, peripeci dhe momente qesharake i shoqërojnë personazhet tona deri në fund.



ANA FLOKËKUQJA

Faqe: 418, bardhë e zi

Çmimi: 1100 lekë; 8 euro, 480 den

"Ana flokëkuqja" e autorit kanadez L. M. Montgomery është varianti i plotë i një prej romaneve klasike, nga më të bukurit e më të lexuarit e letërsisë botërore, që rrëfen aventurat dhe bëmat e Ana Shirlit, vajzës që mbeti jetime e që u rrit duke punuar që foshnjë, vajzës plot jetë e gjallëri, që 11 vjeçe u bë pjesëtare e denjë e familjes Kuthberti në Çatiblertë.



AVENTURAT E TOM SOJERIT

Faqe: 284, bardhë e zi

Çmimi: 950 lekë; 7 euro; 420 den

Shumica e aventurave që rrëfehen në këtë libër kanë ndodhur vërtet. Tom Sojeri, është ndërthurja e tipareve të tre djemve, ndaj klasifikohet në rendin e ndërlikuar të arkitekturës.

Besëtytnitë e çuditshme gjallojnë fort mes fëmijëve dhe skllevërve në perëndim, në kohën kur zhvillohen ngjarjet e këtij libri, pra nja tridhjetë e dyzet vjet të shkuara.

Edhe pse libri ka më së pari synimin të argëtojë djemtë e vajzat, për këto arsye nuk duhet të lihet pas dore nga burrat e gratë, që me shumë ëndje të mund të kujtojnë se si kanë qenë dikur dhe se si ndiheshin, si mendonin e si flisnin etj.

DJEMTË E RRUGËS PAL

Faqe: 284, bardhë e zi

Çmimi: 950 lekë; 7 euro; 420 den

Dy banda djemsh luftojnë për një copë tokë, për një kantier të braktisur. Për djemtë e rrugës Pal, kjo copë tokë është një simbol i dashur i lirisë. Janosh Boka, udhëheqësi i grupit të djemve të rrugës Pal, dhe Ernest Nemeçeku, anëtari më i vogël dhe më i pafuqishëm i këtij grupi, janë personazhet kryesore të romanit, mishërues të besnikërisë, të guximit dhe të drejtësisë. Boka dhe Nemeçeku, së bashku me djemtë e tjerë, janë të vendosur për ta mbrojtur kantierin nga Kësulëkuqët, një bandë tjetër djemsh, e udhëhequr nga Feri Átsi.



AVENTURAT E DINPAKUT DHE TË SHOKËVE TË TIJ

Faqe: 284, bardhë e zi

Çmimi: 950 lekë; 7 euro; 420 den

Në *Qytetin përrallor* të Luleve jetonin njerëz me madhësinë e një kastraveci të vogël e me karaktere të ndryshme. Midis tyre ishte edhe Dinpaku, një fëmijë që i pëlqenin ngjyrat, që kërkonte të merrte mësime muzike e pikture, që përpiqej të drejtonte automjete, të shkruante poezi, por që çdo përpjekje e tij përfundonte gjithnjë në katastrofë, për shkak të padurimit të tij. Por ishte edhe Dinshumi, një fëmijë i zgjuar që lexonte shumë libra, bënte shpikje dhe shpesh u tregonte fëmijëve për zbulimet e tij.

Të gjitha këto rrëfehen me një stil të thjeshtë, humoristik dhe njëkohësisht mjaft të këndshëm për fëmijët.



PËRRALLAT E VËLLEZËRVE GRIM

Faqe: 856, bardhë e zi

Çmimi: 2500 lekë; 22 euro, 1250 den

Përrallat e Vëllezërve Grim, një trashëgimi e vyer e letërsisë për fëmijë, shërbejnë si simbol i të gjitha përrallave botërore dhe si burim i pashtershëm i përrallave të shkrimtarëve bashkëkohorë. Me veprën e tyre ata shpalosin përpara lexuesit figura mitologjike, popullore, figura kafshësh, pyje misterioze etj., duke i stolisur me një shpirt romantik, plot fantazi, me fjalë të urta, epitete e figura të bukura letrare.

PËRRALLAT E ANDERSENIT

Faqe: 896, bardhë e zi

Çmimi: 2500 lekë; 22 euro, 1250 den

Përrallat e Andersenit janë një trashëgimi e mrekullueshme e letërsisë për fëmijë, por edhe për të rritur. Krijimtaria e tij është mbështetur në gurrën e urtisë së pashtershme popullore jo vetëm të vendit të tij, por edhe të vendeve të tjera që vizitoi.

Përralla e tij shpalosin mençurinë dhe filozofinë e vendit të tij dhe popujve që njohu dhe vizitoi. Këto përralla janë një visar i çmuar, që duhen vlerësuar e ruajtur me kujdes, sepse në pjesën më të madhe të tyre ato përshkruajnë ngadhënjimin e së mirës ndaj së keqes, fuqive të mira ndaj atyre të këqija.

Seria Më quajnë...

MË QUAJNË...

Tituj: 27 (seri e hapur)
Faqe: 64, me ngjyra
Formati: 145 x 210 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 600 lekë; 5 eur; 300 den

Është një seri për fëmijë me biografitë e personazheve botërore e shqiptare. Çdo libër flet për një figurë të shquar të historisë, shkencës, artit, kulturës, letërsisë a të mendimit, që në vetë të parë tregon në mënyrë shumë të këndshme jetën dhe veprën e vet, si dhe mjedisin dhe kohën në të cilën jetoi. Ilustrimet e pasura, të frymëzuara nga epoka, na zhytin në kohën dhe botën e tyre.





MË QUAJNË... MBRETËRESHË TEUTA

Mbretëresha ilire Teuta është një nga figurat më spikatëse të grave në historinë europiane, që kanë drejtuar shtete dhe fuqi të mëdha. Ajo ishte gruaja e mbretit të lavdishëm Agron, i cili vdiq papritur në vitin 231 para erës sonë dhe ishte ajo që mori në dorë fatet e Ilirisë. Shkodra në atë kohë ishte një nga qytetet e dëgjuara në Adriatik e Mesdhe. Me një zgjuarsi dhe kurajë të veçantë, kjo strategе ushtarake i dha një dritë të re qytetërimit ilir. Por, në një luftë të pabarabartë me Senatin Romak, më së fundi ajo pranoi të tërhiqej nga froni, në mënyrë që vendi i saj të mos digjej e shkretohej nga ushtritë e huaja.

MË QUAJNË... GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU

Gjergj Kastrioti Skënderbeu është heroi më legjendar i historisë shqiptare, i cili para më shumë se pesë shekujsh çliroi Shqipërinë nga zgjedha osmane dhe u bë një nga mbrojtësit më të mëdhenj jo vetëm të shqiptarëve, por dhe të popujve të tjerë të Europës. Personalitetet më të shquara të Perendimit në atë kohë e më pas, i ngritën himn figurës së tij, e cila u kthye në një referencë të shkëlqyer për shekujt që do të vinin.



MË QUAJNË... MUSINE KOKALARI

Lindi në Adana të Turqisë dhe kaloi fëmijërinë në Gjirokastër, qytetin përrallor, që i dukej sikur fluturonte. Ajo është shkrimtarja e parë shqiptare, që u vlerësua që në fillim për artin e saj me nivel të lartë. Në shkrimet letrare apo ato publicistike ajo vuri në qendër gruan shqiptare tradicionale dhe shpalosi nevojën për emancipimin e vajzave. Ishte një intelektuale demokrate, antifashiste e antikomuniste e shpallur, që besonte në lirinë e mendimit dhe të artit. Që gjatë Luftës themelon me intelektualë të tjerë Partinë Social-Demokrate. Mbas çlirimit, luftoi politikisht për mbrojtjen e lirive demokratike dhe të pluralizmit politik.

Ky libër fitoi çmimin e parë si libri më i mirë për fëmijë në Panairin e Librit 2017.



MË QUAJNË... ALEKSANDËR MOISIU

"Isha në Vjenë. Isha shumë i ri dhe shumë i varfër, u jepja mësime private gjuhe pak njerëzve të cilët patën besim tek unë. Në të vërtetë në atë kohë nuk kisha as idenë më të vogël se çfarë dëshiroja të bëhesha... Isha në kërkim të bukës së gojës, kisha uri të madhe e zorrët më këndonin në bark, kur rastësia e madhe më solli në Burgtheater si figurant.... (Debuti im në Burtheater)".

Ky libër fitoi çmimin e parë si libri më i mirë për fëmijë në Panairin e Librit 2016.

MË QUAJNË... IBRAHIM KODRA

Piktori Ibrahim Kodra lindi në Ishëm të Durrësit më 1918 dhe vdiq më 2006 në Milano, ku jetonte prej më shumë se gjysmë shekulli. Me një krijimtari të madhe prej gjashtë mijë veprash, ai konsiderohet si një nga modernët më të fuqishëm të piktorëve shqiptarë të gjysmës së dytë të shekullit XX. Në historinë e artit modern shqiptar e europian, Ibrahim Kodra ishte një nga profilet origjinale më spikatëse, që edhe pse jetoi jashtë Shqipërisë, ngjyrat dhe tema shqiptare ishin në thelbin e tij artistik. Bota e njohu si një pararendës të një qytetërimi të ri.



MË QUAJNË... ALI PASHË TEPELENA

Ali Pashë Tepelena, themelues i Pashallëkut autonom të Janinës. Lindi rreth viteve 1740-1750 në Tepelenë. Ali Pasha bëri historinë e kohës së tij. Arriti të ngrinte në këmbë një shtet të pavarur nga Porta e Lartë, duke qenë vetëm formalisht në Perandorinë Osmane. Janina u pasurua me librari, kolegje dhe shkolla. U ndërtuan kala, rrugë, ujësjellës e shumë objekte të tjera të rëndësishme. Ali Pasha krijoi aleancë me mbretin e Napolit, me Bonapartin, dhe pashallëku vizitohej nga figura të shquara, gjeneralë, piktorë dhe poetë.

MË QUAJNË... XHANFIZE KEKO

Xhanfise Keko lindi në Gjirokastër. Studioi në Moskë për kinematografi dhe filloi punë si montazhiere në Kinostudio. Vite më vonë do të xhironte dokumentarin e saj të parë "Tingujt dhe fëmijët", çka i hapi rrugën si regjisore. Filmi i saj i parë artistik ishte "Kryengritje në pallat", i ndjekur nga "Mimoza llastica", "Qyteti më i ri në botë", "Beni ecën vetë" , "Tingujt e luftës", "Tomka dhe shokët e tij", "Kur po xhirohej një film" etj. Që nga vdekja e Xhafise Kekos në vitin 2007, filmat e saj nuk kanë reshtur së shfaquri, duke prezantuar kinematografinë shqiptare dhe nëpër takime ndërkombëtare të filmit, si në Londër, Belfast, Paris, Nju-Jork, Selanik, Jerusalem, Tel Aviv, Kopenhagën, Zagreb, Vjenë, Frankfurt, Cyrih e shumë vende të tjera... Kështu realizimet e saj e bënë atë në njëfarë mënyre "qytetare të botës". Është vlerësuar me shumë çmime dhe sot është e para regjisore shqiptare për filmin për fëmijë.

ME QUAJNË... TEREZA E KALKUTËS

"Emri im është Anjezë Gonxhe Bojaxhiu, por të gjithë më njohin si Tereza e Kalkutës. Kurrë nuk më ka pëlqyer të flas për veten time dhe e pranoj që nuk i kam lexuar librat e shkruar për mua. Këtë herë, megjithatë, unë do bëj një përjashtim për ju, pasi fëmijët gjithmonë kanë zënë një vend të rëndësishëm në zemrën time".



ME QUAJNË... ISMAIL QEMALI

" ... Kjo Shqipëri, kur i kërcënohej rreziku Europës nga pushtimet e Turqisë, ndënë kryetrimin e pavdekur të saj, Skënderbejnë, u bë porta e hekurtë kundra sulmeve më të tërbuara të sulltanëve më t'egër që ka pas Turqia. Mirëpo, desh Zoti, që me punën, me trimërinë dhe guximin e pashoq të shqipëtarëvet, sot e tutje të marrin fund mjerimet dhe vuajtjet e Atdheut t'onë, sepse, këtu e kështu, jemi të LIRË të PAVARUR dhe MËVEHTE, prandaj: qeshni e gëzoni!..."

Nga fjalimi i Ismail Qemal Vlorës, më 28 nëntor 1912.



ME QUAJNË... DORA D'ISTRIA

"Shqiptarët nuk janë as sllavë dhe as helenë, por përfaqësuesit e një qytetërimi të vjetër, një nga më të lashtit e Europës, i cili ka lënë monumentet dhe kujtesën e vet në dy brigjet e Adriatikut dhe të detit Jon, me Skënderbeun, idealin e Mesjetës dhe Boçarin, personifikimin kalorësiak të kohëve moderne. Shekujt, shqotat, revolucionet, tiranët, pushtimet, fetë dhe mynxyrat e shumta kaluan si shkulme të tërbuara, pa arritur t'i shfarosin ata..." Nga letra e Dora d'Istrias drejtuar Jeronim de Radës, Firence, 16 prill 1879.



MË QUAJNË... ÇARLI ÇAPLIN

I lindur në Londër, Çarli Çaplini është një nga figurat kryesore të historisë së kinemasë. Ishte biri i një çifti aktorësh jo të njohur. Brenda pak vitesh arriti të kapërcente mjerimin në të cilin jetonte, duke u bërë aktori më i famshëm dhe më i paguar i epokës së tij. Në dyzet vjet mori pjesë në më shumë se tetëdhjetë filma, ku ia doli të kryente me sukses edhe aktorin, regjisorin, kompozitorin, si dhe producentin. U konsiderua si një gjeni i kinemasë, fillimisht asaj pa zë, dhe më vonë i kinemasë me zë. Karriera e tij filloi me komeditë, pastaj me filmat sentimentalë dhe dramatikë, për të përfunduar me filmat që denonconin shoqërinë dhe politikën. Krijimi i tij më i madh ishte personazhi i Sharlotit, një vagabond unik i llojit të tij për shkak të mustaqeve, kapelës, shkopit... dhe peripecive të tij, të cilat kanë emocionuar breza të tërë.



MË QUAJNË... GEGË MARUBI

Me shuarjen e Gegë Marubit u fik yllësia fotografike me emër e famë botërore Marubi, por nuk u mpak vlera e fondit fotografik 120-vjeçar.

Ai çdo ditë e më tepër bëhet i pranishëm dhe i dobishëm për botën kulturore dhe shkencore të shqiptarëve në të gjitha trevat ku ata banojnë. Një pjesë e madhe e këtij fondi, është fryt i mendjes dhe i dorës së Gegë Marubit.



MË QUAJNË... EQREM ÇABEJ

Profesor Eqrem Çabej (1908-1980), ky atdhetar i madh i shkencës shqiptare, ishte një nga personalitetet më të fuqishme të filologjisë shqiptare në shekullin XX, me një kontribut të jashtëzakonshëm në fushën e etimologjisë dhe historisë së gjuhës shqipe.

ME QUAJNË... TEFTA TASHKO KOÇO

Tefta Tashko Koço (1910-1937), kjo bijë e një familjeje atdhetare, ishte ndër të parat soprano shqiptare, që solli muzikën operistike në vendin tonë. Bashkë me një grup artistësh ajo hodhi themelet e muzikës profesioniste shqiptare dhe njëkohësisht u bë një nga interpretueset më të shquara të këngës sonë popullore. Koleksioni i disqeve me këngët e saj është një dëshmi e bukur dashurie e përkushtimi ndaj artit dhe popullit të saj.



ME QUAJNË... ONUFRI

Onufri është piktori më gjenial i ikonografisë shqiptare. Barazohet me emrat e artistëve të tillë botërorë si Rublovi, Theofan Greku, Panselinosi, Frang Katalani. Ai krijoi të ashtuquajturën Shkolla Onufriane. Si stil i takon pikturës kishtare lindore postbizantine, dhe shfaq origjinalitet në kompozimet, portretet dhe në futjen e motiveve etnografike të frymës psikologjike. Arti i afreskeve dhe ikonave të Onufrit është i përpunuar dhe i kulturuar.

Portreti "Davidi" afron me pikturat plot forcë titanike të Mikelanxhelos. Arti i tij është i hapur dhe i ndikuar nga arti i Rilindjes Europiane, por përherë mbetet ikonografik.



ME QUAJNË... ARKITEKT SINANI

Kam lindur më 29 maj, rreth viteve 1489 ose 1490. Kam kaluar fëmijërinë buzë lumit të Vjosës, në fshatin Gjergaj, i cili më pas për nderin tim u quajt Sinanaj.

Shkallët e karrierës ushtarake i ngjita me shpejtësi: nga oficer deri në komandant jeniçer, me titullin e nderit Aga. Nga ekspert në ndërtimin e infrastrukturës ushtarake, siç janë rrugët, urat dhe ujësjellësit, talenti dhe pasioni m'u shpërblyen duke më bërë arkitektin kryesor mbretëror, post të cilin do ta mbaja me nder për afro pesëdhjetë vjet.

Veprat e mia që njihen deri më tani kanë pasur karakter fetar, ushtarak dhe urban, në të gjithë Perandorinë Osmane, nga Budapesti deri në Mekë, nga Sofja deri në Damask.

Por disa prej tyre si xhamia Sulejmanie, Shehzade, si edhe Selimije në Edrine, bënë të më krahasonin me Mikelanxhelon dhe të më thërrisnin "Mikelanxheloja i Orientit".



ME QUAJNË... NIKOLA TESLA

Që i vogël shfaqi interes për elektricitetin. Shumë nga shpikjet e tij nuk u kuptuan dhe nuk u mirëpritën për kohën. Nikola Tesla nuk u mjaftua vetëm me shpikjet e sistemit të rrymës alternative, i cili ndryshoi mënyrën e jetesës në botë, por edhe me shpikje të tjera, si: drita fluoroshente, llamba me gaz neon, komunikimet valore, sistemet valore të transmetimit të energjisë, rrezet lazer, telekomandat, shpikjet e para në robotikë etj. Gjatë gjithë jetës, ai regjistroi rreth 300 patenta shpikjesh në të gjithë botën dhe hodhi idetë e para për përdorimin e energjisë diellore dhe asaj detare. Shpikjet e tij kanë edhe sot një ndikim të jashtëzakonshëm në njerëzim.

VIJNË SË SHPEJTI...

Më quajnë... Bekim Fehmiu

Më quajnë... Ali Pashë Tepelena



ME QUAJNË... TOMAS EDISON

"Kur isha sa ju adhuroja të shihja si funksiononte makineria me avull dhe të mësoja sa më shumë për elektricitetin, bateritë, magnetizmin dhe eksperimentet e thjeshta. Më magjepste kimia dhe reaksionet kimike, saqë një ditë shkatërrova gjysmën e ndërtesës nga një shpërthim. Çfarë telashesh!

Edhe pse kam realizuar mijëra shpikje, ajo që më bëri të njohur dhe ndryshoi jetën e njerëzimit ishte llamba elektrike. Po, po, llamba e thjeshtë elektrike që keni ju në shtëpitë tuaja..."



ME QUAJNË... ALBERT AINSHTAJN

"Shumë herë më pyesnin se nga i nxirrja teoritë, nga më lindnin idetë dhe si ia bëja që t'i thjeshtëzoja gjërat e ndërlikuara. Përgjigjja ime ishte gjithnjë e thjeshtë: gjërat duhen provuar nëntëdhjetë e nëntë herë, që të kesh sukses në herën e njëqindtë".



MË QUAJNË... GANDI

Lindi në Probandar, një qytet i vogël në Indinë Perëndimore. Ai ishte një njeri me pamje elegante dhe i veshur mjaft thjesht: mbështillej vetëm me një cohë të bardhë. Më vonë të gjithë do ta thërrisnin Mahatma (Shpirt i lartësuar), sepse Gandi ia përkushtoi gjithë jetën e tij idealit për të bindur dhe për t`u treguar njerëzve, se dhuna është forma më e keqe për të luftuar për barazi mes pushtuesve dhe të shtypurve, mes të pasurve dhe të varfërve. Duke bërë një jetë të thjeshtë dhe shembullore, si modeli më i mirë për të tjerët dhe duke shndërruar fjalën në armën e tij më të mirë, ai kontribuoi jo vetëm në përmirësimin e gjendjës së njerëzve më pak të privilegjuar apo të diskriminuar, por luajti një rol vendimtar në arritjen e pavarësisë së Indisë. Për fat të keq, në mënyrë paradoksale, një nga pacifistët më të mëdhenj të botës vdiq i vrarë nga një fanatik fetar.



MË QUAJNË... MARKO POLO

"Jam i sigurt se, nëse juve do t'ju jepej mundësia të ndërmerrni një udhëtim të tillë, patjetër që do të niseshit menjëherë. Por besoj se pak njerëz kanë pasur mundësinë për të parë dhe për të njohur të gjitha ato vende dhe, për këtë arsye, dëshiroj t'ju rrëfej për udhëtimin tim. Kështu mund të njihni më mirë njerëzit e vendeve të ndryshme, kulturat dhe besimet e ndryshme të botës dhe të admironi gjërat më të mrekullueshme që ekzistojnë tek ta".



MË QUAJNË... KRISTOFOR KOLOMBI

"Pas zbulimit tim nisi epoka e perandorive të mëdha oqeanike. Falë tregtisë me Botën e Re, disa vende europiane, si Spanja dhe Anglia, përjetuan një rritje të madhe ekonomike dhe u kthyen në fuqi botërore. Që atëherë, ajo që ndodh në një pjesë të botës, ndikon te të gjitha vendet e tjera të saj. Pa udhëtimet e mia, bota në të cilën jetoni, nuk do të ishte siç e shihni!"



MË QUAJNË... LEONARDO DA VINÇI

"Që nga filozofët e deri te poetët, që nga arkitektët e deri te piktorët, që nga mbretërit e papët dhe deri te njerëzit e thjeshtë, të gjithë ndiheshim të aftë për ta transformuar botën. Edhe unë, si bir i kësaj epoke të mrekullueshme, nuk i shpëtova këtij vrulli. Për këtë pikturova dhe gdhenda skulptura, vizatova e skicova fortesa dhe makina lufte, krijova pajisje për të fluturuar dhe aparate të tjera të vogla, që do ta bënin më të thjeshtë jetën e njeriut".



MË QUAJNË... ISAK NJUTON

Përshëndetje, më quajnë Njuton, Isak Njuton. Në moshën tuaj adhuroja të ndërtoja shpikjet e mia të çuditshme. Një ditë ngrita në fluturim disa balona, të cilave u ngjita disa drita që i frikësuan fqinjët. Sa gallatë! Më pëlqenin shumë edhe orët, kështu që arrita të ndërtoja një orë që funksiononte me forcën e ujit, dhe një orë diellore, që më bëri të famshëm në gjithë vendin.

Por nuk njihem në gjithë botën për këtë orë, por për një kokërr mollë. Po, po, për një kokërr të thjeshtë molle!



MË QUAJNË... MARI KYRI

"Me Pierin, bashkëshortin tim, kalonim orë të pafundme, duke pyetur se cili element kimik mund të ishte ai që lëshonte këto rrezatime kaq të habitshme. E quajtëm polonium. Më pas zbuluam radiumin. Dhe atë dukuri e quajtëm radioaktivitet. Gjithmonë besuam se radioaktiviteti ishte një cilësi e brendshme e atomit të paqëndrueshëm, e një atomi që ishte si një kuti surprizash... dhe energjish."



ME QUAJNË... ANA FRANK

"Në Shtëpinë e fshehtë shkrova një ditar, që u bë i famshëm në të gjithë botën... dhe që u kthye në simbolin e Holokaustit. Zëri im flet tashmë në emër të gjashtë milionë të pafajshmëve të vrarë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Shpresoj që fjalët e mia të shërbejnë, mbi të gjitha, për të menduar dhe reflektuar për çmendurinë dhe tmerret e luftës."



ME QUAJNË... MIKELANXHELO

Skulptor, piktor, arkitekt, poet... Pa dyshim jam gjeniu dhe artisti më i madh i Rilindjes. Me shumë mundësi më ambiciozi, punëtori dhe perfeksionisti që ka ekzistuar ndonjëherë...

Punë pa pushim! Nuk ka dëm më të madh se koha e humbur. Kjo ka qenë gjithnjë motoja ime në jetë.

Vështroni skulpturat dhe pikturat e mia! Trupat muskulozë, format e bukura, fytyrat dramatike, ngjyrat e gjalla... gjithçka është shënuar nga karakteri im i zjarrtë, që lufton për të qenë... më i miri artist i Firences, i Romës dhe i gjithë botës!

ME QUAJNË... BETHOVEN

"Gjatë jetës sime kompozova nëntë simfoni, gjashtëmbëdhjetë kuartete harqesh, mbi tridhjetë e dy sonata për piano, një operë dhe kompozime të tjera, që do t'i njohim së bashku. Shkrova aq shumë muzikë, saqë duket gati e pamundur të besosh se gjatë pjesës më të madhe të jetës sime unë nuk munda të dëgjoja. Mund ta imagjinoni dot një muzikant që s'dëgjon? Duket e pamundur, apo jo!"



MË QUAJNË... KLEOPATRA

«Jeta ime ishte shumë e vrullshme në të gjitha kuptimet. U bëra mbretëresha e Egjiptit në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare. Luftova pa u lodhur për vendin tim. Ju siguroj që nuk kam qenë ajo gruaja e padrejtë dhe manipuluese që më kanë përshkruar. Dhe për t'u mbrojtur nga shumë e shumë gënjeshtra, besoj se ka ardhur momenti që t'jua tregoj vetë historinë time.»



MË QUAJNË... XHON LENON

"Unë themelova 'The Beatles', grupin e rokut më të njohur të të gjitha kohërave. Me këtë grup revolucionuam muzikën, u lidhëm me gjithë të rinjtë e kohës, shitëm miliona disqe, mbushëm stadiume... Kurrë nuk kishte ndodhur që një grup muzikor të kishte aq shumë admirues dhe të nxiste aq shumë pasione. Fanset tona ulërinin, qanin dhe madje humbnin ndjenjat në koncertet tona".



MË QUAJNË... PIKASO

"Megjithëse jam i famshëm për pikturat e mia, duhet t'ju them se një pjesë të famës sime ia kushtoj faktit që kam njohur shumë njerëz interesantë dhe se kam jetuar shumë vjet në një epokë nga më të begatat sipas këndvështrimit kulturor. Kam pasur një jetë shumë intensive, në të cilën piktura, gratë dhe demat kanë qenë pasionet e mia kryesore dhe, me raste, shkatërrimi im".

Bëmat e Estes dhe Kokosë

Seria “Bëmat e Estes dhe Kokosë” është përplot me ngjarje gazmore dhe dinamike nga jeta e përditshme e tre fëmijëve (dy motra dhe një vëlla: Koko, Este dhe Ale). Ngjarjet zhvillohen në mjediset ku gjenden sot fëmijët (shtëpi, shkollë, veprimtari jashtë shkolle, kënde lojërash etj.). Me gjuhën dhe syrin e fëmijës, kjo seri është një përshkrim dhe vështrim kritik i realitetit, duke u përcjellë fëmijëve plot skena gazmore me humor batutash e situatash. Seria është, veç tjerash, një bashkëbisedim-rritës i fëmijës me veten.

Faqe: 80, me ngjyra
Çmimi: 500 lekë

Faqe: 80, me ngjyra
Çmimi: 500 lekë

Faqe: 78, me ngjyra
Çmimi: 600 lekë

Faqe: 82, me ngjyra
Çmimi: 600 lekë

Seria Shoku im Maksi

MAKSI NË NJË UDHËTIM TË HATASHËM ME KLASËN

Maksi dhe shokët e tij ndihen të gëzuar. Shumë shpejt ata do të bëjnë një udhëtim me klasën. Në bujtinën“Finkenshtajn“ i pret një ndeshje emocionuese futbolli, një garë dhe loja me fantazmën. Por aventura më e madhe e tyre është humbja dhe kërkimi i qenit të bujtinës, Bobit, i cili u zhduk pa lënë gjurmë. Këto aventura janë tipike të Maksit. Ai, Paulina dhe Niki e dinë se ç’duhet bërë në këto raste.

MAKSI DHE FUTBOLLISTËT FITIMTARË

Maksit i ka ardhur në majë të hundës që e treta A gjithmonë rrihet në futboll nga e katërta B. Por në festën sportive nuk duhet të ndodhë kjo. Në skuadrën e tyre as trajneri më i mirë nuk bën punë, pasi të gjithë grinden me njëri-tjetrin. Por Maksi që është tip, e gjen zgjidhjen: ai merr maskotën e duhur, me ndihmën e së cilës e treta A bashkohet dhe, ndoshta, mund edhe të fitojë lojën.

SHOKU IM MAKSI

Tituj: 3 (seri e hapur)
Faqe: 92-102, me ngjyra
Formati: 145 x 215 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 470 lekë; 4 euro; 250 den (për libër)

Siç rritet lexuesi, rriten edhe Maksi me Konin. Tashmë ata janë të gatshëm të shoqërojnë fëmijët mbi 8 vjeç me aventurat dhe ngjarjet e papritura që hasin çdo ditë. Ndiqini Maksin dhe Konin duke u rritur bashkë me ta.

MAKSI DHE FANTAZMA

Një ditë, e treta A udhëtoi për në parkun e lojërave. Maksi dhe shokët e tij nuk ngopeshin dot me trenat e shpejtësisë së lartë që kalojnë nëpër ujë, me rrotën gjigante që rrotullohet dhe me karuselët drithërues. Befas, Niki humbi pa gjurmë në trenin e fantazmave. Çfarë ndodhi? Këto janë situata tipike për Maksin. Ai dhe Paulina vihen në kërkim të tij dhe u tregojnë fantazmave se çfarë është më drithëruese se ato vetë

Seria Shoqja ime Koni

SHOQJA IME KONI

Tituj: 8 (seri e hapur)
Faqe: 92-102, me ngjyra
Formati: 145 x 215 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 470 lekë; 4 euro; 250 den (për libër)

KONI DHE CIRKU I PUSHIMEVE

Koni mezi pret të shkojë në plazh e të flejë në tendën e kampingut. Por papritur gjithçka shkon ters me pushimet e shkurtra dhe familja Klaviter befas e gjen veten duke bërë kamping në kopshtin e shtëpisë së tyre. Nga një ekskursion i vogël del një cirk fantastik pushimesh!

KONI DHE PONI KËRCIMTAR

Koni është e lumtur. Më në fund ajo do të shkojë në fermën e kuajve. Koni mezi po pret të shohë përsëri kalin e saj të preferuar, Karlinën. Së bashku me Anën, ajo do të ndjekë një kurs akrobacie mbi kalë. Një kalë i cirkut, Amadeusi, ka nevojë urgjente për ndihmën e tyre. A do të mundet Koni dhe miqtë e saj ta ndihmojnë?

KONI DHE DËBORA E MADHE

Koni dhe familja e saj kanë zgjedhur t'i kalojnë pushimet dimërore në një kasolle të vetmuar në mal. Sa keq, bora që Koni mezi pret të bjerë, nuk duket askund! Por, sapo mbërrijnë, si me magji, bie aq shumë dëborë, sa ata bllokohen e madje, mbesin pa ushqime e pa ngrohje. Çfarë bëjnë ata?!

KONI DHE BANDA E DJEMVE

Koni dhe shoqet e saj janë të entuziazmuara. Ato do të shkojnë në fermë tek Anika dhe do të ngrenë atje çadrën e kampingut. Së bashku do të kalojnë një fundjavë fantastike, por... në planet e tyre nuk kishin llogaritur bandën e djemve të fermave fqinje.

KONI UDHËTON NËPËR DETIN MESDHE

Koni udhëton me prindërit dhe Jakobin për në Greqi. Më në fund, pushime! Në ishullin e Kretës, çdo gjë është krejt ndryshe nga shtëpia. Deti është i madh dhe blu. Në rrugicat e qytetit mund të humbasësh lehtë. Sa mirë që ka grekë që flasin gjermanisht! Në të kundërt, Koni nuk do të ishte gjetur kurrë. Gjithashtu, nuk do të kishte parë kurrë një pallat të vërtetë.

KONI DHE KËSHTJELLA E VAMPIRËVE

Daja i Anës ka ftuar mbesën e tij dhe dy shoqet e saj në hotelin e tij kështjellë. Kjo është fantastike! Por shumë shpejt vajzat zbulojnë se atje gjërat nuk shkojnë si duhet. *A sillet rreth e rrotull kështjellës si vampir kont Vladimiri? Pse Dragomiri mban gjithmonë në qafë një shall të madh? Po kontesha e vjetër dhe e çuditshme, pse ha me aq shumë kënaqësi sallam të papërpunuar?*

KONI DHE ÇASTI I SHUMËPRITUR I AKULLORES

Koni, Ana dhe Billi kalojnë disa ditë pushime në Itali. Shoqet vizitojnë gjyshen e Billit në një fshat të vogël, në afërsi të Napolit. Koni njihet me Romën, lahet në detin Mesdhe dhe ngjitet në Vezuv. Por, mbi të gjitha, në Romë Koni dhe shoqet e saj shijojnë akulloren më të mirë në botë!

KONI DHE DASMA

E hatashme! Prindërit e Billit do të martohen dhe Koni është e ftuar! Dasma e parë në jetën e saj, ku ajo do të jetë e pranishme. Mbi të gjitha, ajo do të jetë shoqëruesja e nuses dhe do të hedhë petalet. A nuk është pak e rritur për këtë punë? Billit i duket çmenduri që prindërit e saj vendosin të martohen dhe, mbi të gjitha, nuk do të veshë fustan në ceremoninë e tyre. Por, s`ka dasmë pa pengesa. Edhe kjo dasmë has disa të tilla...

Seria Koni & Shoqëria

KONI & SHOQËRIA

Tituj: 6 (seri e hapur)
Faqe: 164-182, me ngjyra
Formati: 145 x 215 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 650 lekë; 5 euro; 300 den (për libër)

KONI, FILIPI DHE PUTHJA NË DËBORË

Filipi i ka dhuruar Konit një kalendar për Krishtlindje. Kur nga dritareza e vogël që ndodhej mbi të u shfaq një zemër, ajo ndjeu se kjo Krishtlindje do të ishte shumë romantike dhe e bukur. Por pastaj mori vesh që planet e Filipit ishin ndryshe nga sa e kishte imagjinuar dhe aspak romantike. A do të mundet Koni ta shpëtojë festën e saj të Krishtlindjes dhe ta kalojë atë me Filipin?

KONI, ANA DHE FESTA E ÇMENDUR E SHKOLLËS

Në shkollën e Konit, nxënësit i kanë zënë ethet e festës që do të zhvillohet shumë shpejt dhe të gjithë duan t'ia kalojnë sa më bukur. Koni, Ana, Billi dhe Dina duhet të kujdesen për pijet dhe muzikën, por Ana nuk e ka shumë mendjen te kjo detyrë. Duket se për të, kompjuteri i ri dhe bisedat në internet me të tjerët janë më argëtuese sesa shoqet e saj. Dhe, cili na qenka ky Njeriu i Hënës, kaq i mistershëm, i cili na e mban Anën peng?!



KONI DHE SHOQËRIA

Më në fund Koni hyn në gjimnaz. Por, në fillim, me klasën e re nuk është aq e thjeshtë sa kishte menduar. Shkolla i duket kot! Mësuesja e re kujdestare i ka sytë si të një zvarraniku. Të tjerët tashmë njihen mes tyre që nga shkolla fillore.

Por gjëja më e keqe në klasën e saj të re është një grup vajzash, që udhëhiqen nga Xhaneta. Klasa e saj do të bëjë një ekskursion. Koni nuk dëshiron të udhëtojë me mësuesen e saj që i ngjan një zvarraniku dhe me bandën e Xhanetës. Përpjekjet e saj për të mos shkuar në këtë udhëtim dështojnë. A "do t'i mbijetojë" ajo këtij udhëtimi me klasën? Por... ky udhëtim sjell aventura dhe të papritura për Konin dhe klasën e saj.

KONI, PAULI DHE PROBLEMET ME SHOQËRINË

Shkollat 9-vjeçare po stërviten për Lojërat Rinore Mbarëkombëtare. Koni është pjesëtare e skuadrës së atletikës të shkollës së saj. Kjo i dhuron kënaqësi, por i merr edhe shumë kohë. Ajo nuk dëshiron as të heqë dorë nga stërvitja, por as të lërë pas dore shoqet e saj dhe Filipin. Teksa ajo përpiqet t'i përballojë të gjitha këto, Paulit i duhet të luftojë me problemet e tij.

Koni dhe shoqet e shokët e saj e kuptojnë që ai ka nevojë për mbështetjen e tyre, edhe pse ai i refuzon. A do të munden ata ta ndihmojnë Paulin?

KONI, FILIPI DHE SUPERVAJZA

Koni përhumbet në sytë e kafenjtë të Filipit. Fluturat në stomak nuk po i ikin. Përkundrazi, ajo bëhet gjithnjë e më keq, kur një vajzë e re shfaqet në shkollën e tyre. Klarisa jo vetëm që është shumë e bukur, por është edhe superinteligjente, sportiste e zonja dhe mjaft e gatshme për të ndihmuar të tjerët. Ajo është kaq e përsosur në të gjitha drejtimet, sa duket sikur vjen nga një botë tjetër. Brenda Konit ndizet sinjali i alarmit. Mos kjo bukuroshja e re po shoqërohet me Filipin? Por Ana, si gjithnjë, ka një plan. Koni do ta mundë Klarisën me "armët" e saj më të forta!

KONI, BILLI DHE BANDA E VAJZAVE

Koni duhet t'i dalë në krahë Billit. Tanja, një nxënëse e klasës paralele, keqtrajton shokët e saj të klasës. Papritur ajo e ka kapur me Billin. Ç'mund të bëjë Koni për shoqen e saj? Si mund ta ndihmojë Billin, për të shpëtuar nga banda e Tanjës? Për fat, me të është edhe Ana me Dinën. Shoqet e vërteta mund t'i besojnë njëra-tjetrës. Me ta është edhe Filipi, gjithnjë i gatshëm për t'i ndihmuar.

KONI DHE "GJETHJA E TËRFILIT" NË FERMËN E KUAJVE

Koni, Ana, Billi dhe Dina po kalojnë një javë të mrekullueshme në një fermë kuajsh në brigjet e Detit e Veriut, në Gjermani. Ferma është e bukur dhe pronarja e saj është mjaft e dashur dhe e sjellshme. Edhe moti është po aq i mrekullueshëm, sa edhe kuajt e fermës. Gjithçka është edhe më e bukur sa e kishte imagjinuar "Gjethja e tërfilit"! Të katërta shoqet marrin mësime hipizimi dhe kalojnë shumë kohë duke kalëruar përgjatë bregdetit. Por.., papritmas, ato bëhen pjesë e një trilleri të vërtetë me kuaj... Çfarë ndodhi vallë?

Seria

Letërsia italiane për fëmijë

HISTORIA E JASHTËZAKONSHME E LAVINJËS
Autor: Bianca Pitzorno
Faqe: 80, me ngjyra
Çmimi: 470 lekë; 3.5 euro, 230 den

Në pragun e Krishtlindjes, ndërsa të gjithë po festojnë, Lavinja, një shitëse e vogël shkrepësesh, po vdes nga uria dhe nga të ftohtit. Bëjini gati shamitë për të fshirë lotët! Në të vërtetë, jo! Bëhuni gati të qeshni, siç nuk ju ka ndodhur ndonjëherë teksa lexoni një libër, sepse historia nuk mbaron aspak siç mendoni ju. Vogëlushja e gjorë është tip i lezetshëm dhe shumë e shkathët. Ajo, falë dhuratës së një zane, "do t'i marrë hakun" botës së të rriturve egoistë. Unaza magjike dhuratë do të shkaktojë një seri aventurash kaq qesharake, sa do t'ju bëjë të qeshni me lot.

Bëjini gati shamitë!



SHTRIGUSHJA IME
Autor: Bianca Pitzorno
Faqe: 100, me ngjyra
Çmimi: 500 lekë; 3.7 euro, 230 den

Azdrubal Tirinanci nuk i lan kurrë dhëmbët, është i paedukatë dhe egoist. Ai mbetet i shokuar kur lexon në testamentin e të ungjit të ndjerë se, për të trashëguar pasurinë marramendëse të tij, duhet të martohet me një shtrigë. Ai nuk beson në ekzistencën e shtrigave, por u futet kërkimeve se si mund ta gjejë një të tillë.

Për Emilinë, foshnjën flokëkuqe që pluskon në govatë, që flet me maçokun e zi dhe që nuk pasqyrohet në pasqyrë, familja Zep mendon se janë vetëm ca rastësi qesharake.

A do të shpëtojë Emilia e vogël nga kthetrat e gjahtarit të pështirë të trashëgimisë?



MATIA DHE GJYSHI
Autor: Roberto Piumini
Faqe: 84, me ngjyra
Çmimi: 470 lekë; 3.5 euro, 230 den

Qielli, si gjithmonë në këtë histori, ishte i qetë e plot dritë. Kështu mbyllet kapitulli i dhjetë i **"Matia dhe gjyshi"**, ndonëse tregohet diçka e dhimbshme dhe vendimtare: vdekja. Pakti i shpresës, që autori e kishte nisur që te libri "Stralisku", vijon edhe në këtë libër. Një i madh dhe një i vogël, ndërsa këmbejnë përmasat, ecin së bashku, flasin, shohin botën, luajnë deri në fund. Luajnë lojën më të madhe me rregullat e dashurisë.

Ky libër rrëfen dashurinë e një nipi për gjyshin e vet, që edhe pas vdekjes mbetet shoku i tij i pandarë.

GJYSHI IM ISHTE NJË PEMË QERSHIE
Autor: Angela Nanetti
Faqe: 128, me ngjyra
Çmimi: 700 lekë; 6 euro, 350 den

Në këtë libër rrëfehen thjesht dhe me shumë ndjenjë një seri përjetimesh të një djali të vogël, Toninos, i cili kishte kaluar te gjyshi në fshat verën më të bukur të jetës së tij. Kur lindi nëna e Toninos, gjyshi mbolli një pemë qershie. Që nga ai çast, ajo pemë u bë pjesëtare e familjes. Ajo ishte pema ku luante dikur mamaja e tij e më pas edhe vetë ai.

Në mendjen e tij prej fëmije, kur dikush vdiste, shndërrohej në diçka që e kishte dashur shumë në jetë. Prandaj edhe ai mendonte se gjysh Oktaviani ishte një pemë qershie.

Kur komuna donte ta priste pemën e qershisë, sepse pengonte ndërtimin e rrugës, Toninoja bëri çmos që ajo të mos prekej dhe të mbetej përgjithmonë aty, në oborrin e gjyshit...

NJË JASHTËTOKËSOR NË FAMILJE
Autor: Bianca Pitzorno
Faqe: 256, me ngjyra
Çmimi: 880 lekë; 6.5 euro; 390 den

Në familjen Olivieri ka ardhur një mik i jashtëzakonshëm: Moja, një fëmijë nga planeti Deneb. Është vajzë apo djalë? Ndërmjet tokësorëve dhe denebianëve ka një ndryshim të vogël: gjinia e fëmijëve nuk zbulohet pa mbushur të njëzetat. Por ky ndryshim i vogël shkakton vështirësi të mëdha. Me sa duket, në tokë, të qenit djalë apo vajzë përcakton çdo aspekt të jetës, që në fëmijëri.

Në këtë roman, që të bën për të qeshur e për të menduar, autorja tregon kontradiktat dhe paragjykimet që shoqërojnë edukimin e vajzave dhe të djemve, dhe se sa e vështirë është të zgjedhësh se çfarë do të bëhesh, ndërkohë që të gjithë të thonë se kush je.

STRALISKU
Autor: Roberto Piumini
Faqe: 112, me ngjyra
Çmimi: 550 lekë; 4 euro, 230 den

Sakumati, piktor turk, u thirr për të pikturuar muret e bardha mes të cilave jetonte një fëmijë, i mbyllur për shkak të një sëmundjeje të çuditshme. Raporti ndërmjet piktorit, fëmijës dhe të atit nuk do të jetë një kontratë e thjeshtë pune, por një pakt marrëdhëniesh njerëzore. Figurat që do të lindin dhe do të jetojnë në mure, do të reshtin së qeni thjesht një zbukurim, kur të krijohet lulja-xixëllonjë, që do të jetë edhe thelbi i të gjithë krijimit: Stralisku. Historia e këtij libri është historia një miqësie të pastër dhe delikate, që mund ta quajmë edhe një përrallë për fuqinë e dashurisë. Roberto Piumini, me këtë roman të shkurtër dhe magjik, na zbulon se dashuria nuk është vetëm një lidhje gjaku, por edhe një lidhje befasuese dhe e vërtetë mes njerëzve, që dinë të falin paqe, mbështetje dhe emocione te të tjerët.

Seria

Trashëgimi kulturore

LEGJENDA SHQIPTARE

Tituj: 2 (seri e hapur)
Faqe: 80, me ngjyra
Formati: 240 x 280 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 500 lekë; 12 euro; 730 den

Kjo seri, veç librit **"Legjenda dhe vende shqiptare"**, plotësohet me një botim tjetër me legjenda për heronjtë e heroinat dhe virtytet e tyre të mrekullueshme. Por, ndërsa në librin e parë ndërthurej historia e lashtë e disa vendeve shqiptare, me pamjen që kanë sot këto vende, në këtë botim legjendat, si ato të ringjalljes, të mbajtjes së fjalës së dhënë, të flijimit rrëfejnë ngjarje historike, zakone, norma që lidhen me kulturën autoktone shqiptare. Kjo kulturë përcillet përmes tyre, dhe, ashtu siç ngrihet gur pas guri një kështjellë, po ashtu fjalë pas fjale plotësohet mozaiku i historisë së lashtë të popullit tonë. Të shoqëruara me ilustrime origjinale, ato e nxjerrin më në pah thelbin e tyre fantastik.



LEKË DUKAGJINI

Faqe: 40, me ngjyra
Formati: 195 x 235 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 000 lekë; 7 euro; 420 den

"Lekë Dukagjini (Kështjella e Ligjeve)" është një tregim i ilustruar për fëmijë. Në këtë tregim, fëmijët do të lexojnë se si princa të ndryshëm, të huaj e vendës, vijnë të kërkojnë dorës e motrës së Lekë Dukagjinit për nuse. Tre prej tyre nisen të luftojnë me Lekën dhe përfundojnë si mëtues në Kështjellën e Ligjeve, ku Maria, motra e Lekës, i sheh një e nga një mëtuesit e saj. Në fund, ajo zgjedh njërin prej tyre, nga një familje shumë e njohur arbërore. Rrëfimi origjinal në këtë libër është shumë tërheqës dhe ndërthur historinë me legjendat dhe trillimin artistik.

UDHËTIM NË BOTËN E PIKTURËS SHQIPTARE

Faqe: 76, me ngjyra
Formati: 235 x 305 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 300 lekë; 9.5 euro; 580 den

Shkrimtari Luan Rama, që është edhe personazhi i gjyshit në këtë libër, e shoqëron mbesën e tij, Lolën, por edhe të gjithë lexuesit e vegjël në atelietë e piktorëve, si dhe në galeritë dhe muzetë e artistëve më të njohur shqiptarë në kohë. Ky udhëtim fillon me tablotë e realizuara në shekujt XVI-XVIII, nga mjeshtri i madh Onufri, nga pasuesi i tij i denjë, Konstandin Shpataraku; vazhdon më pas me tablotë e shekullit XX të piktorëve, si Spiro Xega, autori i tablosë së njohur "Skënderbeu", piktori dhe fotografi i shquar Kolë Idromeno, krijuesi i peizazheve të mrekullueshme, Vangjush Mio. Dhe shfaqen më pas portretet që të mbeten në mendje të motrave Androniqi dhe Sofia Zengo, tablotë me frymën e thellë popullore të Abdurrahim Buzës, portretet dhe peizazhet e mjeshtrit Sadik Kaceli, për ta mbyllur me piktorin me famë botërore, Ibrahim Kodrën, ku mbresëlënëse është dhe piktura e tij e fundit, e mbetur përgjysmë.

Seria Autorë shqiptarë

Faqe: 304
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 800 lekë; 7 euro; 400 den

PRESIDENT I PLANETIT TË KUQ

Heronjtë e këtij romani, një grup i guximshëm fëmijësh tokësorë dhe marsianë, marrin përsipër shpëtimin e Sistemit tonë Diellor nga sulmi i mafies kozmike. Ata arrijnë ta mposhtin të Keqen përmes luftës së përbashkët. Në këtë luftë udhëhiqen nga Presidenti i Planetit të Kuq, i cili i dëgjon me shumë vëmendje fëmijët dhe, nga mësimet që nxjerr prej përrallave të tyre, rregullon të gjitha ligjet e planetit.

Ndonjëherë, për të shpëtuar botën, nuk mjaftojnë dijet dhe teknologjia, por duhet bota fëminore, fantazia dhe aftësia e tyre për të besuar tek e pamundura, duke shndërruar kështu çdo përrallë të bukur në realitet.

Faqe: 70
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 550 lekë; 4 euro; 240 den

HEROIZMAT E FATBARDH PIKALOSHIT

Aventurat me fyej magjikë e katallanë të Fatbardh Pikaloshit vijojnë të magjepsin fëmijët anembanë.

"Babai" i Fatbardh Pikaloshit, shkrimtari i njohur për fëmijë, Bedri Dedja, ju fton në portat e botës së tij magjepsëse të përrallave. Në këtë libër do të njihni heroizmat e famshme të Pikaloshit dhe miqësinë e tij jo të zakonshme me Qenin Qimekuq-Zemërbardhë.

Faqe: 168
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 800 lekë; 7 euro; 400 den

NJË UDHËTIM I RREZIKSHËM

Kokëdruthi, Kokëtapa dhe Kokëfirifiu largohen fshehurazi nga vendlindja e tyre, Qyteti Sdikuisht, për të shkuar drejt Qytetit të Qejfit, të hallakatur nga premtimet e Usta Ipaudhit, këtij mashtruesi të shkuar në moshë. Aventurat e tyre do t'i rrëmbejnë lexuesit e vegjël për t'i çuar në Festivalin e Gjëraxhepit, në qytetin famëkeq të Helmegazisë, e deri në Monopatin e torturave gramatikore e matematikore... Por çfarë ndodh më pas me ta?
Ky roman është një nga veprat më zbavitëse të shkrimtarit Bedri Dedja, vlerësuar me çmimin e IBBI-t (Bordit Ndërkombëtar të Librave për Fëmijë), si romani më i mirë i vitit 2000, për fabulën e tij dinamike e plot fantazi, si dhe për dhuntinë e madhe krijuese të autorit.



Faqe: 162
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 800 lekë; 7 euro; 400 den

KACIMICRRI RRETH GLOBIT
Personazhi aq i njohur i përrallave shqiptare, Kacimicrri, niset në një udhëtim të gjatë rreth globit, për të takuar shumë personazhe të tjera të letërsisë botërore për fëmijë.
Ku do ta çojë aeroplani sa një gogozhare udhëtarin e tij të vetëm, të vogël sa një gisht? Cilët janë këto personazhe që do të takojë gjatë këtij udhëtimi plot aventura? Le t'i ndjekim së bashku këto aventura të jashtëzakonshme, të cilat shkrimtari na i rrëfen ëmbël e me humor.

Faqe: 118
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 800 lekë; 7 euro; 400 den

SI 4 ÇILIMINJ U BËNË BIZNESMENË
Shkrimtari aq i dashur për fëmijët, Bedri Dedja, do të na çojë përsëri në Sdikuisht, në kryeqytetin e përrallave të tij, kësaj here për të na njohur me të fshehtat e biznesit, me sekretet e qyteteve Gëzimburg dhe Skarcomania, me magjistaren "Inteligjenca Artificiale", me autostradat dhe semaforët kozmikë, me lojërat e futbollit në stadiumet nëntokësorë, por edhe me epidemi e mikrobit të rrezikshëm me emrin "Tezgomania"... Si do të vazhdojë më tej kjo aventurë e guximshme e heronjve tanë të rinj, që zbresin nga bota magjepsëse e përrallave? Tak-tak-tak! Porta u hap përsëri...



Faqe: 172
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 700 lekë; 6 euro; 350 den

I FUNDMI I KASTRIOTËVE
(bazuar në romanin me të njëjtin titull të Andon Frashërit)
Romani hedh dritë mbi një ngjarje tragjike të historisë së Shqipërisë, e cila njihet shumë pak nga lexuesi shqiptar. Në vitin 1481, pasi u rrit e u bë burrë, Gjon Kastrioti vendosi të kthehej në Krujë për të organizuar një kryengritje, me dëshirën për të vazhduar bëmat e atit të tij, Skënderbeut të lavdishëm. Si do të vijojnë përpjekjet e tij për ta çliruar Shqipërinë nga zgjedha turke, në rrethanat e reja që janë krijuar në vend, pesëmbëdhjetë vite pas vdekjes së të atit?
Shkrimtari Bedri Dedja, duke u mbështetur në fabulën dhe subjektin e veprës me të njëjtin titull, shkruar nga Andon Frashëri, ndërtoi mbi skeletin e saj një vepër të re, së cilës i dha formën e romanit për fëmijë.

Faqe: 204
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 800 lekë; 7 euro; 400 den

ALARMET E QYTETIT SDIKUISHT
Është koha të rikthemi edhe një herë në portat e qytetit fantastik të Sdikuishtit, për t'u takuar përsëri me Kokëdruthin, Kokëtapën, Kokëfirifiun, Kokakomçin, Usta Ipaudhin e të tjera personazhe, që i përkasin një epoke ku teknologjia ka ecur me hapa viganë.
Por çfarë ndodhi me këto personazhe fantastike? Vazhduan të thellohen në rrugën e krimit apo u kthyen në bankat e shkollës për të mësuar? Për të gjetur përgjigjet e këtyre pyetjeve, duhet të ndesheni më parë me ushtrinë e robotëve, të udhëtoni me vagonët e nëndheshëm e të zhyteni në thellësitë e oqeaneve me nëndetëse superteknologjike e të njiheni me shumë e shumë aventura që fshihen pas këtyre faqeve.

Faqe: 140
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 750 lekë; 7 euro; 400 den

KALAMAJTË E PALLATIT IM - 1
Një copëz letër, mbetur "e burgosur" në zarf, mban një sekret që shpaloset në faqet e fundit të këtij romani. Xhamat e thyer në shtëpinë e banorit më të ri të pallatit, zbulojnë një nga një fqinjët e kateve të tjera, e ndjekin deri në oborr fëmijët e moshave të ndryshme që argëtohen në lojëra e vrapime, që dinë të krijojnë skuadrat e tyre, apo të organizojnë kohën e lirë.

Janë rrëfime që shënjojnë jetën e lexuesve të vegjël, pasi jo vetëm rrjedhin natyrshëm, por të krijojnë përshtypjen sikur shkrimtari është edhe një shok e pjesëmarrës në lojërat, shqetësimet, dhe gëzimet e tyre.

Faqe: 164
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 750 lekë; 7 euro; 400 den

KALAMAJTË E PALLATIT IM - 2
Ngjarjet ndodhin në një pallat në Tiranë, në shkollë, në rrugët e kryeqytetit, e më tej, edhe në fshat. Gjithçka është dhënë me vërtetësi të madhe artistike nga autori.

Ky libër mund të lexohet me kënaqësi edhe nga të rriturit, pasi në rrëfimet e tij ata do të gjejnë gjurmët e fëmijërisë së tyre.

Faqe: 64, me ngjyra
Formati: 21x25 cm.
Çmimi: 700 lekë; 6 euro; 350 den

"Ruruja e vogël me zemër të madhe" përmban tregime, tregime humoristike dhe përralla shkencore. Në përrallat e kësaj përmbledhjeje dalin mesazhe mjaft reale dhe të rëndësishme nga jeta e përditshme. Në këtë përmbledhje me tregime dhe përralla autorja shquhet për mënyrën e rrëfimit dhe të komunikimit të ngrohtë dhe të çiltër me fëmijë, dhe një fantazi dhe imagjinatë kaq e bukur e botës fëmijërore. Këtu gjejmë shpirtëzimin e gjallesave dhe sendeve, me qëllim zhvillimin e imagjinatës së fëmijëve dhe gërshetimit të saj me realitetin ekzistues, me këtë realitet, kur interneti dhe telefonat zënë kohën më të madhe të fëmijëve, dhe jo lojërat dhe aktivitetet në natyrë.

Këto tregime dhe përralla, për shkak të vlerave, gjuhës dhe mesazheve kaq aktuale dhe të rëndësishme që përcjellin, duhet të jenë në duar te çdo fëmije dhe jo vetëm, por edhe të prindërve të tyre!

Faqe: 58, me ngjyra
Formati: 21x25 cm.
Çmimi: 800 lekë; 7 euro; 400 den

Dikur na ishte një vogëlushe Enni... tani na është një Kapelëkuqe Diellzë. Dikur shkonte në kopsht... tani është nxënëse në klasën e parë. Dikur vinte në kokë një fjongo të kaltër, si syçkat e saj,... tani vesh kostum të kuq, mbath këpucë të kuqe... Hedh në shpinë çantën e kuqe të librave dhe vë në krye kapelën e kuqe që ia ka qëndisur g jyshja...Dhe ndërroi emrin! Po, po, vërtet ndërroi emrin dhe hyri në përrallë. Por mbeti ashtu siç kishte qenë: e mirë, e mençur, e sjellshme, e dashur, ledhatare, e dalluar në shkollë dhe punëtore në shtëpi.

Faqe: 94, me ngjyra
Formati: 14.5x20.5 cm.
Çmimi: 600 lekë; 4.5 euro; 250 den

Mjaftoi lajmi që një planet në kozmos mori zyrtarisht emrin Arbër, që fantazia e një grupi të vogël fëmijësh të merrte udhë për të zbuluar të fshehtat qiellore, Sistemin Diellor dhe jetën e galaktikave të tjera.

Shumë shpejt këta "astronautë" të vegjël do të përjetojnë një ëndërr të madhe: të jenë të parët që do të zbulojnë planetin që sillet rrotull yllit Illyrian. Ashtu si për astronautët e Apollo-s që shkelën për herë të parë në Hënë, edhe udhëtimi i tyre në hapësirat qiellore është plot të papritura...

Seria Autorë shqiptarë

GJYSHI NË KORNIZË

Autor: Ermir Nika
Faqe: 52, me ngjyra
Formati: 120 x 180 mm
Kopertina: e plastifikuar, me lustër
Çmimi: 420 lekë; 3 euro; 180 den

Në këtë libër, **"Gjyshi në kornizë"**, autori sjell me emocion një ngjarje kulmore, nga jeta e një gjyshi dhe nipit të tij. Fëmija ndodhet para vështirësish natyrore, të cilat shumëfishohen nga humbja aksidentale e gjyshit. Përballimi i situatës, me ndihmën e njerëzve të rastësishëm, dhe forca e vitaliteti i gjyshit, i mbeten fëmijës të pashlyeshme në kujtesë. Përshkrimet e situatave, dhënë me shumë art, lexuesit do t'i mbeten gjatë në kujtesë, së bashku me foton e gjyshit në kornizë.

Kjo seri librash ka si qëllim që t'ua sjellë më pranë fëmijëve krijimet e rilindësve shqiptarë. Dhe jo vetëm që të njihen më tepër me këto krijime, por edhe për t'ua bërë atyre më të dashura. Kjo seri është mjaft e dobishme për fëmijët, nxënësit dhe mësuesit.

Në librin **"Stinët e motmotit",** nëpërmjet një parathënieje të shkurtër fëmijët rikujtojnë se **Luigj Gurakuqi** ka qenë një luftëtar i shquar për lirinë dhe përparimin e kombit tonë, por edhe poet e përkthyes. Ky libër përmbledh disa nga vjershat dhe prozat që ai i ka shkruar me shumë përkushtim për nxënësit e vegjël. Në to i këndohet me dashuri natyrës, stinëve të vitit, përshkruhen me detaje pemët, zogjtë, lulet, bora, shtrëngatat, por edhe fati i të varfërve. Në disa vjersha ai nuk harron të japë këshilla për nxënësit, që të jenë të gatshëm të shkojnë në shkollë, të dëgjojnë me nderim prindërit e mësuesit, të mos i heqin librat nga duart edhe gjatë pushimeve.

Libri **"Zemra fluturake"**, i dyti i kësaj serie është një përmbledhje e vjershave të **Naim Frashërit,** të përzgjedhura me kujdes nga shkrimtari Pandeli Koçi. Nëpërmjet parathënies ata rikujtojnë se Naimi është rilindësi i cili i ka kënduar me shumë dashuri Atdheut. Nga prindërit dhe gjyshërit fëmijët kanë dëgjuar që të vegjël për vargjet e Naimit. Më pas, në shkollë, ata kanë mësuar më tepër, madje i kanë mësuar përmendësh disa nga vjershat e tij. Mesazhet që përcjellin poezitë e përzgjedhura në këtë libër, nxisin dashurinë për dijen, për shkollën, për të të rriturit.

Në librin **"Fillo me gëzue",** fëmijët rikujtojnë se **Ndre Mjeda**, është një nga poetët më të rëndësishëm të Rilindjes sonë Kombëtare. Ai ka shkruar mjaft vepra, por asnjëherë nuk harroi të shkruajë e të botojë edhe për të vegjlit. Poezia e Mjedës ka një karakter edukativ, me vargje që rrezatojnë mirësi e dashuri.



Faqe: 72, me ngjyra
Formati: 21x25 cm.
Çmimi: 700 lekë; 6 euro; 350 den

Zgavradori nuk është një pyll i zakonshëm, pasi aty jetojnë kafshë që ta rrëmbejnë zemrën dhe të bëjnë t'i duash, pasi ato udhëhiqen nga një forcë e madhe: dashuria.

Dhe Tuli-Turtuli është një prej banorëve të këtij pylli. Tuli është një breshkë e vetmuar, me një këmbë prej druri, pasi këmbën e vërtetë e pati humbur në një betejë.

Një ditë, ndërsa ai po pastronte shtëpinë, prapa rafteve në murin prej guaske zbulon një të çarë të vogël dhe brenda saj... një shishe qelqi të pluhurosur. Ajo "fsheh" një hartë, e cila tregon rrugën se si duhet shkuar në mbretërinë e mbretit Tiercel...

Në këtë libër kaq të dashur për fëmijë janë fshehur të gjitha sekretet dhe harta se si duhet shkuar aty!



Faqe: 50, me ngjyra
Formati: 21x25 cm.
Çmimi: 800 lekë; 7 euro; 400 den

Nuk e di për ju që po e lexoni këtë përrallë, por unë për veten time gjithmonë kam dashur që të kem një shkop magjik. Madje edhe sot ka çaste kur do të dëshiroja vër tet që, me anën e një shkopi magjik, të bëja shumë gjëra.

A dini të mbani një sekret? Po? Mirë. Meqë më thatë që dini të mbani një sekret, unë po jua rrëfej sekretin tim. Tezja ime, teze Lola, ka shkop magjik. Madje jo një, por dhjetë. Po, po dhjetë ka. Unë i kam parë vetë me sytë e mi. Ja, tani po jua rrëfej menjëherë të gjitha, vetëm mbani vesh.

Faqe: 62, me ngjyra
Formati: 14.8x21 cm.
Çmimi: 550 lekë; 4 euro; 250 den

HISTORIA E KRISHTLINDJES SË FRANCIT

Franci është një djalë tetë vjeç. Ai jeton me mamin, babin dhe vëllanë e tij të madh, Jozefin. Shoqja e tij, Gabi, banon ngjitur me shtëpinë e tij. Ajo ka të njëjtën moshë me Francin. Luajnë bashkë dhe kalojnë shumë bukur, por Gabi do t'i kalojë Krishtlindjet te halla e saj në fshat. Për këtë arsye, ajo dhe Franci, dy shokët e ngushtë, i shkëmbejnë dhuratat një ditë përpara festës. Ndërkohë, Franci duhet të bëjë sikur është shumë i gëzuar nga dhurata e Gabit. Por, në fakt, Gabi dhuratën më të bukur e ka për Peterin, shokun e saj në fshat. Mirëpo kjo gjë duhet të ndryshojë...



Faqe: 88, bardhezi
Formati: 14.8x20.5 cm.
Çmimi: 600 lekë; 5 euro; 300 den

Akikoja është një vajzë që nuk i pëlqen kufijtë dhe e do shumë babanë. Ajo e sheh botën pak më ndryshe, prandaj të tjerëve u duket e çuditshme.

Akikoja shpesh është e vetmuar, por kjo nuk do të thotë që nuk ka miq. Miqtë e saj më të mirë janë një pemë, Baobabi, dhe shoku i saj, Marseli, takimi me të cilët do ia bëjë jetën më të bukur.

Autori i këtij libri, Stefan Tićmi, ka lindur në vitin 1992 në Leskovac. Ai është diplomuar në Fakultetin e Sporteve dhe Edukimit Fizik në Nish. Shkruan poezi dhe prozë, si dhe tekste për teatër dhe televizion. Tićmi është fitues i disa çmimeve letrare dhe konsiderohet nga kritika një zë i veçantë në letërsinë për fëmijë.

Seria "Libri i madh"

LIBRI I MADH
Tituj: 2 (seri e hapur)
Faqe: 112, me ngjyra
Formati: 270 x 325 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 300 lekë; 9.5 euro; 580 den (për libër)

LIBRI I MADH I LEGJENDAVE MESJETARE

Ky libër përmbledh 11 legjenda mesjetare, në të cilat tregohet për vende magjike ku banojnë dragonj që lëshojnë zjarr, kalorës trima, princesha të burgosura nëpër kulla të larta, ura që ngrihen e ulen dhe për shumë ndodhi e personazhe të tjera. Fantazia dhe imagjinata udhëtojnë në mjegullën e kohës, duke u frymëzuar nga bëmat dhe trimëritë e kalorësve të mbretit Artur si: Lançeloti, Ivani, Persëvali, Gavaini apo të shigjetarit më të zot, mbrojtësit të të varfërve, heroit, Robin Hud. Në këtë libër zënë vend edhe historitë e dashurisë më të bukura dhe më tragjike të të gjitha kohërave, që të bëjnë të prekesh e të lotosh, si historia e dashurisë mes Tristanit e Izoldës dhe ajo e Romeos dhe e Zhuljetës.

LIBRI I MADH I AVENTURAVE

Përmbledh 11 tregime të përshtatura për fëmijë të autorëve më të mëdhenj klasikë të librave me aventura. Në këto tregime fëmijët njihen me personazhet më eksplorues e më guximtarë të kohërave, që arritën të mbijetonin në çdo vështirësi, që sfiduan fatin e që synuan të dilnin fitimtarë, duke ndihmuar të tjerët.

Me ilustrime mjaft tërheqëse ky libër përfshin tituj, si: "Robinson Kruzo" i Daniel Defosë; "Udhëtim në qendër të Tokës" i Zhyl Vernit; "David Koperfildi "i Çarls Dikensit; "Sandokani" i Emilio Salgarit; "Ishulli i thesarit" i Robert L. Stivensonit; "Fantazma e Kantervillit" i Oskar Uajlldit; "Konti i Monte Kristos" i Aleksandër Dymasë; "I Fundit i Moikanëve" i Xhejms F. Kuperit; "Tom Sojeri" i Mark Tueinit; "Mobi Dik" i Herman Melvillit dhe "Ivanhoe" i Valter Skotit.

Seria

Letërsia franceze për fëmijë



BALABILUJA

Faqe: 42, me ngjyra
Formati: 120 x 170 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 420 lekë; 3.5 euro; 210 den

"A jua kam treguar historinë e Balabilusë?" – pyeti Namani, peshkatari i vjetër, Lalën dhe fëmijët e tjerë. Ata tundën kokën në shenjë mohimi. Këtu fillon historia e mrekullueshme e një mbreti të madh, që kishte një vajzë shumë të bukur, që e quanin Lejla. Mbretëria e tij pllakoset nga thatësira, e cila vjen nga një mallkim... Një zog i vogël, me një zë magjik, e shpëton Lejlën e bukur dhe mbretërinë nga thatësira... Po kush është ky zog? Një histori e mbushur plot me befasi, emocion dhe rimë. Histori si e një mijë e një netëve, e treguar nga Lë Klezio, autor i çmimit "Nobel" në letërsi.

UDHËTIM NË BOTËN E PEMËVE

Faqe: 38, me ngjyra
Formati: 120 x 170 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 350 lekë; 3 euro; 180 den

A e di ti se pemët flasin, lëvizin dhe shohin? Nëse i vështrojmë me kujdes, do të zbulojmë se ato janë si ne. Djali i vogël do t'i zbusë ato dalëngadalë dhe, falë imagjinatës, ai do të ndërmarrë një udhëtim të mrekullueshëm, ku do të zbulojë sekretet e tyre. Kjo përrallë poetike e shkrimtarit të shquar francez Lë Klezio, është një himn për heshtjen dhe jetën, për të mos u mërzitur kurrë dhe për të mësuar se si të ëndërrojmë. Lë Klezio është autor i shumë librave për fëmijë dhe të rritur. Ai ka shkruar mbi 40 vepra dhe ka marrë një sërë çmimesh, ndër to dhe më të rëndësishmin çmimin "Nobel" në letërsi.

NJË PLAK I VITIT TË RI NDRYSHE

Faqe: 94, me ngjyra
Formati: 145 x 205 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 500 lekë; 4 euro; 250 den

Marinarë dhe piratë nga të gjitha anët kanë krijuar një parajsë të vërtetë në një ishull të Oqeanit Indian. Jeta atje rrjedh ëmbël e qetë deri pa mbërritur Aldeberti, një fëmijë europian dhjetë-vjeçar.

Padashur Aldeberti do të fusë shqetësimin në shpirtin e të gjithë miqve të rinj në «Ishullin e Mrekullueshëm» duke u folur atyre për Plakun e Vitit të Ri. Këmbëdrunjti i vjetër u përpoq shumë të qetësonte gjakrat, por fëmijët donin të dinin: A egziston Plaku i Vitit të Ri?

LETËRSIA FRANCEZE PËR FËMIJË

Tituj: 5 (seri e hapur)

DANIEL PENNAC

Shkrimtari francez Daniel Pennac, autor i bestsellerëve ndërkombëtarë, është përkthyer në mbi 30 gjuhë të botës. Ai është kurorëzuar me shumë çmime letrare ndër të cilët: RENAUDOT 2007; Grinzane Cavour International (2002); MYSTÈRE DE LA CRITIQUE 1988 ; TROPHÉE 813 DU MEILLEUR ROMAN POLICIER 1987.



SYRI I UJKUT

Faqe: 160, bardhë e zi
Autori: Danniel Pennac
Formati: 140 x 185 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350g
Çmimi: 650 lekë; 5 euro; 300 den

Në një kopsht zoologjik, një ujk plak dhe me një sy ndeshet me një njeri të çuditshëm, një djalë që e vështron pa lëvizur, që qëndron i ngrirë si një pemë dhe vështron Ujkun. Ditën kalojnë dhe djali nuk ia ndan sytë deri në momentin kur Ujku dorëzohet dhe ulet përballë djalit dhe vendos të sillet si ai. Por djali shkon më tej. Për të folur një gjuhë me Ujkun, ai mbyll njërin sy. Që nga ai moment në syrin e Ujkut djali lexon, përjeton aventurën e dhimbshme dhe prekëse të Ujkut të Veriut të largët Kanadez. Shfarosjen e tyre të pamëshirshme, gjahtarët që i përndiqnin hap pas hapi...deri në momentin kur Ujku sakrifikohet për të shpëtuar të motrën.

Dhe ja ku Ujku kupton që nuk është vetëm, që ka ende shpresë, dhe zemra e tij fillon të çelë sërish falë mirësisë së djalit...

JETA E NJË QENI

Faqe: 224, bardhë e zi
Autori: Danniel Pennac
Formati: 140 x 185 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 800 lekë, 7 euro, 430 den

Pothuajse i mbytur në lindje, i hedhur te plehrat dhe i përndjekur nga gjuajtësit e qenve. Nuk ka dyshim: jeta e një qeni është e vështirë. I vetëm në botë, ai vendos se është koha për t'i gjetur vetes një pronar, dikë që mund ta dojë dhe, sigurisht, ta trajnojë. Por njerëzit mund të jenë të paqëndrueshëm dhe të paparashikueshëm, dhe kush do ta donte një qen të shëmtuar dhe të lerosur si ai? Papritur, në jetën e tij shfaqet Molla, një vajzë kokëfortë dhe tekanjoze. A mund të jetë ajo pronarja për të cilën po kërkon ai? Apo Qeni do ta gjejë veten në rrugë përsëri?

Seria Enciklopedia ime

ENCIKLOPEDIA 6-10 VJEÇ

Faqe: 176, me ngjyra
Formati: 207 x 265 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 2 500 lekë; 20 euro; 1250 den

Në këtë enciklopedi janë përmbledhur së bashku temat kryesore të dijes, për të kuptuar gjithçka rreth botës që na rrethon. ***Universi, trupi i njeriut, historia, toka, bimët, kafshët, bota sot, artet, shkenca dhe teknologjia*** janë fushat e dijet, njohuritë bazë të së cilave i gjeni të përmbledhura në këtë enciklopedi, me ilustrime të ndryshme, që kureshtarët e vegjël të zbulojnë botën rreth tyre.



ENCIKLOPEDIA 10-14 VJEÇ

Faqe: 392, me ngjyra
Formati: 207 x 265 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 3 300 lekë; 28 euro; 1700 den

Në këtë enciklopedi janë përmbledhur së bashku temat kryesore të dijes, për të kuptuar gjithçka rreth botës që na rrethon. ***Historia, kafshët dhe bimët, shkenca e tokës, trupi i njeriut, shkenca dhe teknika, bota sot, arti, leximi dhe sporti*** janë fushat e dijet, njohuritë bazë të së cilave i gjeni të përmbledhura në këtë enciklopedi për moshat 10 deri në 14 vjeç. Këtu do të gjeni 15 përmbledhje interesante mbi dinozaurët, astronominë, sportin, Europën dhe 100 personazhe që kanë bërë historinë, me ilustrime mjaft të këndshme!

Seria Miniguidat



MINIGUIDA TIRANA

Faqe: 80, me ngjyra

Formati: 150 x 235 mm

Kopertina: e fortë

Çmimi: 800 lekë; 7 euro; 430 den

Ky libër nuk është thjesht një udhërrëfyes turistik, pasi qyteti ka plot gjëra për të treguar dhe për të zbuluar: legjendat dhe historitë, figurat e shquara të shkuara dhe të sotme, e plot vende e thesare të trashëgimisë sonë, aq tërheqëse për ju.

MINIGUIDA PËR FËMIJË

"Miniguida TIRANA" çel serinë e guidave të qyteteve shqiptare për fëmijë nga ALBAS, që do të vazhdojë me Prishtinën, Shkodrën, Gjirokastrën, Korçën etj. Miniguida turistike për udhëtarët e vegjël ose për ata që duan të njohin më shumë historinë e qytetit, të shkuarën dhe të ardhmen e tij, të shoqëruara me ilustrime plot imagjinatë dhe me gjuhë tërheqëse për fëmijët.

Këta libra nuk janë thjesht udhërrëfyes turistik, pasi qyteti ka plot gjëra për të treguar dhe për të zbuluar: legjendat dhe historitë, figurat e shquara të shkuara dhe të sotme, e plot vende e thesare të trashëgimisë sonë, aq tërheqëse për fëmijët.

Sepse qyteti është një botë për t'u zbuluar...

VIJNË SË SHPEJTI...

Miniguida Shkodra

Miniguida Gjirokastra

Miniguida Prishtina

Seria

Tituj të tjerë

ÇFARË ZBULIMI

Faqe: 140, me ngjyra
Formati: 165 x 235 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 700 lekë; 6 euro; 350 den

Dysheme për t'u veshur me pllaka të ngjyrosura, një kurorë e artë që dyshohet se nuk është prej ari, rrufe që ndajnë në dysh pemë shekullore... Çfarë kanë të përbashkët? Janë disa nga problemet që i kanë shtyrë shkencëtarët dhe shpikësit që të bëjnë zbulime të mëdha që ndryshuan botën, të gjitha të përmbledhura në këtë libër.

BENI DHE ANA

Faqe: 100, bardhë e zi
Formati: 145 x 205 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 500 lekë; 3.7 eur; 230 den

Është një roman për fëmijë mjaft i këndshëm. Aty flitet për dashurinë fëmijërore mes Anës dhe Benit, për prindërit e tyre, shokët e shoqet e klasës së tyre, mësuesin aq simpatik Zajbman etj. Romani trajton një anë të veçantë të marrëdhënieve të fëmijëve, si dhe dashamirësinë dhe taktin që tregojnë ndaj tyre si prindërit, ashtu edhe mësuesit.

GJYSHJA NË PEMËN E MOLLËS

Faqe: 112, bardhë e zi
Formati: 140 x 208 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 450 lekë; 3.5 eur; 220 den

Andi është i mërzitur sepse, ndryshe nga shokët e klasës, nuk ka një gjyshe. Papritur ai bëhet me dy gjyshe. Njëra rri fshehur në pemën e mollës dhe ka një makinë bojëqielli me butona çudibërëse. Së bashku ata nisen drejt aventurave gjithnjë e më emocionuese: argëtohen në parkun e lojërave, shkojnë në stepën mbresëlënëse e mandej lundrojnë në detin e stuhishëm drejt Indisë. Ndërsa gjyshja e dytë është fqinja e re, për të cilën Andi mund të kujdeset.

BËMAT FATKEQE TË RIKARD ZEMËRRADHIQES, KALORËS I GURIT TË LLUMIT

Faqe: 116, me ngjyra
Formati: 128 x 190 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 580 lekë; 4.2 eur; 250 den

Për faj të një gabimi të pafalshëm të të mjerit këshilltar Pepo Peponi, Rikardi, djali dembel i kontit Rrumbullan, emërohet kalorës i Kontesë. Për habinë e të gjithë Oborrit, Rikardi pranon dhe emëron shqytar të tij personal shërbëtorin e dhjamosur, Nespullin. Hipur në shalën e të madhit dhe të panënshtrueshmit, kalit Titan, të ndjekur nga mushka Agostinë, ata të dy ndërmarrin misionin e tyre të parë: të gjejnë një bimë të rrallë për të shëruar stomakun e kontit. Dhe kështu, dy shokët e aventurës lënë për herë të parë muret e kështjellës dhe shkojnë drejt e në qendër të së parës, të shkëlqyeshmes... katrahurë.

JASEMINI NË VENDIN E GËNJESHTARËVE

Faqe: 176, me ngjyra
Formati: 148 x 210 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 770 lekë; 6 eur; 380 den

Në një vend, ku, sipas urdhrit të sovranit, gjithçka funksionon në të kundërt dhe është e ndaluar të thuhet e vërteta, mbërrin Jasemini me zërin e tij të fuqishëm, i cili me ndihmën e miqve simpatikë mposht arrogancën dhe bën të triumfojë sinqeriteti. Në këtë libër (një ndër të parët) Rodari dëshmon aftësinë e tij të jashtëzakonshme për të shqyrtuar realitetin shoqëror me sy kritik dhe aftësinë për të shkuar me gjallëri dhe me finesë stili drejt një universi fantastik, të ngritur mbi altruizmin, bujarinë dhe miqësinë. Jasemini me zërin dhe me tipin simpatik na fton ta shohim me mirëbesim të ardhmen.

Ç'NATË E MREKULLUESHME

Faqe: 210, me ngjyra
Formati: 195 x 230 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 1 200 lekë; 9 eur; 540 den

Përmes tetë rrëfimeve, të cilat i bashkon tema e Krishtlindjes, tetë nga autorët italianë më në zë të letërsisë për fëmijë tregojnë për personazhe dhe situata shumë të ndryshme mes tyre. Në këto rrëfime për këtë festë kaq të dashur në të gjithë botën përmblidhen aspekte të ndryshme të saj. Zemërgjerësi, përulësi, lindje, familje, mohim, gatishmëri për t'u bërë mirë të tjerëve, si dhe kujtime të bukura janë disa nga fjalët që të vijnë në mendje, ndërsa lexon këtë libër dhe secila mbart një thesar sugjerimesh, si ajo dhurata që gjen poshtë pemës, gati për ta hapur.

RRËMBIMI I PRINCIT OLEOMARGARIN

Faqe: 154, me ngjyra
Formati: 203 x 280 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 280 lekë; 10 euro; 600 den

Rrëmbimi i princit Oleomargarin, vepra e mbetur në dorëshkrim e shkrimtarit legjendar amerikan Mark Tuein, vjen për herë të parë në shqip.

Libri flet për fatin e një djali të varfër, Xhonit, që doli për të shitur pulën e tij të vetme, të quajtur Murtaja dhe Uria. Megjithëse po vdiste nga uria, ai ia fali pulën një plake, e cila i dhuroi disa fara magjike. Pasi hëngri lulen Juju, Xhoni shkon në botën e kafshëve dhe më pas në oborrin e mbretit, të cilit i kanë rrëmbyer djalin, princin Oleomargarin. Pas gjithë aventurave, Xhoni nuk u bë i pasur prej parave, por sepse gjeti miq të vërtetë.



NJË ËNDËRR JASHTË LOJE

Faqe: 192, me ngjyra
Formati: 109 x 183 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 750 lekë; 6 euro; 380 den

Për Danielin, shokun e ri të skuadrës dhe sulmuesin e ri të *Virtusit*, Matia di vetëm që e ka lëkurën të errët, që shpërfill pozicionin jashtë loje dhe bën gola të përsosur. Por rreth Danielit ka shumë për të zbuluar: ai vjen nga larg, ka një buzëqeshje ngjitëse dhe për Matian e Ilarian ai do të bëhet si një vëlla. Kjo deri ditën kur Danieli do të zhduket dhe të rinjve do t'iu duhet kurajë për të përballuar sekretet që historia e tij fsheh. Në këmbim, do të mësojnë që ëndrrat janë shumë më të thjeshta për t'u realizuar, nëse përpiqemi të gjithë së bashku.

Ç'PO NDODH ME MUA?!

Faqe: 64, me ngjyra
Formati: 200 x 290 mm
Kopertina: me mbushje
Çmimi: 1 000 lekë; 7 euro; 430 den

Libri **"Ç'po ndodh me mua"** i ndihmon adoleshentët të qartësojnë dyshimet e mëdha që mund t'u lindin në këtë etapë. Si mund të flas për seksin me prindërit e mi? Ç'të bëj që t'i pëlqej personit tjetër? Ç'rroba duhet të vesh? Këto dhe shumë çështje të tjera të adoleshencës, periudhë kjo e mbushur me ndryshime e me emocione të reja, qartësohen në këtë libër. Të rinjtë zbulojnë se "shqetësimet" që ka secili prej tyre, i kanë edhe shokët e tjerë të klasës, miqtë apo të rinjtë me të cilët takohen çdo ditë.



RACIZMI SHPJEGUAR VAJZËS SIME

Faqe: 160, bardhë e zi
Autori: Tahar Ben Jelloun
Formati: 130 x 210 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 1 000 lekë; 8 euro, 500 den

Tahar Ben Jelloun është një nga shkrimtarët më të njohur francezë, i vlerësuar me disa çmime dhe kandidat për çmimin *Nobel* në Letërsi. *Racizmi shpjeguar vajzës sime* është bestseller dhe është përkthyer në 25 gjuhë.

Njeriu nuk lind racist, por bëhet. Këtë përpiqet t'i shpjegojë autori vajzës së tij, Merjemes, e cila gjatë një manifestimi kundër një projektligji për emigracionin e pyeti për racizmin. Libri është në formën e një bashkëbisedimi, që u përgjigjet pyetjeve kureshtare të një fëmije. Ky libër u drejtohet *fëmijëve* që nuk kanë ende paragjykime dhe *prindërve, mësuesve, edukatorëve,* për t'iu përgjigjur pyetjeve më të koklavitura nga sa mendojnë fëmijët.

UNË THEM JO!

Faqe: 208, me ngjyra
Formati: 170 x 225 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 1 100 lekë; 8.5 euro; 550 den

Nga Spartaku te Darvini, nga Gandi te Martin Luter Kingu, nga Xhordano Bruno te Malala Josafzai: historitë e grave dhe të burrave që u kanë thënë Jo padrejtësive. Tridhjetë e pesë histori të jashtëzakonshme, që rijetësojnë betejat e mëdha për lirinë. Dy personalitete të rëndësishme të kulturës shqiptare, NËNË TEREZA, që i ka thënë "JO" varfërisë dhe MUSINE KOKALARI, që i ka thënë "JO" komunizmit, janë përgatitur për botim nga redaksia ***Albas***.

ÇFARË MUZIKE!

Faqe: 160, me ngjyra
Formati: 168 x 211 mm
Kopertina: e fortë
Çmimi: 1 100 lekë; 8.5 euro; 550 den

Një libër që i dedikohet muzikës dhe forcës që të jep ajo. Me një stil mbresëlënës tregohet historia e 20 këngëtarëve që kanë bërë historinë e muzikës moderne. Që nga Elvis Presly, Michael Jackson, Aretha Fanklin, Madona... e deri te Eminemi e Lady Gaga. U kushtohet të gjithë atyre që e adhurojnë muzikën, veçanërisht atyre që kanë brenda tyre një ***rockstar***, edhe pse akoma mund të mos e dinë këtë.



MONDO DHE TREGIME TË TJERA

Faqe: 356, me ngjyra
Autori: J. M. G. Le Clézio
Formati: 140 x 205 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 1 000 lekë; 8.5 euro; 520 den

Fëmijë, të afërt apo të largët, ata quhen Mondo, Ulula, Jon, Daniel Sinbad, Kryqi i Vogël... Me praninë e tyre ndriçojnë secilën nga këto histori dhe na ftojnë t'i ndjekim e të futemi në botën e tyre për të zbuluar udhën e lirisë.

Zbuloni librin Mondo dhe tregime të tjera, shkruar nga J. M. G. Le Clézio, i cili është nderuar me çmimin ***Nobel në letërsi***.

JETA IME, DASHURIA DHE GJITHÇKA TJETËR

Faqe: 240, bardhë e zi
Autori: Dagmar Hobfeld
Formati: 145 x 210 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 800 lekë; 6.5 euro, 400 den

"Jam pesëmbëdhjetë vjeçe. Që prej fiks një sekonde. Zemra më rreh fort.

Ndihem si gjithmonë. Aspak ndryshe. Por, s'duhet të jetë kështu. Duhet të jetë ndryshe! Sido që të jetë, jam përpjekur pesëmbëdhjetë vjet të jetës sime për të qenë pesëmbëdhjetë vjeçe. Sidomos viti i fundit ka qenë vërtet shumë i vështirë. Kur je pesëmbëdhjetë, në të kundërt, je gati e rritur. Duhet të ketë, pra, një ndryshim. Sot është 30 prill, ditëlindja ime. Nga sot kam fiks një vit kohë për të gjetur ndryshimin, nëse ka një të tillë."

Një roman gjenial për adoleshentë dhe problemet që shoqërojnë jetën e tyre!

VERA IME PA TË DASHUR

Faqe: 212, bardhë e zi
Autori: Dagmar Hobfeld
Formati: 145 x 210 mm
Kopertina: e plastifikuar, 350 g
Çmimi: 800 lekë; 6.5 euro, 400 den

Është verë. Shkolla ka mbaruar dhe Koni ndihet e vetmuar. Prindërit janë në punë, ndërsa shoqet e saj të ngushta kanë ikur me pushime. Edhe Filipi ndodhet mijëra kilometra larg, në një kurs veror në Kaliforni të SHBA-së. Tanimë mes tyre ekzistojnë disa zona kohore dhe Koni nuk e di se në cilën prej tyre ka ngecur...

Si mund t'i mbijetojë një vere të tillë, krejt e vetmuar, një vajzë 15-vjeçare? Cila është gjëja e duhur për ta kthyer një "summerboring" në një "summerfeeling"? Një libër mjaft interesant dhe edukativ për këtë grupmoshë, se si ata të arrijnë të kapërcejnë me maturi dhe mençuri sfida dhe zona kohore, në dukje të pakapërcyeshme!



MITOLOGJIA

Faqe: 184, me ngjyra
Formati: 140 x 190 mm
Kopertina: me mbushje
Çmimi: 1 000 lekë; 7 euro; 600 den

Mitologjia është tërësia e miteve të krijuara nga njerëzit në lashtësi, me të cilat ata shpjegonin dukuritë natyrore, sëmundjet, marrëdhëniet personale dhe familjare, luftërat... Në këtë vëllim janë përmbledhur mitet më të shquara të disa kulturave, shumë prej të cilave kanë karakteristika të përbashkëta, edhe pse janë krijuar në disa kontinente të ndryshme. Mitet janë dhënë shkurtimisht dhe nxirren në pah veçoritë e tyre dalluese. Gjithashtu jepen ilustrime që identifikojnë personazhin mitik dhe emrin e tij korrespondues në kulturat e tjera. Në fund të vëllimit ka një tregues emëror të personazheve mitike, me emrat e tyre në kulturat e tjera.

MITOLOGJIA SHQIPTARE

Faqe: 130, me ngjyra
Formati: 140 x 190 mm
Kopertina: me mbushje
Çmimi: 1100 lekë; 9 euro; 550 den

Në këtë libër mitologjia shqiptare vjen e strukturuar në: *Mitologji pellazge, Mitologji ilire, Mitologji arbërore.* Mitologjia shqiptare dhe dokumentohet paralelisht me mitologjinë greko-romake, që përbën bazat më të hershme të qytetërimit të sotëm europian dhe më gjerë. Nëse pasuria e mitologjisë greke vjen përmes poemës së famshme të Homerit, ajo shqiptare pasqyrohet në poemën "Lahuta e Malcis" të Gjergj Fishtës, ku, përkrah heronjve luftëtarë, gjallojnë afro 112 figura mitologjike, 97 prej të cilave me emra të përveçëm. Libri sjell për lexuesit jo vetëm kënaqësinë e leximit për një botë fantastike ireale, por edhe kënaqësinë që vjen prej imazheve nga lashtësia dhe ato moderne, të autorëve botërorë dhe të atyre shqiptarë.

LEXIMI TË ZGJERON BOTËN

albas

Shtëpia botuese ALBAS është krijuar në vitin 2000. Themelues të saj janë LATIF AJRULLAI dhe RITA PETRO.

Që në fillimet e saj ALBAS ka pasur si politikë botimet shkollore. Me seli në Tiranë, Tetovë, Prishtinë dhe Preshevë ALBAS jo vetëm që e sjell tekstin shqip sa më afër nxënësve në hapësira të ndryshme gjeografike, por edhe e përpilon atë sipas kërkesave të veçanta të sistemeve arsimore në këto vende.

ALBAS ka një numër të madh bashkëpunëtorësh: studiues, pedagogë, punonjës shkencorë e didaktë, mësues të kualifikuar, përkthyes, të cilët kanë sjellë në botime koncepte bashkëkohore, shkencore dhe didaktike. Gjithashtu, ajo është e përbërë nga një staf profesionist, i cili ka një përvojë të gjatë në fushën e botimeve. Ky staf karakterizohet nga dëshira, vullneti dhe përkushtimi për të realizuar dhe për të botuar libra sa më bashkëkohorë, që bazohen në psikologjinë dhe botën e fëmijëve të moshave të ndryshme, prandaj çdo vit rritet numri i mësuesve dhe i prindërve që përzgjedhin librat e kësaj shtëpie botuese.

Shtëpia botuese Albas është bërë lider në tregun e librit shkollor, si dhe në tregun e librit për fëmijë. Kjo për arsye se vizioni i saj përputhet me vizionin e një biznesi që synon siguri dhe besueshmëri në të ardhmen.

Në Tiranë:
Rr. "Donika Kastrioti", pallati 14, ap. 4D
Tel: +355 45800160
e-mail: info@albas.al

Në Tetovë:
Rr. "Ilindenit", nr. 105
Tel: +389 44344047
e-mail: albas_te@yahoo.com

Në Prishtinë:
Rr. "Muharrem Fejza", p.n.
Tel: +383 45 999 750
e-mail: albas_pr@yahoo.com